# Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (82). SHKURT 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

*koha kalon, cilësia mbetet*

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al



VENDLINDJA

## Xhoxhet e Lugjej

*Nga* **ILMI DERVISHI** - FAQE 6

## Fshati Zogje

*Nga* **BASHKIM LLESHI** - FAQE 7

NOSTALGJI

## Na ishte njëherë një Kombinat i Qilimave...

*Nga* **REXHEP TORTE** - FAQE 5

KULTURË

## Alegoria si kllapedanar i ligjërimit

*Nga* **QERAM CIBAKU** - FAQE 14

PORTRET

## Cuca himariote, nuse e mësuese në Blliçe

*Nga* **SHAQIR SKARRA** - FAQE 6


Këndvështrim studimor nga antikiteti deri në vendosjen e regjimit komunist


# Shkëlqimi, rënia dhe demonizimi i parisë

*Nga* **Mentor HOXHA**

**FORMIMI I PARISË DIBRANE**

Përgjatë Mbretërisë ilire dhe luftërave iliro-romake e romake-makedone (170-169, p.e.s), kur treva dibrane (Penestia) u pushtua nga ushtritë romake dhe ato makedone të Perseut, nuk ka dokumente mbi strukturën e parinë krahinore. Me përfundimin e tyre më 167 p.e. s. Dibra (Penestia) ra për 4 shekuj e gjysëm nën pushtimin romak. Më 395 të erës sonë, kur Perandoria Romake u nda në dy pjesë: e Lindjes dhe Perëndimit, viset juglindore të Ilirisë (përfshirë dhe Dibra), kaluan për dy shekuj në Peradorinë e Lindjes, që më pas u quajt Perandoria Bizantine. Në fillim të shek. VII-VIII u bë pre e barbarëve dhe e kolonizmit sllav të Maqedonisë. Në fund të 10 vjeçarit II të shek. IX hyri sërish nën sundimin bizantin nën juridiksionin e Themës së Durrësit (812-820), ndërsa nga fundi i shek. IX deri në fillim të shek. XI, u vu nën sundimin bullgar. Pas shembjes së Perandorisë bullgare më 1018 hyri përsëri nën sundimin bizantin. Në fund të shek.XII, kur u krijua Principata e Arbërisë (1191-1216), (shteti i parë shqiptar) me qendër Konjën popullsia dibrane u përfshi në të dhe u shkëput politikisht nga Perandoria Bizantine. Pas bizantëve erdhën anzhuinët e Napolit, të cilët më 1272 shpallën Mbretërinë e mbretit të tyre Karlit I d'Anxhuin. Më 1283, Dibra u pushtua nga mbreti serb Milutin dhe deri më 1307 mbeti nën sundimin e Mbretërisë së Rashës, më pas në sundimin 20 vjeçar të Stefan Dushanit. Gjatë këtij sundimi, bujarët dibranë u zëvendësuan me bujarë serb. Pas vdekjes së Car Dushanit më 1355 dhe shpërbërjes së Perandorisë serbe, u shfaq Andrea Gropa, me titull "Zhupan i Madh", (kreu i disa zhupanëve krahinorë).

*(Vijon në faqen 11)*



## **Konkurs** ndërkombëtar për shtatoren e **Dom Nikollë Kaçorrit**

**Galeria e Arteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës kanë shpallur në muajin shkurt një konkur ndërkombëtar për realizimin e shtatores kushtuar Dom Nikoll Kaçorrit, zëvendëskryeministër i qeverisë së Ismail Qemal Vlorës në vitin 1912.**

**Në kushtet e vëna për këtë konkurs, thuhet se shtatorja duhet të jetë figurative dhe realiste dhe duhet të jetë e krijuar posaçërisht për këtë konkurs. Ajo do të derdhet në bronz dhe do të vendoset në një nga sheshet e qytetit të Durrësit.**

**Mbledhja e boceteve fillon më 1 prill dhe përfundon më 29 prill 2013. Nikollë Kaçorri ishte klerik, politikan dhe atdhetar shqiptar, nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë dhe zëvendëskryeministër i parë i Shqipërisë.**

**Buste të Dom Nikollë Kaçorrit u realizuan në kuadrin e 100-vjetorit të Pavarësisë dhe janë vendosur në ceremoni zyrtare në Peshkopi dhe në Lurë.**

**BULQIZË,FESTOHET JUBILEU I 65-VJETORIT TË MINIERËS**

# Administratorët në festë, minatorët në protestë

Ehëna 18 shkurt 2013, për komunitetin e Bulqizës ka përkuar me jubileun e 65-të të hapjes së minierës së kromit në këtë qytet. Ka qenë 18 shkurti i vitit 1948, kur shpërthimi i minave paralajmëroi hapjen e kësaj miniere, që ndër vite erdhi dhe u bë jo vetëm më e madhja e këtij lloji në vendin tonë, por edhe më gjerë, si për nga sasia e nxjerrjes së mineralit, ashtu dhe për nga cilësia e tij. Kështu në 65 vite të jetës së saj nga kjo minierë janë nxjerrë 25 milion ton krom me cilësi të lartë 42 deri në 46% oksid kromi. Në kuadër të rëndësisë së kësaj miniere kujtojmë se edhe para viteve '90, ish PPSH-së deklaronte në kongreset butaforike të saj, se Miniera e Bulqizës, jep 32 deri në 37 % të të ardhurave kombëtare në shkallë vendi, ku në kushtet e izolimit të egër të vendit punohej me moton: "Kromi çan bllokdën".

*Nga* **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 3


**BOTIME**

## Dibra në hulli të historisë

Një botim në tre vëllime mbi historinë e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj

## Një botim shkencor për shkollën

*Nga Prof. Dr.* **ADEM BUNGURI dhe ELMAS LALA** - FAQE 12,13






**HOMAZHE**

## Beshir Sufa, figurë e shquar në historinë dibrane

*Nga* **NAIM PLAKU** - FAQE 21

## Memorial për Maliq Kacanin

*Nga* **XHAFER MARTINI** - FAQE 22

## Çidhnaku humanist

*Nga* **MEVLUD BUCI**- FAQE 23


cyan magenta yellow black 1

**Festimi i përvjetorit të 65-të të minierës më 18 shkurt 2013-të, ka ndarë administratorët nga minatorët. Kështu të parët, administratorët qendrorë e lokal, kanë festuar e drekuar ndërsa për minatorët ka qenë një ditë pune e zakonshme**

# Koncensioni i Bulqizës

**Pajtim Bello: "Kompania shfrytëzoi mineralin e kromit, transferoi fitimet, tashmë merr edhe një dorë eurosh nga shitja e aksioneve dhe largohet pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë. Ndërkohë ne na lë një të keqe të madhe".**



Ish-zëvendësministri i Energjetikës Pajtim Bello thotë se shitja për herë të dytë e koncesionit të kromit vulos përfundimisht fundin e minierës së Bulqizës.

"Eshtë marrë vendim për ta ndëshkuar përfundimisht minierën e Bulqizës, për ta përcaktuar përfundimisht fatin e saj. Dëmi është i qartë, miniera e Bulqizës nuk është e hapur dhe jetëgjatësia e saj tashmë numërohet në muaj, jo në vite. Edhe minerali që ka mbetur do të merret dhe askush nuk do ta hapë më atë minierë", thotë Bello.

Tre ditë më parë Autoriteti i Konkurrencës njoftoi se kompania 'ACR' ja ka shitur 100 për qind të aksioneve grupit 'Balfin', që zotërohet nga biznesmeni shqiptar Samir Mane.

"Kompania shfrytëzoi mineralin e kromit, transferoi fitimet, tashmë merr edhe një dorë eurosh nga shitja e aksioneve dhe largohet pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë. Ndërkohë ne na lë një të keqe të madhe, ashtu siç u paralajmërua para dy vjetësh", shton Bello.

Sipas të dhënave zyrtare të bëra publike nga vetë Ministria e Ekonomisë, ACR nuk ka realizuar 13 milionë euro nga plani i detyrueshëm i investimeve, që kryesisht kanë të bëjnë me hapjen e thellësisë së minierës për rritjen e jetëgjatësisë së saj. Bello thotë se shitja në këto kushte duhet të ishte ndalur.

"Absolutisht koncensionari nuk mund të ikë duke shitur. Ai mund të përzihet, pra mund ta largojë Qeveria, por mbasi të paguajë penalitetet. Nuk mund të pritej që këto kompani të largohen pasi konsumojnë gjithë kohën për të kryer investimet, nuk i kryejnë dhe pastaj ikin. Kompanitë shfrytëzojnë burimet e mineraleve dhe ikin pa i hyrë një gjemb në këmbë", shton Bello.

### ABUZIMI 12-VJEÇAR ME KROMIN

Ikja e kompanisë ruso-austriake shënon fundin e një historie abuzimi dhe shpërdorimesh me një nga pasuritë më të madhe publike, minierën e kromit në Bulqizë. Koncesioni i minierës është miratuar që në vitin 2001 nga ish-Qeveria socialiste.

Bashkangjitur marrëveshja përmbante edhe një plan të detyruar investimesh për rritjen e sigurisë në punë, përmirësimin e teknologjisë në minierë dhe zgjatjen e jetës së saj. Por plani i investimeve nuk u zbatua si nga darfo fillimisht ashtu dhe nga acr më vonë.

Në qershor të vitit 2009, kur afati ligjor kishte skaduar të dy kompanitë kishin kryer vetëm gjysmën e investimeve të detyruara. E gjendur përballe kësaj shkelje, që ligjërisht e rrëzonte koncesionin e minierës, ACR kërkoi shtyrjen e afatit të investimeve dhe shtyrjen për pagesën e gjobës që ajo duhet të paguante për mosrealizimin e tyre.

Vetëm 2 ditë pas kësaj kërkesë, në 9 korrik të vitit 2009, ish-ministri i Ekonomisë Genc Ruli përmes një procedure të dyshimtë miratoi kërkesën më një vendim të vetin, duke anashkaluar kuvendin, i cili ishte organi që kishte miratuar marrëveshjen koncesionare. Pa kërkuar miratimin në Kuvend, Zoti Ruli i dha të drejtë kompanisë që 11.4 milionë dollarët që duhet t'i kishte investuar t'i riskedulonte deri në fundin e vitit 2012.

Paralelisht ish-kreu i Energjetikës shtyu edhe pagesën e gjobës prej 1.6 milionë dollarësh, që kompania duhet të derdhte menjëherë në shtet për moskryerjen e investimeve. Por edhe pas kësaj shtyrje sërish kushtet nuk u zbatuan. Në fund të vitit 2012 acr kishte realizuar vetëm 30 për qind të investimeve, të cilat duhet të kishin përfunduar ligjërisht që në vitin 2009.

Ndërsa gjoba 1.6 milionë dollarë, që kompania duhet ta derdhte brenda gushtit të vitit 2010 në buxhet nuk u shlye asnjëherë. Tashmë kompania po largohet, pasi ka shfrytëzuar më shumë se 6 vjet rezervat e gatshme të kromit, duke marrë fitimet pa kryer asnjë investim dhe duke lënë pas një faturë të madhe për publikun: Rrezikun e mbylljes përfundimtare të minierës sepse shfrytëzimi i rezervave të të gatshme të kromit ka cënuar rëndë rentabilitetin e saj. Kjo i jep fund një koncesioni që në fund pati vetëm një rezultat, privatizimin e fitimeve të pasurisë publike dhe kalimin e humbjeve te qytetarët.

**Ndërsa gjoba 1.6 milionë dollarë, që kompania duhet ta derdhte brenda gushtit të vitit 2010 në buxhet nuk u shlye asnjëherë. Tashmë kompania po largohet, pasi ka shfrytëzuar më shumë se 6 vjet rezervat e gatshme të kromit, duke marrë fitimet pa kryer asnjë investim dhe duke lënë pas një faturë të madhe për publikun: Rrezikun e mbylljes përfundimtare të minierës sepse shfrytëzimi i rezervave të të gatshme të kromit ka cënuar rëndë rentabilitetin e saj. Kjo i jep fund një koncesioni që në fund pati vetëm një rezultat, privatizimin e fitimeve të pasurisë publike dhe kalimin e humbjeve te qytetarët.**

*Posta e* Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (82). 2 - 28 Shkurt 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Fejzulla Gjabri, Haki Pernezha, Abdurahim Ashiku, Sakip Cami, Mustafa Tola, Zabit Lleshi, Islam Çenga, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
**JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".**
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Rexhep TORTE
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU
Xhafer MARTINI
Naim PLAKU
Adem BUNGURI
Elmaz LALA
Qeram CIBAKU
Mentor HOXHA
Bashkim LLESHI
Resul BENDO
Jahe DELIA (SELMANI)
Ali R. BERISHA
Mevlud BUCI
Ilmi DERVISHI
Ymer STOJKU

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Keni nje histori per te treguar?

Nje ngjarje per te kujtuar?

Nje liber per te promovuar?

Nuk keni nevoje per MIK, as PARA per te paguar...

vetem shkruani ne emailin <rrugaearberit@gmail.com>

Rruga e Arbërit

65 VJETORI I MINIERËS SË BULQIZËS
Shoqata e Minierave të Shqipërisë në bashkëpunim me ACR, pjesë e Balfin Group

BULQIZË,FESTOHET JUBILEU I 65-VJETORIT TË MINIERËS

# Administratorët në festë, minatorët në protestë

*Nga* **HYSEN LIKDISHA**

Ehëna 18 shkurt 2013, për komunitetin e Bulqizës ka përkuar me jubileun e 65-të të hapjes së minierës së kromit në këtë qytet. Ka qenë 18 shkurti i vitit 1948, kur shpërthimi i minave paralajmëroi hapjen e kësaj miniere, që ndër vite erdhi dhe u bë jo vetëm më e madhja e këtij lloji në vendin tonë, por edhe më gjerë, si për nga sasia e nxjerrjes së mineralit, ashtu dhe për nga cilësia e tij. Kështu në 65 vite të jetës së saj nga kjo minierë janë nxjerrë 25 milion ton krom me cilësi të lartë 42 deri në 46% oksid kromi. Në kuadër të rëndësisë së kësaj miniere kujtojmë se edhe para viteve '90, ish PPSH-së deklaronte në kongreset butaforike të saj, se Miniera e Bulqizës, jep 32 deri në 37 % të të ardhurave kombëtare në shkallë vendi, ku në kushtet e izolimit të egër të vendit punohej me moton: "Kromi çan bllokdën".




**Përfaqësuesi i Belfin Group, garantoi se shoqëria e re koncensionare nuk do të neglizhojë dhe shmangë asnjë detyrim të firmosur në kontratën koncensionare, gjatë operimit në minierë. Për 2-3 javë, kompania do të hapë traverbangun e Klosit, për të mundësuar kështu mospërmbytjen e galerive. Të jeni të sigurtë, premtoi ai, se ky investim në Minierën e Bulqizës, do të jetë një histori suksesi.**

### PAK HISTORI

Vendburimi i mineralit të kromit në Bulqizë, u diktua nga një gjurmues popullor, më 1940. Punimet e para u kryen nga një shoqëri konçensionare italiane, që u detyrua të ndërpresë punimet nga veprimtaritë luftarake të njësive partizane të zonës së Bulqizës për çlirimin e vendit. Pas çlirimit më 18 shkurt 1948 u ngrit miniera dhe filloi prodhimi i mineralit të kromit. Pas krijimit të shërbimit gjeologjik në vitet '50, u zgjeruan punimet e kërkimit, u zbuluan rezerva të konsiderueshme dhe nxjerrja e xeherorëve të kromit u shtua me ritme të larta. Në fillim u zbatua sistemi i shfrytëzimit me mbushje në pjesën e trupit xeheror, afër sipërfaqes duke përdorur galeri të shkurtra. Sot janë hapur galeri e traverbanke me gjatësi 2-3 kilometra, puse vertikale 200-500 metra të thella dhe përdoret gjerësisht sistemi i shfrytëzimit me galeri nënkati. Aktualisht ndihmojnë edhe dhjetëra miniera të reja me punëtorë të kualifikuar e specialistë të mjaft punimeve.

### PERSPEKTIVA

Në të ardhmen miniera e Bulqizës, më e madhja në vendin tonë dhe e treta në botë për nga kapacitetet nxjerrëse dhe veçanërisht cilësisë së kromit, do të zgjerohet e modernizohet më tej. Pas një historie jo të suksesshme koncensionare administrimi të kësaj miniere, që nisi në vitin 2001, me shoqëritë Darfo Albania, për të vijuar më tej me Albanian Chrome ACR në 2006, ku niveli i investimeve ka qenë tejet i ulët, për të mos thënë fare, 2013-ta duket se do jetë viti I kthesës dhe ndryshimit për Minierën e Bulqizës. Kështu aktualisht investitori I ri Balfin Group që ka marrë në dorëzim këtë pasuri të rëndësishme kombëtare, premton se do të ndryshojë gjendjen e minierës në Bulqizë në një kohë record duke investuar me dhjetëra milionë euro. Kështu shoqëria e re koncensionare Balfin Group, që ka marrë në dorëzim minierën për administrim, ka premtuar dhe projektuar ndër të tjera hapjen e një pusi prej 1000 metra të thellë, si dhe disa punime të tjera 300-500 metra. Gjithsesi të shpresojmë dhe të shohim.

### FESTA

Festimi i përvjetorit të 65-të të minierës më 18 shkurt 2013-të, ka ndarë administratorët nga minatorët. Kështu të parët, administratorët qendrorë e lokal, kanë festuar e drekuar në një nga lokalet luksoze në vendin e quajtur "Pishat", për këta të dytët, pra për minatorët kjo ditë, ka qenë një ditë pune e zakonshme

Madje një ditë pune ku në turin e parë të punës, thuhet se ishin përfshirë edhe një pjesë e mirë e minatorëve të turit të dytë, për të mos u dhënë mundësi atyre të shkojnë në protestën që kishte paralajmëruar dega e Partisë Social Punëtore në rrethin e Bulqizës. Kështu, në festën jubilare të 65-vjetorit të minierës, 500 minatorët e saj u privuan të marrin pjesë edhe në festën që organizuan administratorët e minierës me të ftuar special nga Tirana dhe pushteti, por edhe tubimin e protestës që dega e PSP-së zhvilloi në qendër të qytetit. Festa e 65 vjetorit të minierës, me pjesëmarrjen e minatorëve të paktë fare në numër, banorëve të zonës dhe drejtuesve vendor, nisi në ambientet e brendshme të minierës, ku gjithçka, deri edhe podiumi, qendra e zërit, etj, ishte përgatitur nga administratorët qendror nga Tirana. Mori pjesë dhe përshëndeti edhe kryetari i bashkisë Bulqizë, zoti Roland Keta, i cili në fjalën e tij shprehu besimin se investitori i ri Belfin Group, do jetë i suksesshëm dhe se ai do t'i ofrojë kësaj shoqërie gjithë ndihmën e bashkëpunimin e duhur asaj, me kushtin e realizimit prej saj të punimeve të thellësisë së minierës, për t'i zgjatur kështu jetën kësaj miniere. Ndërsa përfaqësuesi i Belfin Group, Luan Selimaj, në fjalën e tij përshëndetëse garantoj se shoqëria e re koncensionare nuk do të neglizhojë dhe shmangë asnjë detyrim të firmosur në kontratën koncensionare, gjatë operimit në minierë. Për 2-3 javë, tha në vijim ai, kompania do të hapë traverbangun e Klosit, për të mundësuar kështu mospërmbytjen e galerive. Të jeni të sigurtë, premtoi ai, se ky investim në Minierën e Bulqizës, do të jetë një histori suksesi.

**Protestuesit kërkuan dhënien e statusit për minatorët, të rënët në minierë që nuk janë pak, por 264 minatorë të shpallen dëshmorë të punës, familjarët e të rënëve të kenë pension të posaçëm familjar, hapja e thellësisë së minierës dhe mosha e daljes në pension të jetë 50 vjeç për burrat dhe 45 vjeç për gratë. Në fjalën e tyre veteranë të minierës u shprehen me bindje se në vazhdimësi pas viteve '90 miniera e Bulqizës është vjedhur sistematikisht nga pronarë me dhe pa licencë. Ndërsa kushtet e punës për minatorët lënë shumë për të dëshiruar, pasi koncensionari, në vijimësi ka shfrytëzuar rezervat e gatshme të mineralit dhe nuk ka investuar asnjë qindarkë për galeritë e minierës.**

### PROTESTA

Dhjetëra minatorë dhe ish minatorë veteranë të kësaj miniere, si dhe të gjithë familjarët e të rënëve gjatë punës në këtë minierë, kanë organizuar një miting proteste më 18 shkurt 2013, në qendër të qytetit, që ka nisur rreth orës 11.30 minuta, që ishte organizuar nën drejtimin e Partisë Social Punëtore të rrethit.

Pjesëmarrja nuk ishte ajo që pritej për arsyet që dihen pasi minatorët aktual ishin në punë dhe të tjerë e ndiqnin në distancë pasi hezitonin të merrnin pjesë për arsyet që dihen. Kryetari i degës së PSP-së të rrethit Kadri Disha, në fjalën e tij renditi disa kërkesa për qeverinë shqiptare si, dhënien e statusit për minatorët, të rënët në minierë që nuk janë pak, por 264 minatorë të shpallen dëshmorë të punës, familjarët e të rënëve të kenë pension të posaçëm familjar, hapja e thellësisë së minierës dhe mosha e daljes në pension të jetë 50 vjeç për burrat dhe 45 vjeç për gratë. Në fjalën e tyre veteranë të minierës u shprehen me bindje se në vazhdimësi pas viteve '90 miniera e Bulqizës është vjedhur sistematikisht nga pronarë me dhe pa licencë. Ndërsa kushtet e punës për minatorët lënë shumë për të dëshiruar, pasi koncensionari, në vijimësi ka shfrytëzuar rezervat e gatshme të mineralit dhe nuk ka investuar asnjë qindarkë për galeritë e minierës. *Fotot: H. Likdisha*



Rruga e Arbërit nr. 82

dëshmi



**Sipas bisedës me Ramadan Guzja, minatori më i vjetër i minierës**



**Ramadan Guzja : Miniera e kromit në këtë 65 vjetor është shëndruar në një kërmë të shqyer nga ujqërit, të cilët të uritur përpiqen të marrin çdo rezervë të gatshme të përgatitur nga puna e mundi i bashkëqytetarve të mi, të cilët në këtë arenë lufte për mbi jetesë nxjerrin fëmijët, gratë e invalidët për të mbledhur krom nëpër stogje që të mund të sigurojnë bukën e gojës.**

Nga **YMER STOJKU**

# Një jetë në galeri...

Miniera e Kromit te Bulqizë me date 18 Shkurt 2013 mbush plotë 65 vjet nga hapjes e saj, që përkon me 65 vjetorin e themelimit të qytetit të Bulqizës. Në këtë minerë kanë punuar shumë minatorë, por një nga më të spikaturve është edhe Ramadan Hysen Guzja, nga fshati Çernenë i krahinës së Maqellarës të Qarkut të Dibres. Ramadani ka lindur me 07.05. 1922, në një familje të varfër fshatare, por me tradita të mëdha atdhetare. Arsimin fillor e kreu në Tiranë në vitet 1934 – 1938 pranë familjes të njohur dibrane Jegeni, të cilët ishin vendosur në Tiranë që në vitin 1920. Më pas u punësua çirak në Tiranë, ku edhe vazhdoj arsimin 7 vjeçar. Në vitin 1946 kreu shërbimin ushtarak dhe u inkuadrua në brigadat e rinisë për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta, duke punuar vullnetar për ndërtimin e rrugës Gramsh – Lezhan, Berat – Çorovodë, hekurudhën Peqin – Elbasan, ku përvetsoi profesionin e minatorit.

Në vitin 1950, dy vjet pas fillimit të punimeve të Minierë së Kromit Bulqizë, organizoj një grup të rinjsh dhe filloj punën në këtë minierë si minator dhe drejtues i kësaj brigade të rinjsh nga Maqellara. Që nga ky vit e deri më sot banon në Qytetin e Bulqizës.

Ramadani ka punuar në të gjitha profesionet që dikton nevoja e prodhimit të kromit që nga minatori, vagonisti, brigadieri, shefi i zonës, shefi i cilësisë, përgjegjës i prodhimit, përgjegjës i eksportit, duke qenë një nga shembujt e shkëlqyer të punëtorit pararojë, mjeshtrit të madh të punës e dijes, drejtuesit që udhëhiqte gjithmonë më shembullin personal, i njeriut që e donin e dhe e duan e respektojnë qytetarët të tijë edhe sot në moshën 91 vjeçare.

Siç dihet zbulimin e kromit në territorin e Bulqizës u bë rastësisht gjatë pushtimit italian në vitet e '40, ndërsa shfrytëzimi i minierës nisi pak vite pas çlirimit. Në fillim të vitit 1940, Hamit Duriçi, banor i fshatit Vajkali, ndërsa u punonte tokën, gjeti një gur të zi me një shkëlqim metalik, më i rëndë se gurët e tjerë. Ai dorëzoi atë tek oficerët italianë që shërbenin në atë zonë. Italianët filluan të mbledhin krom në sipërfaqe të fushës, dhe transportonin atë me mushka deri në Qafë të Dushkut, në rrugën që kish filluar të ndërtohet në ato kohë, e prej aty nëpërmjet portit të Durrësit eksportohej për në Itali.

Miniera e Kromit të Bulqizës filloi punën, për nxjerrjen e kromit, më 18 shkurt të vitit 1948, kur u bë shpërthimi i parë i minave, nga një grup minatorësh të ardhur nga Rubiku, të gjithë djem të ri si Dodë Preng Gjeta, Pal Mark Deda, Kolë Përdoçi, etj , pasi kishin përvojë nga puna në minierat e Bakrit të Mirditës. Barakat e para për strehimin e punëtorëve, shënuan edhe fillimin e ngritjes së Qytetit të Bulqizës, që u vendosën në pjesën jugore të Fushës së Vajkalit, në afërsi të punimeve, që bëheshin për nxjerjen e mineralit të kromit nën drejtimin e teknikut të parë të minierës Dodë Preng Gjeta.

Më pas, ditë pas dite e vit pas viti, u rrit kjo minierë, e bashkë me të edhe qyteti i Bulqizës, u rrit duke marrë përmasa më të mëdha e rëndësi të veçantë për ekonominë e Shqipërisë. Disa nga punëtorët, strehuan në barakat e ngritura edhe familjet e tyre, në kushte të vështira, duke u bërë banorët e parë të këtij qyteti. E kështu edhe Ramadan Guzja u bë një nga qytetarët e parë të kësaj qendre punëtore dhe industriale që shumë shpejt do të bëhej një nga më të rëndësishmet e vëndit.

Vitet e para të punës në këtë minierë ishin shumë të vështira – tregon minatori 91 vjeçar. Mjetet e punesë ishin kazmat, lopatat, tezgat, karrocat e dorës, qesqite e varet. Vetëm pasi avancuan punimet në thellësi erdhen vagonat, kandilët e karbitit dhe martelët. Kushtet e punës dhe të jetesës ishin tepër të vështira, nuk behej fjalë për impiante ajrimi e kompresor ajri, për shina e elektovoz. Jetonim në baraka prej dërase me kushte të vështira higjeno-sanitare.

Nisur nga rëndësia e madhe ekonomike që kish minerali i kromit për ekonomin e vendit shumë shpejtë filloj ndërtimi i qytetit dhe modernizimi i nxjerrjes së kromit, së bashku me këtë u përmirësua jetesa e punëtorëve dhe banorë të saj. Një ndihmës të madhe në zhvillimin e minierës dhe rritjen e nivelit kulturor të kësaj qendre të re punëtore kanë dhënë personeli inxhinjero- teknik nga gjithë Shqipëria të shkolluar brenda dhe jashtë vëndit. Më kanë mbetur në mëndje inxhinjerët Todo Mnaço, Sinan Xhemili, Niko Lulo, Jorgo Kola, Martin Cukalla, Bashkim Lleshi, Bujar Pata, Llambi Gegprifti, Jashar Dema, Hamza Gura, Fatmir Beqiri e shumë e shumë të tjerë, që krahas projekteve që bënin në zyra , qëndronin në ballë te fronteve të punës, jo vetëm për të nxitur prodhimin, por për të siguruar kushtet e punës dhe jetese të punëtorëve e familjeve të tyre – kujton Ramadani. Erdhi një ditë dhe prodhimi i kromit të pasur arriti deri në 1200 tonë në ditë , dhe qyteti banohej me mbi 10 000 banorë, me dy shkolla të mesme, me spital e një sërë objektesh social kulturore. Por, siç dihej edhe atëherë pjesa më e madhe e të ardhurave të kromit nuk mbetej në Bulqizë, por shkonte në Tiranë. Minatorët shpesh herë shprehnin pa kënaqësi të cilat në vitet 90 morën trajtën e demonstratave me parullën ku kanë vajtur paratë tona: - Me shpresë e besim të madh në sistemin demokratik, filloj një fryme e re e cila shumë shpejt ç'thuri disiplinën e punës, nxiti vjedhjet e korrupsionin, deri sa e çoj minierën e Kromit që e hapëm dhe zhvilluam me mund, djers dhe gjak (deri me tani kanë humbur jetën 238 minatorë), në një gërmadhë që të vjen keq kur e sheh nëpër kronikat televizive, dhe qytetin tonë në një nga qytetet më të varfëra të Shqipërisë. Për ta nxer nga bataku ku e zhytën "demokratët e rinjë", miniera u dha me koncesion një firme të huaj Italiane Darfo, firmë e cila deri atëherë blinte kormin tonë dhe e shkrinte në Itali. Ajo erdhi me premtimin për të bërë investime të mëdha për zhvillimin e minierës, por fatkeqësisht vetëm shfrytëzoj rezervat e gatshme dhe pasi fitoj disa miliona dollar e shiti koncesionin tek firma Austriake ACR, e cila njëlloj si Darfo shfrytëzoj sa mundi, dhe e gjendur nën presionin e shumë subjekteve private të liçensuar dhe pa liçensuar, e rishiti koncesionin një firme tjetër. Në këtë mënyrë miniera e kromit në këtë 65 vjetor është shëndruar në një kërmë të shqyer nga ujqërit, të cilët të uritur përpiqen të marrin çdo rezervë të gatshme të përgatitur nga puna e mundi i bashkqëqytetarve të mi të cilët në këtë arenë lufte për mbi jetesë nxjeri fëmijët, gratë e invalidët për të mbledhur krom nëpër stogje që të mund të sigurojnë bukën e gojës.

Fatkeqësisht – shton Ramadani, me këtë situatë janë pajtuar edhe ato që në vitet 90 u ngritën dhe kërkonin: - ku kanë vajtur parat tona?, Një pjesë e tyre janë liçensuar e kanë marrë nga një copë, një pjesë tjetër janë larguar të zhgënjyer, e pjesa më e madhe po e shohim si po rrënohet çdo ditë pararoja e industrisë shqiptare, Ndërmarrja që jepte 30% të produktit të përgjithshëm industrial të vendit, ndërkohë që dihet se deri më tani është marrë vetëm 50% e rezervave të zbuluara deri më vitet 90 të shekullit të kaluar.

Së bashku me minierën, çdo ditë po rrënohet edhe qyteti i Bulqizës. Pa punësia, grindjet midis firmave rivale, rritja e kriminalitetit, shtuar këtu edhe klimën e ftohtë e të ashpër , bëjnë që njerëzit çdo ditë të largohen drejtë zonës së ulët bregdetare.

nostalgji



© Foto: Argjent R. Kaba

**Qindra mijëra metra katrorë qilima e tapisona të llojeve të ndryshme në kulmin e zhvillimit shiteshin në 34 dyqane në Kosovë e 7 dyqane në Maqedoni.**
**Me fillimin e aplikimit të ekonomisë së tregut, edhe punëtorët e këtij kombinati bënë vlerësimin e kapitalit dhe përgatitën dokumentacionin e nevojshëm që ia dërguan Agjensionit për privatizim. Por këta punëtorë nuk mundën të jenë aksionerë, pasi rrogat e tyre ishin nën mesataren e garantuar dhe mbi bazën e ligjit nuk mund të blenim aksione.**

# Na ishte njëherë një Kombinat i Qilimave...

*Nga* **Rexhep TORTE**

***Në mungesë të donatorëve dhe financuesve të jashtëm, obligimet bankare sëbashku me borxhet dhe kamatat arritën afër 500 mijë euro, gjë që pas 58 vitesh që nga themelimi, solli vdekjen e tërësishme të këtij kombinati të qilimave që tashmë i mbeti historisë, si sinonim i shkatërrimit të ekonomisë dibrane të ngritur me aq mund e djersë.***

Garniturë e suksesshme vendore mund të quhet vetëm ajo e cila ka zhvilluar ekonominë dhe ka siguruar vende pune për popullatën, e sidomos për të rinjtë. Nuk ka gjë më dëshpëruese për të rinjtë, të cilët në mungesë të punësimit kalojnë kohën në gjumë ose duke bredhur rrugëve pa shpresë.

Me ardhjen e ekonomisë së tregut u shuan edhe shumë subjekte ekonomike, u mbyllën shumë vende pune dhe erdhi një periudhë e vështirë për popullatën.

Kështu ndodhi edhe në Dibër të Madhe kur vite më parë u shua dhe u fshi nga faqja e dheut Kombinati i Qilimave në Dibër të Madhe, njëri nga objektet industriale ekonomike që në dekadat e shkuara i jepte gjallëri qytetit. Ishte objekti ku gjatë kulmit të zhvillimit të tij punonin afër 900 punëtorë. Ishte kombinati që me një punësim kaq masiv e mbronte Dibrën e Madhe nga turpi i varfërisë.

Ta marrësh si ta marrësh, periudha e lavdishme e Dibrës së Madhe mbetet fillim shekulli i 20-të, kur ky qytet ishte qendër e Prefekturës me nënprefekturat e Matit, Peshkopisë dhe Rekës, kur lulëzonin zejet dhe prodhimtaria që nga ndërtimi, drugdhendja e deri te përpunimi i armëve, rrobave, këpucëve dhe prodhimeve farmaceutike, kur Dibra e Madhe ia kalonte edhe Prizrenit e Prishtinës.

Proverbi popullor shumë i dëgjuar me famë se, "Po të digjet Stambolli do ta ndërtojë Dibra, e po të digjet Dibra s'ka kush ta ndërtojë", sot ka mbetur vetëm një e vërtetë historike, që dëshmonte fuqinë dhe aftësinë ekonomike të dibranëve.

Për fat të keq dibranët sot janë dëshmitarë se në orët e mëngjesit dhe të pasditës rrugët e Dibrës së Madhe janë të shkreta, sepse ish objektet industriale gati janë shkatërruar.

Fabrikat dhe repartet ekonomike të prodhimit ishin ato që i jepnin gjallëri qytetit, që mundësonin rrugët të gumëzhinin nga njerëzit, para dite kur shkonin në punë dhe pas dite kur ktheheshin nga puna.

Viteve të fundit u shua dhe u fshi nga faqja e dheut Kombinati i Qilimave në Dibër, njëri nga objektet industriale ekonomike që në dekadat e shkuara i jepte gjallëri qytetit. Ishte objekti ku gjatë kulmit të zhvillimit punonin afër 900 punëtorë. Ishte kombinati që me një punësim kaq masiv e mbronte Dibrën nga turpi i varfërisë.

Me lejimin e shuarjes së këtij kombinati të qilimave dështuan tërë dibranët, dështoi pushteti vendor,dështuan deputetët dibranë që nuk arritën ta shpëtojnë, dështoi edhe mërgata dibrane, e cila për një kohë të gjatë sa ishte në shitje ky kombinat me një çmim shumë të leverdishëm, nuk vuri dorë që t'i aktivizojë të paktën disa nga repartet e shumta për prodhimin e qilimave makineritë dhe atyre dore që punoheshin me endjen në vek.

Këtë kombinat më në fund e bleu Korporata e Gjipsit "Knauf Radika" dhe brenda disa muajve i shiti të gjitha makineritë si hekurishte dhe shkatërroi tërë fabrikën, në mënyrë që këto hapësira t'i përdorën për programet e veta prodhuese dhe zhvillimore.

Shumë qytetarë më të moshuar plot nostalgji, thonë se, "kur punonte kombinati i qilimave gati tërë qyteti merrte frymë më lirshëm, edhe pse rrogat nuk ishin shumë të larta, megjithatë atë ditë që merreshin rrogat mbusheshin dyqanet plot me blerës dhe gëzoheshin të gjithë. Nëntëqind familje jetonin dhe shkollonin fëmijët e tyre falë këtij kombinati".

Me trokatjen e ekonomisë së tregut dhe me ardhjen e demokracisë filloi të pushojë edhe gumëzhimi i makinave prodhuese nëpër shumë reparte, duke iu nënshtruar dhëmbit të kohës dhe amortizimit.

Ky objekt industrial zanafillën e ka qysh në vitin 1948, kur punoheshin qilimat e dëgjuar persianë, ndërsa si kolektiv punues me organet e tij punë drejtuese ka filluar punën në vitet 1952-1954.

Në kulmin e zhvillimit të tij arriti të ketë afër 10 mijë metra katrorë sipërfaqe të mbuluar repartesh prodhimi.

Në këtë gjigant industrial me makina të tipit gjerman dhe anglez, funksiononin reparti i tjerrtores, ku punonin sektori i ngjyrosjes,tjerrtorja strajgan dhe gjysëmkrehja. Reparti i endjes, ku punonin makinat e endjes, ato klasike, tebris, supertebris dhe aksminster, ku prodhoheshin katër lloje qilimash shumë të kërkuar në treg. Reparti i finalizimit, ku bëhej qethja, lateksimi dhe hekurosja. Reparti i taftingut ku prodhoheshin llojet e tapisonave. Reparti për prodhimin e qilimave dore, dhe reparti ku kryheshin punët përfundimtare të prodhimit, kontrolli dhe përmirësimi i ndonjë gabimi gjatë fazës së prodhimit.

Në këtë kombinat funksiononte edhe konfeksioni gjysëm i rëndë ku prodhoheshin xhupat, veshjet sportive, farmerkat dhe këmishat.

Të gjitha këto reparte ishin të kompletuara me makineri dhe punëtorë që prodhonin qilima dhe tapisona aksminster dhe jamboli leshi shumë cilësorë dhe të kërkuar në treg.

Qindra mijëra metra katrorë qilima e tapisona të llojeve të ndryshme në kulmin e zhvillimit shiteshin në 34 dyqane në Kosovë e 7 dyqane në Maqedoni.

Me fillimin e aplikimit të ekonomisë së tregut, edhe punëtorët e këtij kombinati bënë vlerësimin e kapitalit dhe përgatitën dokumentacionin e nevojshëm që ia dërguan Agjensionit për privatizim. Por këta punëtorë nuk mundën të jenë aksionerë, pasi rrogat e tyre ishin nën mesataren e garantuar dhe mbi bazën e ligjit nuk mund të blenim aksione.

Megjithatë sipas kushteve aktuale, punëtorëve të këtij ish-kombinati asokohe iu mundësua ta blejnë 30 përqind të kapitalit, me kusht që ta paguajmë më vonë,e duke llogaritur edhe 15 përqind të aksioneve nga personat e pensionuar,shpresonin se do ta arrijnë vlerën prej 45 përqind të kapitalit, mirëpo për fat të keq asgjë nuk u realizua.

Në mungesë të donatorëve dhe financuesve të jashtëm, obligimet bankare sëbashku me borxhet dhe kamatat arritën afër 500 mijë euro, gjë që pas 58 vitesh që nga themelimi, solli vdekjen e tërësishme të këtij kombinati të qilimave që tashmë i mbeti historisë, si sinonim i shkatërrimit të ekonomisë dibrane të ngritur me aq mund e djersë.

Rruga e Arbërit nr. 82

# Xhoxhet e Lugjej



*Lagjja e Xhoxhe. © Fotot: I Dervishi*

*Nga*: **ILMI DERVISHI**

Nëse do ta marrim si një vijë të drejtë rrjedhjen e Drinit të Zi, ky do të ishte kufiri se ndanë Lugjejt në Zall-dardhë.

Derdhja e përroit të Topuzëve në Dri është fillimi që Lugjejt ndahen në Fushë Çidhën, duke u ngjitur pyllit të Lugjepravës do kalonin në Lisibelenë, nëpër Gjorde te kroi i kuq, do ulemi poshtë rrëskilës nën kullën e Dik Xhelilit, do të dalim te Prroi i thatë ku ndahemi në Livadhin e Fanës, te Gurët e Sufës e duke zbritur përroit të thatë ku ndahet me Imeret dhe derdhja e përroit në Dri shënon dhe kufirin ndarës, duke formuar një gjysmë rrethi. Ky është fshati Lugjej, që dallon nga të tjerët për bukuritë natyrore, me fusha e kodra, me pyje e kullota, me ujë të pijshëm dhe vaditës që ja shton jo vetëm begatuinë por edhe bukurinë.

Lugjet, në regjistrimet e vitit 1467, në Tefterin Turk figuron me emrin Lugan. Po në këtë vit ky fshat përbëhej nga 8 shtëpi në kryefamiljar Shtjefën Korrteci, Gjon Kotorri, Gjin Luga, Gjon Lundia, Pal Sundia, Pip Skela dhe Laj Liti.

Në vitin 1704, studiuesi i kishave gjermani Berkl duke ju referuar Dibrës do shkruante. "Në Lugjej ndodhet një kishë që ju shërben 5 shtëpive katolike më 7 frymë dhe 4 shtëpive myslimane me 19 frymë "Sipas Berklit, në Lugjej ishin 9 familje me 26 frymë e në një shumicë myslimane se ishte nën presionin e vazhdueshëm të Perandorisë Osmane shuam familje po myslimanizoheshin.

Po të dalësh matanë Drinit e të hedhësh një sy Lugjej, nga përroi i Topuze dhe te Prroi i Imere, si kufi ndarës, do shikosh që derdhja e Përroit të Madh është mesi që e ndan gati në mënyrë të barabartë në dy pjesë jo vetëm si sipërfaqe, por në një aërsi po të barabartë tokat më të mira në si Shatorret dhe Nebetat por edhe pyet e kullotat. E gjitha vija ndarëse ku kalon përroi i madh që nga burimi i tij te kroi i kuq në kufi me Palamanin e deri në derdhjen në Dri është kufiri që ndan Lugjejt në Xhoxhe.

Të gjithë studimet, por edhe autorët e mëvonshëm që kanë shkruar libra e monografi për Dardhën dhe Lugjejt përmendet kisha e Lugjej si vend banimi i hershëm, rrënojat e të cilës janë edhe sot kur e gjithë sipërfaqja quhet "Kishë" por në asnjë rast nuk jepet shpjegimi pse u quajt Lugjej. Citoj këtu librin "Dardha e Dibrës" të Hysen Ndreut,



*Shkolla në Xhoxhe*



*Pamje nga rrafshja e Xhoxhe*



*Shtëpi e braktisur në Xhoxhe*

## vendlindja

"Nëntë male e një bajrak" të Hysen Dervishit, "Bab Daliu me djem e nipa" të Islam Dervishi. "Në kërkim të një fisi" Qatip Cala, "Në vendlindje" Selim Pira etj.

Në vitet '70 kur po bëheshin në mënyrë masive histokuri i fshatrave në shënimet e tij Nuri Cala ka një frazë që shpreh në oda burrash dhe diskutohej nga burra të mençur të rritur nëpër mexhlise si Sait Lushi, Selman Cala, Zaim Dervishi, Elez Pira apo Suf Gjoka dhe pranonin si variantin e dy vëllezërve Luigji dhe Xhoxhi që pas daljes së dimrit nga shtrati i lumit, përmbyt toka e pasuri total, shkuli varrezat e Xhoxhe që dhe sot përdoret si epitet "Varret Xhxohe" dhe u larguan.

Kur Luca u bë shtëpi e madhe e "Rustan Luca u bë në dhjetë djem... Imeri, Hasani, Selmani dhe Hazizi... duke tërhequr njëritjetrin në plaçka, me gra e fëmijë për dore, një ditë kalojnë Drinin dhe shkojnë e vendosen në ... Lugjej". Dardha e Dibrës H. Ndreu f. 46.

Më vonë Luca mori dhe vëllain e tij Gjokën e duke pranuar dhe Pirën si vëlla trojesh me pjesë të barabartë, duke punuar dhe jetuar në harmoni vëllezërish deri në ditët tona.

**PO XHOXHET?**

I pari që kalon në Xhoxhe ishte Dogje Boça i ardhur rreth viteve 1480 në Qa të Dardhës nga Kastrati i Shkodrës. Në vitet 1530-1850 kur në Dardhë kthimi me forcë nga të kishte në besimin mysliman kishte përfunduar, dhe në harkun kohor të këtyre viteve Dogjë Boçes i lindi djali i vetëm i tij që mori emrin Dervishi.

Me kalimin në Xhoxhe Dogja me të birin Dervishin zunë tokat më të mira me ujë vaditës dhe me sy të pijshëm. Pati një zhvillim ekonomik e blegtoral. Dervishi ishte ndër të parët që ndërtoi shtëpinë trekatëshe me gurë.

"Dogjë Boça me djalin e Dervishin ngrihet nga Qani i Lashkizës dhe shkon e vendosët në lagjen Xhoxhe të fshatit Lugjej..." H. Ndreu, Dardha e Dibrës, f. 164.

Më vonë Derivshi mori Lushin e afroi pranë vetes duke i dhënë toka të mira, ndërsa Cala që erdhi më vonë mori toka më pak prodhimore dhe të pjerrëta. Ndër toponimet më të hershme janë Lagjja Xhoshe, emërtim që ruhet edhe sot, Rrafshet e Xhoxhe ku kanë toka Dervishi, Lushi dhe Cala, Kroi i Katrajnës, ku sipas Hysen Dervishit një vajzë me emrin Katrina e gjeti burimin dhe varret e Xhoxhe, diku në breg të Drinit, qe dalja nga shtrati i lumit i prishi dhe shpërndau ... duke lënë një pamje të keqe dhe duke u përdor edhe sot si fjalë fyese si varret e Xhoxhe.

Sipas të gjitha burimeve të shkruar të thëna nëpër dhomën e mexhlise, pas Dervishit, Lushit e Calës as një pjesëtar familje nuk ka marrë emër katolik, e detyrimisht as Katerina. Që në fillimin e jetës në Xhoxhe duke patur dhe mësimin e hidhur të "Varreve të Xhoxhe", Dervishi, Cala, Lushi caktuan një parcelë në Rrafshe të Xhoxhe për varreza dhe asnjëherë nuk jam quajtur varret e Xhoxhe, por varret në Rrafshe të Xhoxhe. Ku të tre fiset kanë dhe vendin e caktuar të tyre.

Marrëdhëniet miqësore të hershme në Xhoxhe e Lugjej, që vazhdon edhe sot, e hedh poshtë mendimin se Lugjej janë pasardhës të Luigjit dhe Xhoxhet të Xhohiut, por janë të ardhur në Lugjej dhe në Xhoxhe.

Njerëz punëtor por dhe trima. Në gjitha betejat që në luftën e Gjoricës në vitin 1844 kundër Hajredin Pashës ku ishin pjesëmarrës Vesel Dervishi, Selman Cala i parë në kryengritjen e Shkodrës 1831-39 kundër Tanzimatit turk Rexhë Cala më 1912 në mbrojtje të Shkodrës nga malazezët. Ali Lushin në mbrojtje të trojeve shqiptare Plavë-Guci e Ulqin në vitet 1878-1881 Dali Dervishi nga një burrë për shtëpi në luftën kundër serbëve më 1912 në Kolesian e në shumë ngjarje e përpjekjeve për mbrojtjen e vendit.

vendlindja



*Në foto:* **Lugina e fshatit Zogje.**Kodra e Xhipit, Bokat, Përroi Rasate, Udha e Lurës, Livadhet e Epra,Mali,
Në horizont: Qafa Mollës, Sharra Lik Mehmetit, Qafa Fangut, Shullani i ri.

*Foto poshtë:* **Tokat e fshatit** Gropa e Zogje, Udha e Madhe, Ndërvneshtet, Trojzat, Fanxhest, Arrnajcat, Lgjatat, Rrethi i Sharrës, Sharra e Zogje që mbyll luginën.
*Fotot: © Bashkim Qamil Lleshi Maj 2005*

# Të dhëna të hershme për prejardhjen e fshatit Zogje

Nga: **BASHKIM LLESHI**

Në qendër të Grykës së Vogël, ndodhet një luginë e ngushtë që quhet Gropa e Zogje, e rrethuar nga të gjitha anët me kodra e male vendoset fshati me të njëjtin emër, Zogje i Dibrës.

Të dhënat e herëshme flasin se emri i vjetër i këtij fshati quhej "Gropë" *(sipas regjistrimit Austro-Hungarez të vitit 1916,* Kristo Frashëri 2012 *)* ose "Shishkë" *(Sipas tregimeve gojore të* Aqif Lleshit). Me ardhjen në fshat të Gjin Zogjut nga Kthella e Epërme e Mirditës, me tre djemtë e tij; Markun, Lekën e Lleshin, fshatit i mbeti emri Zogje; Tre dejmtë u bënë familje më vehte u shtuan duke krijuar tre fise: Markja, Leka e LLeshi; Rrënjët i kanë në Zogje, ku deri në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar përbënin pjesën më të madhe të fshatit. Me shtimin e tyre para viteve nëntëqintë e më vonë u shpërndanë në gjithë Dibrën në Okshatinë, Gjoricë, Çerenec, Reshan, Banjisht, Bofmovë e Dibër të Madhe. Pas luftës së dytë botërore e sidomos pas viteve nëntëdhjetë, shumë familje të këtyre fiseve kanë migruar në Tiranë, Laç, Durrës etj. një pjesë kanë emigruar edhe jashtë Shqipërisë në shtete të ndryshme të Evropës e deri në Amerikë.

Sipas të dhënave gojore të hershme të trasmetuara brez pas brezi, të marra nga pleqtë më të vjetër të fshatit Zogje (Aqif Lleshi, Murat Daci, Man Kaja, Ali Leka, etj.) Zogju me të tre djemtë e tij, Markun, Lekën e Lleshin kanë migruar nga zona e Mirditës për në zonën e Dibrës për një jetë më të mirë, ose për çeshtje hasmërie dhe pasi ecën në këmbë një ditë e një natë, rruga i zbriti në stanet e Shishkës (sot Zogje) duke menduar se ranë në fushën e Dibrës.

Haxhi Lleshi në librin, Vite, Njerëz, Ngjarje, shkruan: "*..Të parët e familjes tonë kishin ardhur nga Kthella e Epërme e Mirditës dhe ishin vendosur në një grykë midis malesh e zabelesh duke krijuar fshatin që me sa duket emrin e ka marrë nga i pari i fisit, Zogu..*". (Haxhi Lleshi 1996,faqe 9)

Në zonën e Lurës të cilën e njihnin se e kishin më afër dhe kishin miqësi, ato kanë udhëtuar ditën, nga Krej Lura, ose Lajthiza, kapërcyen lumin Molla e Lurës, në Pregjë Lurë, Lurë të Vjetër e Fushë Lurë, në Borije Lurë, në qafën e Gur Lurës, poshtë liqejve të Lurës, tek Guri i Vashës në Qafën e Lukanit, duke zbritur në një terren të pa njohur natën, në krahinën e Katër Grykëve, në Lukan, Lunar e Selishtë. Nepermjet rruges nga Prati, Xhiteca (Qyteza) e Kzane, kroi i Bukës, Qaf Mollë u ulën në Xhitecën e Sute në livadhe të Epra. Janë ndaluar për të pushuar dhe kur ka zbardhur dita kanë parë rrugën nga kanë zbritur duke thënë, se kjo është Udha e Lurës nga erdhëm ne. Edhe sot pas mbi 500 vjet, kjo rrugë quhet Udha e Lurës. Ajo në fakt është udha që në fillim të çon në Gjuras, sa kalon Qafën e Mollës, pastaj të dërgon në Prat të Selishtës, në Selishtë, Lunar, Qaf Murrë e Lukan, e pasi kalon Lukanin, futet në zonën e Lurës.

Udha e Lurës është një nga toponimet më të rëndësishme që tregon prejardhjen e Zogjut i cili u vendos në Zogje dhe fshati mori emrin e tij.

Ka edhe mendime të tjera: 1. Zogju e ka origjinën nga Malësia e Dukagjinit, 2. Krahina e Hasit të Gjakovës. Ndoshta mund të jetë origjina e herëshme e tij në Dukagjin ose në Malësinë e Gjakovës, siç del sot origjina e herëshme e Markagjonëve të Mirditës nga Hasi.(Shefqet Hoxha 2007). Të parët e Zogjut, ndoshta, për hasmëri mund të jenë shpërngulur në Mirditë e më vonë kanë bërë një migrim të dytë për një jetë më të mirë në Dibër.

Në librin "Jeta dhe veprimtaria e Aqif Lleshit" (Moisi Murra 2005,faqe 9) shkruan : *".. Ka shumë mundësi që kryefamiljari Nikoll Zoku i Kovashicës i vitit 1467… të ketë lënë Kovashicën dhe të jetë ngjitur pak më lart… duke i dhënë dhe emrin këtij vendi që më vonë nga Zok(Zog) do të shndërrohej në Zogje… "*

Kjo e dhënë është më pak e besueshme për arësye se në rradhë të parë, mbiemri "Zoku" i Nikollës në Kovashicë, mund të jetë përkthyer gabim në Defterin turk të vitit 1467(Hilmi Sadikaj faqe 14), sepse në përkthimin e plotë, maqedonisht të këtij Dokumeti (Grup autorësh 2000, faqe 305) ky emër është përkthyer : *(Hikoˆa Poko=Nikolla Roko),* pra mbiemri "Roko" është vështirë të shndrrohet në "Zoku".

Fatkeqësisht ky gabim është bartur dhe në përkthimin e fundit në shqip të vitit 2011 "Dibra në Defterët Osmane" (1467,1583) me autorë Zyber Gjoni e Haki Përnezha ku mbiemri "Roko" i Nikollës është përkthyer mirë (Poko=Roko), por gabimisht është vënë në kllapa "Zoku" , Roko(Zoku) ashtu si në përkthimin në shqip nga Hilmi Sadikaj. *(Zyber Gjoni, Haki Përnezha 2011, faqe 261)*

Edhe në përkthimin në maqedonisht të Dokumentit turk të vitit 1583 vazhdojnë në Kovashicë banorë me emrin dhe mbiemrin Nikolla si : *"Hikoˆa Pako(Rako), Nikolla Ivanko, Ivanko Nikolla, Jofko Nikolla, Dobre Nikolla, Ycko Nikolla," etj.* (Aleksandër Stojanovski 2000, faqe 468), ç'ka tregon se Nikolla nuk është larguar nga Kovashica. Kjo e dhënë bëhet pak e besueshme edhe sepse në teritorin e fshatit Zogje nuk ka asnjë toponim me emrin Nikoll, si dhe historikisht, migrimi, pothuajse i të gjithë banorëve të fshatrave të sipërme, ashtu dhe i banorëve të Kovashicës, është bërë për në fshatrat e mëposhtëme, për tju afruar më shumë fushës së Dibrës dhe jo në drejtim të malit, për tju larguar asaj.

Prof. Dr. Mark Tirta në Gazetën "Rruga e Arbërit"nr. 5(25) të muajit Maj 2008 në artikullin Mirdita dhe Dibra shkruan: *".. Në Grykë të Vogël, Leka, Lleshi, Markja, janë me prejardhje nga Kurbneshi i Selitës. I jati i Markut ka qenë quajtur Zog, pra nga Zogajt e Kurbneshit. Prej tyre është formuar edhe fshati Zogjaj i Dibrës…"*

Ardhja e Zogjut me të tre djemtë do të ketë ndodhur përpara rregjistrimit turk të vitit 1583, sepse në këtë kohë Zogju ishte fuqizuar, djemtë ishin martuar, kishin krijuar familje dhe më vonë u krijuan fise me vehte, duke mos pranuar të jepnin taksa e nizame për regjimin Osman. Në këtë kohë fshati nuk ruante më emrin e vjetër "Gropë" ose "Shishkë" por quhej Zogje dhe ndoshta për këto arësye emri i fshatit Zogje, ashtu si dhe emri i fshatit Kastriot, ku jetonin banorë e fise vendase ortodoksë e katolikë, të padëshëruar për Turqit, që nuk pranonin të paguanin taksa, nuk figurojnë në Defterin Turk të vitit 1467 dhe në atë të vitit 1583.

Zogju gjeti në këtë fshat fiset Suti, Kaja, Lila e Mena. Banorët e pranuan Zogjun me të tre djemtë, i cili më vonë me punë u fuqizua aq sa edhe fshati mori emrin e tij Zogje dhe tre djemtë e tij u bënë tre fise, Markja, Leka e Lleshi.

Nga gërmimet e herëshme në veri perëndim të fshatit, në vendin e quajtur Xhiteca e Sute (Qyteza e Sute) në livadhet e Epra, ngjitur me Kuçlat e Shalave, janë gjetur mure të vjetra që dëshmojnë për një qyezë të herëshme, të datuara si të shekullit III-IV-tër të erës tonë, e cila lidhej me rrugë të herëshme me Xhitecën e Gjurasit (Qyteza e Gjurasit) në veri lindje dhe Qytezën e Sofraçanit në jug perëndim.(Iljaz Kaca, 2003) Mure të vjetra janë gjetur edhe tek Ara e Madhe, në lindje të së cilës kalon Udha e Lurës, ku mendohet se fshati i ka patur shtëpitë në këtë zonë në kohët e herëshme.

Gërmimet e mëtejshme në muret e vjetra të Xhitecës së Sute e Arës së Madhe, si dhe në kodrën e Kishës e Malin e Kishës, etj. do të pasurojnë më tej hulumtimet e nisura nga studjuesi i vjetër Iljaz Kaca dhe veprën shkecore "Prehistoria e Dibrës" të arkeologut të shquar dibran Adem Bunguri. (Iljaz Kaca 2003, Adem Bunguri 2010)



Nga toponimet e vjetra mendohet, se më i vjetri katolik të ketë qenë Gjini. Kjo dëshmohet nga toponimi "Sharra e Bab Gjinit" në livadhe të Care. Kjo sharrë(zabel) ndodhet mbi trojet e vjetra të Lleshe dhe ngjitur me livadhin e Xhemahil Lleshit mbi Gjurrat e Lleshe.

Gjini mund të ketë qenë babai i Markut, Lekës dhe Lleshit. Kur i ka ndarë djemtë, sipas zakonit te vjetër ai ka qëndruar me djalin më të vogël, Lleshin, prandaj dhe zabeli i quajtur "Sharra e Bab Gjinit" në livadhe të Care është ngjitur me trojet e vjetra të Lleshe ku ka patur shtëpinë Xhem Ram Lleshi, nga trungu i Ram Lleshit të vjetër, që më vonë ka zbritur në Gjoricë.

Gjin Zogju me tre djemtë, Markun, Lekën e Lleshin u fuqizuan dhe zunë pjesën më të madhe të tokave arë dhe zabeleve të fshatit Gropë (*Gropa e Zogje B.Ll.).*

Këtë e tregojnë toponimet e vjetra që kanë ngelur edhe sot si: Lleshet e Gjurit e Shkrepi i Lleshe, nën kodër të Vishkullit, Hurdha e Lleshit poshtë Teqes së Bllacës, Gjurrat e Lleshe, Trojet e Lleshe në Livadhe të Care, Sharra e Leke në Livadhe të Epra, Livadhi i Marke në mal, Ara e Zogjut, Sheshet e Lleshe, Rrugajat e Lleshe, mbi qafën e Shtushanit, në afërsi të Majeve sipër Bokave të Zogje etj.

Ka edhe emërtime me emra katolikë siç vërtetohet nga toponimet si : Ara e Lloshës mbi Livadh të Marke në mal, Sharra e Kol Sutit në Livadhe të Epra, Ara e Palit mbi Qaf Mollë, Sharra e Bab Gjinit, Maja e Kishës, Kodra e Kishës etj.

*Referimet:*


- Adem Bunguri (2010) Prehistoria e Dibrës. Monografi, Tiranë 2010
- Aleksadër Stojanovski (2000) Turski Dokumenti od 1583 godina, Skopje 2000
- Aqif Lleshi (1980) Kujtime dhënë Bashkim Qamil Lleshit në Tiranë, Dorëshkrim, Tiranë 1980.
- Bashkim Lleshi(2008) Djemte e Llesheve të Gjurit. Libër Tiranë 2008
- Bashkim Lleshi(2012) Fisi Lleshi i Zogjeve të Dibrës. Libër Tiranë 2012
- Grup autorësh (2000) Turski Dokumenti od 1467 godina, Skopje 2000
- Haxhi Lleshi (1996) "Vite, Njerëz, Ngjarje." Libër me kujtime, Tiranë 1996
- Hilmi Sadikaj (1985) Defteri emëror i vilajetit të Dibrës 1467 (Përkthim) Peshkopi 1985
- Iljaz Kaca (2003) " Rrugët e vjetra të Dibrës" Libër, Tiranë 2003
- Mark Tirta (2008) "Mirdita dhe Dibra" Gazeta Rruga e Arbërit 5(25) maj 2008
- Moisi Murra (2005) "Jeta dhe veprimtaria e Aqif Lleshit" libër, Tiranë 2005
- Shefqet Hoxha (2007) "Hasi Tedeli i Kastriotëve" Tiranë 2007
- Zyber Gjoni,Haki Përnezha(2011) "Dibra në Defterët Osmanë (1467,1583) "Volumi I Tiranë 2011

Rruga e Arbërit nr. 82

portret

# Cuca himariote, nuse dhe mësuese në Blliçe

*Nga* **SHAQIR SKARRA**

Atëherë ishim të rinj. Kishim dëgjuar se në fshatin Blliçe bëhej një dasëm disi alla-franga siç i thoshin pleqtë. Një vajzë e re e sapo diplomuar për fizikë vinte nuse nga Himara e largët në fshatin Blliçe. Dy të rinjtë Afroviti Kokuri dhe Shaban Bitri ishin njohur në fakultet dhe kishin thyer çdo lloj tabuje për ato vite. Unë pata fatin të njihem me këtë çift simpatik shumë vite ma vonë kur kishin bërë afro dyzet vite martesë e që të dy ishin bërë gjyshër. Edhe pse "flokët e bardha u kishin qëndisur flokët" e vitet u rëndonin mbi supe ato ishin si ma parë, të qeshur, të lumtur dhe edhe ndonjë çift i ri, i sapo martuar do t'i kishte zili. Po kush është vajza nga zona e Himarës që theu çdo tabu dhe erdhi nuse në Blliçe? Ka lindur në fshatin e bukur Palasë të krahinës së Himarës i cili për hir të pozitës gjeografike ku ndodhet është një ndër fshatrat e Bregut më të lakmueshëm për turistët vendas por dhe të huaj. Ky fshat shtrihet rrëzë malit të Çikës dhe laget nga deti Jon. Arsimin fillor Vita e mbaron në Palasë ku shkolla ndodhej në qendër të fshatit, përballë rrapit 400 vjeçar dhe kishës së Shën Dimitrit. Në të njëjtën shkollë mbaron dhe pjesën e mbetur t ë ciklit 7 vjeçar. Arsimi i mesëm për Vitën ishte dhe fillimi i vështirësive të jetës së saj. Për të përfunduar gjimnazin duhej të udhëtoje nga Palasa në Himarë pasi nuk kishte shkollë të mesme në fshat. Atëherë konvikti ishte vetëm për djem pasi vajzat nuk lejoheshin të qëndronin në konvikt. Kështu që Vita bashkë me motrën e cila sapo kishte mbaruar shkollën pedagogjike dhe ishte emëruar mësuese në njërën nga shkollat fillore të Himarës, marrin të dyja bashkë një shtëpi me qera .Në qershor të vitit 1969 mbaron maturën në gjimnazin "Spiro Gjiknuri me rezultate të shkëlqyera ku prirjet e saj ishin në shkencat ekzakte. Po në këtë vit Vitës i doli e drejta e studimit në fakultetin e shkencave të natyrës në fizikë. Ishin pikërisht vitet studentore në fakultet që vajzës nga Bregu ia ndryshuan rrjedhën e jetës së saj. Po si e kujton Vita këtë periudhë: "Më thotë një shoqe ime se në fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit zhvilloheshin kurse për gjuhën italiane në mënyrë të fshehtë. Mua më kishin tërhequr shumë gjuhët e huaja dhe kështu bashkë me shoqen u nisëm për atje. Pikërisht këtu njoha atë që do bëhej bashkëshorti im. Ishte si të thuash dashuri me shikim të parë, por një dashuri që vërtet u rezistoi sfidave të jetës, një dashuri që nuk mundi ta pengojë as largësia, as besimet e ndryshme fetare dhe as lufta e klasave aq shumë e përhapur në ato vite. Tani vërtet qesh kur e kujtoi por në ato vite, të afërmit e mi u mërzitën shumë kur shkuan vetë në Blliçe për të pyetur për biografinë, dhe u kthyen që andej me një biografi të "nxirë" për kohën". E për Vitën kujtimet e jetës studentore janë të shumta, por më të bukura mbeten domosdo ato pas njohjes me Shabanin, djalin simpatik nga fshati Blliçe që i rrëmbeu zemrën vajzës himarjote. Mes studimesh, provimesh, vështrimesh e buzëqeshjeve të fshehta kaluan vitet studentore. Karrierën si mësuese në fillim e nisi në shkollën 8 vjeçare dhe të mesme në Kuç të rrethit të Vlorës. Edhe gjatë kësaj kohe për Vitën përveç punës si mësuese e re duhej të mbante ende të fshehtë lidhjen e saj me Shabanin, dhe mundohej vazhdimisht të bindtte familjen të cilët ende ishin në dilemë për këtë fejesë. Pas shumë debatesh, lotësh dhe dhimbje më 11 gusht të vitit 1974 vajza nga Palasa e Himarës Afroviti Kokuri shkon nuse në fshatin Blliçe të Dibrës, jo e veshur si nuse por e veshur thjeshtë, me një fustan bezhë të cilin ende e ruan me fanatizëm. Udhëtimi nga Himara në Dibër që për krushk kishte dhe vëllanë e Shabanit, Bilbilin, në atë kohë ishte vetëm 8 vjeç edhe pse zgjati shumë ishte



mjaft i bukur dhe mbresëlënës. "Ndërsa i afroheshim shtëpisë, kujton Vita-drejt taksisë tonë po afroheshin disa fëmijë me veshje karakteristike të zonës, veshje kjo në fakt aq e ndryshme nga ajo e zonës time. Në oborrin e shtëpisë një grup vajzash po këndonin këngë, fjalët e të cilave unë nuk i kuptoja. Kam shumë për të treguar për këtë ditë të veçantë por unë do të veçoj vetëm dy momente. Duke qenë se unë nuk dija asnjë nga zakonet e fshatit, një orë pasi ishim futur në shtëpi kërkova Shabanin, por kjo kërkesë e imja i habiti dhe mërziti disi njerëzit.. Përveç kësaj mua më thanë se duhej të rrija në këmbë veçanërisht kur hynte dikush në dhomë. Sot më vjen për të qeshur kur i kujtoj por atë ditë jo". Për Vitën në fakt ka qenë e vështirë edhe diferenca mes kulturave e zakoneve që kishte midis dy krahinave, por ajo e shpreh sot se ka patur vazhdimisht mbështetje nga familja e Shabanit, ku e kanë përkrahur dhe mbështetur dhe atëherë kur u duhej të dilnin kundër zakoneve e traditave të vjetra që mbartnin si fshat. Sot kanë kaluar afro dyzet vite që atëherë por për Vitën këto kujtime janë të bukura sa kur i tregon qesh dhe vetë. "Sipas zakonit ditën e hënë më duhej të shkoja në krua të mbushja ujë bashkë me vjehrrën, e cila për mua mbetet një zonjë e dashur dhe e respektuar. Ajo duhej të ecte para e unë pas saj, por ngaqë nuk e dija këtë zakon të fshatit ecja paralelisht me të e kjo vihej vërtet në siklet dhe ndaj vazhdonte të nxitonte hapat dhe unë pastaj vazhdoja bashkë me të. Edhe mënyra e veshjes time linte vend për koment nga familjet vendase. Pak kohë më parë, një ish nxënësja ime Anila më tregoi se në ato vite ne mundoheshim të të imitonim në veshje por prindërit na thoshin se ajo është ndryshe, është nga një zonë tjetër më e emancipuar. Sot dua të falënderoi të bashkëfshatarët e mi të asaj kohe për mirëkuptimin që kanë treguar ndaj meje".Menjëherë pas martesës Vita emërohet mësuese në shkollën 8 vjeçare dhe të mesme në Fushë Alie, e para mësuese me arsim të lartë në ato vite. Duke qenë se Shabani u emërua inxhinier në Fierzë, rrugën për në shkollë Vita e bënte bashkë me kunatin e saj Rruzhdi Bitrin, atëherë mësues në ciklin e ulët. Pas lindjes së djalit emërohet mësuese në shkollën e fshatit Blliçe. Ende sot pas kaq vitesh Vita flet me respekt për ish kolegët e saj të cilët e kanë ndihmuar dhe mbështetur kudo deri dhe në kuptimin e dialektizmave që fliteshin jo vetëm nga nxënësit por dhe nga prindërit. Të tillë përmend: Murat Koltraka, Xhavit Spata, Ali Hoxha, Sul Bajraktari, Maliq Kacani, Shasine Koçi, H.Nezha, S.Kuta, A.Shehu, N.Tota etj. Në vitin 1976 Shaban Bitri emërohet inxhinier në hidrocentralin e Fierzës dhe në gusht të po këtij viti merr dhe Vitën me vete. Pas dy viteve në fshat, ndarja e Vitës me pjesëtarët e familjes nuk ishte e lehtë por shumë e vështirë. Ata kurrë nuk e thirrën nuse por gjithmonë në emër Vita dhe e vlerësuan tamam si vajzën e tyre Zaren. Po ashtu dhe emërimi kunat apo kunatë nuk ekzistoi në këtë familje intelektuale. Dy vitet e para në Fierzë Vita punoi në shkollën 8 vjeçare e më pas në shkollën e mesme profesionale, ndërtimi, elektrike dhe mekanike. Me kalimin e viteve në këtë kantier të madh ndërtimi shtohej pasioni dhe përkushtimi për punën dhe profesionin e mësimdhënies. Por jeta rridhte bashkë me punën. Tashmë familja ishte shtuar, djali i parë Mondi lindi n ë Blliçe dhe djali tjetër Alfonsi lindi në Fierzë. Pra familja intelektuale Bitri u shtua e u bënë katër veta, katër veta në këtë kantier të madh e të zhurmshëm në çdo orë të ditës e të natës. Në vitin 1980 Vita Bitri trasferohet si mësuese në shkollën pedagogjike "Shejnaze Juka" në Shkodër, një vlerësim ky, një çertifikim për punën e mirë që kishte bërë .Jo vetëm kaq por për koincidencë në këtë kohë dhe Shabani emërohet si inxhinier në Koman , kurse Vita me dy djemtë udhëton drejt qytetit të Shkodrës, Shabani udhëton drejt një kantieri tjetër të rëndësishëm siç ishte Komani.Jo pak por plot tetëmbëdhjet vjet Vita Bitri punoi si mësuese në shkollën pedagogjike të Shkodrës ku dha por dhe mori përvojë në mësimdhënie. Edhe pas kaq e kaq vitesh mësuese Vita i kujton me mallë ish kolegët e saj por dhe ish nxënësit e saj si: drejtoresha e shkollës Aishe Hoxha, mësuesit A.Miloti, I.Dizdari, T.Tasellari, R.Jashari, F.Kopliku, F.Gjyrezi, S.Dibra, J.Zera, Sh.Selhani, Y.Troshani, P.Haxhi, B.Dizdari, A.Leka, Z.Kalaja, E.Draçini, D.Garuci, Dhe ish nxënësit:Remzi Veseli-ish kryetar komune që fatkeqësisht u nda nga jeta pak vite ma parë, Ilmi Përllaku, një nxënës nga Kukësi, jetim nga nëna, i cili e kishte fituar të drejtën e studimit falë këmbënguljes dhe dëshirës së tij të madhe për t'u arsimuar, Naim Tahiri, Filxhane Toçilla, Besa Hoxha, Arben Doçi-sot kryetar komune, M.Demiri, A. Mazreku, Q.Murati-sot drejtor shkolle. Ja se si shprehet ish kolegu i saj Ali Hoxha në ato vite për mësuese Afroviti Bitri: "Pa asnjë dyshim mësuesja e re e fizikës në shkollën tonë Afroviti Bitri, është njëra nga ato mësuese që emri i saj do të kujtohet kudo në ato mjedise ku punoi. Ajo si në punën mësimore-edukative, me nxënësit, ashtu dhe në marrëdhëniet me ne kolegët dhe më gjerë në pjesën tjetër të shoqërisë, në çdo fjalë e në çdo hap të saj Afroviti rrezatonte urtësi, mençuri dhe harmoni e miqësi midis njerëzve".Dhe ish kolegu tjetër i saj Xhavit Spata që sot nuk jeton është shprehur në kujtimet e tij: "Afroviti vinte nga një kulturë e mendësi tjetër, por unë udhëtoja nga Blliçja e në Fushë Alie dhe punoja me të. është fat të vijnë në zonën tonë njerëz të tillë". Rruzhdi Bitri, dhe ky ish koleg por dhe kunati i saj do të shprehet: "Isha vetëm 16 vjeç kur Vita u bë kunata ime, por që në momentet e para dhe deri sot ajo është motra ime e madhe. Këtë vend tek ne e bëri vetë Vita. Kujtoi se disa herë kur nëna ime bashkë me Vitën bënin punët e shtëpisë dhe kur nëna fliste ndonjë fjalë në dialekt mua më duhej të përktheja por dhe e kisha të vështirë të gjeja sinonime të ngjashme me ato fjalë të vjetra që fliste nëna ime".Pas më shumë se dy dekada në arsim, shkëputja prej tij edhe për Vitën ishte i vështirë por më 23 prill t ë vitit 1998 ajo mbylli një cikël shumë të rëndësishëm të jetës së saj, atë të mësimdhënies nëpër shkolla por nuk mundi të ndahej kaq lehtë prej saj sa kur erdhi në Tiranë bleu librin "Edhe pak matematikë për ju" dhe zgjidhte ashtu kot ushtrime. Sot Afroviti Bitri ka hapur një librari në Laprakë, kështu i duket vetja ma e lidhur përsëri me librin të cilin e ka patur dhe vazhdon ta ketë përsëri pasion.

opinion

# Skënderbeu "hero i madh grek"? Marrinat nuk kanë fund

*Nga* **ABDURAHIM ASHIKU**

Gjergji i Gjon Dibranit ( por përdor llagapin e Volaterranus (1434-1516), njeriut që ka qenë pranë Kastriotëve po aq sa edhe humanisti i madh Marin Barleti) – Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, tash na doli...grek, na doli "Jorgjo Kastriotis-feudal grek i helenizuar mesjetar", na doli "një hero i madh grek, Jorgjos Kastriotis me historinë e tij".

Lëçitësin e këtyre deklaratave e fali me shprehjen e njohur "Fale o Zot se s'di çfarë thotë" por gazetarin shqiptar që i fiksoi në celuloid zërin dhe figurën, madje ia përcolli "botës mbarë" nuk mund ta fali.

Në etikën e gazetarit, në intervistë debati përjashtohet por nuk përjashtohet pyetja pas pyetjes e pyetjet pas pyetjeve për të përgënjeshtruar bashkëbiseduesin. Ai e kishte këtë privilegj dhe nuk e shfrytëzoi duke "pohuar" se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (alias Jorgjo Kastriotis) na qenka një "hero i madh grek", një "feudal grek i helenizuar mesjetar".

Kam në dorë veprën "Historia e Dibrës" të historianit të madh të kohës sonë Kristo Frashëri, një rrëfim historik që nuk është thjesht "dibran" por kombëtar, veçanërisht kur ai lidhet me origjinën e kryetrimit arbër, me 18 nga 25 betejat fitimtare të tij në krye të arbërve në truallin e Dibrës, me trimërinë arbërore por edhe me dhimbjen dhe tragjedinë e trevave ku u zhvilluan betejat dhe ku shpata e pushtuesit otoman preu me qëllim zhbihje qafa pleqsh e plakash, burrash e grash, fëmijë në djep...

Betejat e mëdha të kryetrimit shqiptar na qëllon që ti lexojmë në qetësinë e të ndjekurit të një filmi kalorësiak, të gjëmimit të tambureve dhe vringëllimit të shpatave pa e vrarë mendjen se çfarë dhimbje sillnin ato, çfarë peshe të jashtëzakonshme mbante mbi shpatulla një popull i vogël në numër dhe një vend në një hapësirë të ngushtë gjeografike.

Tek lexoja Kristo Frashërin (vazhdoj ta lexoj e ta rilexoj, ta nënvizoj e të shkëpus pjesë nga "Historia e Dibrës" së tij) ndjeva trimërinë e pashoqe, dhimbjen e plagëve, kohën në dejet e gjakut tim.

Populli im, të parët e mi, kanë hequr atë që nuk e ka hequr popull tjetër në Evropë, është vdirë dhe shkrirë si qiri. Por, për këtë, më mirë t'ia lë penën disa fragmenteve nga dhimbja e madhe përcjellë nga historiani Kristo Frashëri, tashmë dibran po aq sa edhe përmetar.

"Në epopenë skënderbegiane treva dibrane luajti një rol të rëndësishëm nga pikëpamja gjeografike dhe njerëzore. –thekson Ai-Nga pikëpamja gjeografike trevës dibrane, e cila ndodhej në kufijtë lindorë të Shqipërisë së çliruar, i takoi të luante rolin e ledhit për ta mbrojtur vendin nga ushtritë osmane meqenëse në shumë raste ato i turreshin Shqipërisë nga gryka e Radikës ose nga Gryka e Drinit të Zi. Ledhin mbrojtës në këtë sektor e përbënin luftëtarët dibranë me në krye Mojsi Golemin ose siç quhej ndryshe Mojsiu i Dibrës. Gjithashtu nga pikëpamje njerëzore kontributi që dha treva dibrane në mbrojtjen e Shqipërisë së çliruar ka qenë shumë i madh. Sakrificat njerëzore, me të cilat treva dibrane përballoi luftërat mbrojtëse kanë qenë të jashtëzakonshme. Sikurse do të shohim më tej, më 1467 popullsia e trevës ka qenë thellësisht e dhjetuar. Fshatrat e saj qenë rrudhur në shumë pak shtëpi. Dëmet e mëdha që treva dibrane pësoi në ekonomi mund të kuptohen po të kemi parasysh numrin e madh të betejave që janë zhvilluar në këtë trevë dhe taktikën e djegieve, plaçkitjeve, rrëmbimeve që ndiqnin ushtritë osmane, sa herë vërsuleshin kundër Shqipërisë së Çliruar. Veç kësaj, treva dibrane u bë disa herë fushë betejash të përgjakshme. Madje emrat e vendeve dibrane të këtyre betejave si: Torvioll, Sfetigrad, Oranik, Çidhën, Meçad, Vajkal historianët, duke filluar që nga Barleti, i popullarizuan në mbarë Evropën."



*Shtatorja e Skënderbeut në Peshkopi, vepër e skulptorit Sadik Spahija, e realizuar me idenë dhe sponsorizimin e Zaim Korsit.*

© Foto: Bujar Karoshi

Për historianin Frashëri..."Nuk është rastësi që beteja e parë shqiptare-turke, nga e cila varej në njëfarë shkalle fati i mëtejshëm i Shqipërisë së çliruar, u zhvillua në fushën e Torviollit-një fushë e rrethuar me pyje , në Dibrën e Poshtme, ndoshta në fushën e sotme të Peshkopisë. Ka mundësi që Skënderbeu ta ketë zgjedhur vetë vendin e betejës (madje këtë e pohon vetë Barleti), mbasi ai e njihte mirë terrenin, njohje kjo që i dha atij mundësinë ta fuste ushtrinë turke të Ali Pashës në kurth. Këtu nuk është vendi për të trajtuar betejat e Skënderbeut, mbasi ata i takojnë historisë së Shqipërisë dhe si të tilla janë trajtuar në monografinë kushtuar jetës dhe veprës së Skënderbeut.

Megjithatë këtu nuk është pa vend të vihet në dukje një nga momentet më dramatike për shqiptarët e epopesë skënderbegiane, ku shkëlqen besnikëria e pafund e popullsisë së Shqipërisë së çliruar, përfshirë edhe banorët dibranë, ndaj Heroit. Është fjala për betejën e Ujëbardhës e cila u zhvillua në verën e vitit 1457. Atë vit një ushtri e madhe osmane (sipas burimeve të kohës me 80.000 ushtarë), nën komandën e Isak bej Evrenozit, të cilën e shoqëronte tradhtari Hamza Kastrioti, marshoi kundër Shqipërisë së çliruar. Pasi përshkoi grykën e Radikës armata osmane hyri në trevën dibrane. Këtë na e thotë guvernatori venedikas i Durrësit Nark Diedo. Në raportin që ai i dërgonte senatit të Republikës më 31 korrik 1457 njoftonte se: "Me anën e kësaj letre plot nderim lajmëroj të ndriturin Këthjelltësi tuaj për arritjen e ushtrisë së Turkut, në një vend të quajtur Dibër, vend i të madhërishmit Skënderbej".

Në Dibër ushtria turke ndeshi një rezistencë të vogël, jo se ushtria shqiptare u thye, por se Skënderbeu u shtir sikur u thye dhe u tërhoq...

"...Gjatë kësaj kohe ushtria osmane, pasi kaluan përmes Dibrës e Matit duke kryer plaçkitjet, djegiet dhe mizoritë e tyre të zakonshme dolën në grykën e lumit Mat..."

"...Popullsia dibrane i qëndroi besnike Skënderbeut edhe në vitet e vështira të mëvonshme. Dëmet që treva dibrane pësoi gjatë fushatave të mëvonshme osmane qenë të mëdha. Por sakrificat e pallogaritshme njerëzore dhe materiale ajo i pësoi në vitet 1466-1467, gjatë rrethimit të dytë dhe të tretë të Krujës. Gjatë rrethimit të dytë, në pamundësi për të shtënë në dorë kalanë e Krujës sulltan Mehmeti II shpresoi se do ta thyente rezistencën e Skënderbeut duke asgjësuar bazën njerëzore dhe ekonomike të rezistencës shqiptare. Madje inatin që i shkaktoi sulltanit për të dytën herë Kruja heroike ai e shkarkoi në trevën dibrane... Në korrik të vitit 1466, sulltani marshoi drejt krahinës së Dibrës dhe viseve të tjera të shtetit të Skënderbeut. Kudo ushtritë osmane kryen mizori, plaçkitje, rrënime e djegie, të cilat e detyruan një pjesë të popullsisë të kërkonte strehim në skutat malore..."

Fatihu... "Gjatë kthimit të tij kaloi nëpër Dibër dhe në viset e Skënderbeut, në Çidhën ku kreu një masakër të përbindshme-masakroi rreth 8000 shqiptarë (sipas Barletit). G. Biemi thotë: u masakruan 30 mijë burra, gra e fëmijë, midis të cilëve 8 mijë luftëtarë..."

Shqipëria e çliruar, siç e emërton në të gjitha rastet historiani Frashëri, për një çerek shekulli u rrudh deri në palcë në njerëz dhe pësoi shkatërrimin më të madh ekonomik në historinë e saj. Historiani, bazuar në "defterin emëror të hartuar nga administrata osmane (mars 1467) për viset e Dibrës së Epërme, të Dibrës së Poshtme, Gollobordës, Rekës e për vise të tjera" thekson se "mbarë treva dibrane kishte 171 fshatra, nga të cilët 153 ishin me banorë, me gjithsej 1331 familje, kurse 18 fshatra ishin krejtësisht të braktisura. Po të kemi parasysh se në shekullin XV familjet kishin karakter patriarkal, pra çdo familje kishte mesatarisht tetë anëtarë për familje (Pashko Vasa njoftonte më 1879 se në Lurë, e cila bën pjesë në malësinë dibrane, kishte dëgjuar për një familje me 225 anëtarë), si rrjedhim, treva dibrane kishte në kohën e regjistrimit 10.648 banorë. Në se marrim në konsideratë se në fillim të epopesë skënderbegiane fshatrat e trevës dibrane kishin secila 40 familje, me siguri me karakter patriarkal dhe në se pranojmë të njëjtën mesatare prej tetë anëtarësh për çdo familje del se treva dibrane kishte në fillim të viteve '40- të 54.720 banorë. "

Mund të vazhdoj të citoj Kristo Frashërin në "Historia e Dibrës, Kristo Frashërin në "Skënderbeu", Marin Barletin në "Historia e Skënderbeut...", Biemin, Volaterranos, dokumentet evropianë, osmanë etj. në të cilët do të na dalë e njëjta tablo, një heroizëm i pashoq i një populli të vogël dhe një sakrificë e pashoqe e po të njëjtit popull që u gri dhe u zhbi nga shpata dhe mërija e perandorisë më të egër të kohës, madje më e egra e të gjitha kohërave.

Kjo, pikërisht kjo, anashkalohet në intervistën e gazetarit shqiptar me deputetin e një force ekstremiste greke. Anashkalohet fakti se Skënderbeu dhe Shqipëria e lirë e Skënderbeut nuk kishte as afërsi gjeografike dhe as afërsi shpirtërore me qytet-shtetet greke të asaj kohe. Çdo gjë ishte thjesht shqiptare; gjaku i derdhur dhe pasuria e djegur dhe e plaçkitur.

Shqipërisë ia kanë vjedhur dhe po i vjedhin përditë historinë e vet, atë para Krishtit dhe pas Krishtit, Lekën e Madh të Maqedonisë, Pirron e Epirit, Skënderbeun... luftën e pashoqe dhe sakrificat sublime. Vjedhësit nuk duhet ti kërkojmë larg. Ata janë brenda nesh; janë në pyetjet që bëjmë pa reaguar, në deklaratat, në botimet e pakta, në monografitë dhe në qëndrimet zyrtare.

Zoti na faltë se nuk dimë se ç'bëjmë, çfarë flasim e çfarë shkruajmë!

*Athinë, 6 shkurt 2013*

Rruga e Arbërit nr. 82

Këndvështrim studimor nga antikiteti deri
në vendosjen e regjimit komunist

studim

# Shkëlqimi, rënia dhe demonizimi i parisë

*Nga* **Mentor HOXHA**

**FORMIMI I PARISË DIBRANE**


Përgjatë Mbretërisë ilire dhe luftërave iliro-romake e romake-makedone (170-169, p.e.s), kur treva dibrane (Penestia) u pushtua nga ushtritë romake dhe ato makedone të Perseut, nuk ka dokumente mbi strukturën e parinë krahinore. Me përfundimin e tyre më 167 p.e. s. Dibra (Penestia) ra për 4 shekuj e gjysëm nën pushtimin romak. Më 395 të erës sonë, kur Perandoria Romake u nda në dy pjesë: e Lindjes dhe Perëndimit, viset juglindore të Ilirisë (përfshirë dhe Dibra), kaluan për dy shekuj në Peradorinë e Lindjes, që më pas u quajt Perandoria Bizantine. Në fillim të shek. VII-VIII u bë pre e barbarëve dhe e kolonizmit sllav të Maqedonisë. Në fund të 10 vjeçarit II të shek. IX hyri sërish nën sundimin bizantin nën juridiksionin e Themës së Durrësit (812-820), ndërsa nga fundi i shek. IX deri në fillim të shek. XI, u vu nën sundimin bullgar. Pas shembjes së Perandorisë bullgare më 1018 hyri përsëri nën sundimin bizantin. Në fund të shek.XII, kur u krijua Principata e Arbërisë (1191-1216), (shteti i parë shqiptar) me qendër Konjën popullsia dibrane u përfshi në të dhe u shkëput politikisht nga Perandoria Bizantine. Pas bizantëve erdhën anzhuinët e Napolit, të cilët më 1272 shpallën Mbretërinë e mbretit të tyre Karlit I d'Anxhuin. Më 1283, Dibra u pushtua nga mbreti serb Milutin dhe deri më 1307 mbeti nën sundimin e Mbretërisë së Rashës, më pas në sundimin 20 vjeçar të Stefan Dushanit. Gjatë këtij sundimi, bujarët dibranë u zëvendësuan me bujarë serb. Pas vdekjes së Car Dushanit më 1355 dhe shpërbërjes së Perandorisë serbe, u shfaq Andrea Gropa, me titull "Zhupan i Madh", (kreu i disa zhupanëve krahinorë). Më pas doli në skenë i biri i tij, Pal Gropa, "zot të Ohrit ose të Dibrës që dëshmohet nga diploma e Karlit I Anzhuin, mbretit të "Mbretërisë së Arbërisë", lëshuar më 18 maj 1273, në favor të sevastit Pal Gropa nga fshati Gropa i Zerqanit. Titulli "Sevast" është me origjinë bizantine. Prandaj ka mundësi që Pal Gropa dhe paradhësit e tij të kenë qenë edhe më parë, krerë të feudalizuar të Dibrës së Epërme dhe se mbreti anzhuin ka ripohuar një pozitë të tij të mëparshme[1]. Zotërimi i Gropajve u formua në Dibër të Epërme, ndërsa në bashkësitë e lira malësore të Dibrës së Poshtme nuk nuk ka ndonjë autoritet (feudal të fuqishëm). Ajo u vu nën drejtimin e kefalijve (krerët e bashkësive të lira krahinore) për veç malit të Çidhnës që drejtohej nga një feudal i vogël, i panjohur më parë që quhej Pal Kastrioti. (kristo, 90-Bashkëkohëtari i Skënderbut, fisniku Gjon Muzaka, kushëri i parë i Donika Kastriotit bashkëshortes së Skënderbut, thotë se "gjyshi i Zotit Skënderbe, quhej zoti Pal Kastrioti dhe nuk kishte në zotërim më tepër se dy fshatra, të quajtura Sinja dhe Gardhi i Poshtëm[2]. Pal Kastrioti edhe pse një feudal i vogël i Çidhnës vuri themelet e familjes dinastike të Kastriotëve, që nëpërmjet Gjergj Kastriotit dominon historinë shqiptare të shek. XV. Me vdekjen e Palit në fund të shek. XIV a në fillim të shek XV, fuqinë e mori në dorë djali i tij, Gjon Kastrioti, i cili u bë "Zot i Dibrës e i Matit". Më 1434 ushtritë turke "rrënuan vendet e Gjonit", bashkë me zotërimet e Gropajve dhe ariantiëve të cilën e kishte trashëguar Muzak Arianiti, më pas Moisi Golemi (biri i Muzakës). Më 1438, i zhveshur nga të gjitha zotërimet vdiq Gjon Dibra ose Gjon Dibrani[3]. Nga 28 nëntori 1443 e deri më 17 janar 1468 kur ai vdiq, historia shqiptare dominohet nga Gjegj Kastrioti-Skënderbu. Nga 25 beteja antosmane, 19 i bëri në Dibër. Bashkëpunëtorët e luftëtarët më të ngushtë të tij ishin bujarët dibranë Zakaria Gropa, Pal Kuka, Gjergj Kuka, Gjon, Gjin e Pal Maneshi, Vladan Gjurica, Moisiu i Dibrës dhe Nikollë Berisha. I mbuluar me lavdi u varros në katedralen e Shën Kollit të Lezhës, në atë vend ku akishte themeluar Besëlidhjen Shqiptare.[4] më 2 mars 1444. Pas vdekjes së Skënderbut, Shqipëria u "zhyt" në terrin e pushtimit turk, i cili e izoloi nga ajo lidhjet tradicionale që ekzistonin më parë. Elita dibrane u shua përfundimisht. "Gjatë pesë shekujve të sundimit të Perandorisë osmane, mbiemrat e familjeve të mëdha u zhdukën ose u otomanizuan dhe vendin e mbiemrave patronikë e kishin zënë: kadiu, hoxha, asqeri, taksidari, myftyu, asqeri.....etj."[5] Me vendosjen e regjimit ushtarak të timareve më 1467, Topalltia (Dibra e Madhe), iu nënshtrua pushtetit qendror, ndërsa Malësia (Dibra e Poshtme, Golloborda e Lura), që në shek. XV ishin shkrirë me Skënderbeun iu rikthyen traditës së lashtë të vetëqeverisjes. U riorganizuan në "male" e "bajraqe". Malësia e Dibrës u nda në "Nëntë Male": Reci, Dardha, Çidhna, Muhurri, Luznia në Dibër të Poshtme; Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza e Selishta në Dibër të Epërme. Shpesh "mal" futesh edhe Golloborda Perendimore, ndërsa Lura mbeti Bajrak. "Malet e Dibrës, mund të jenë krijuar që në shek. XII, njëkohësisht me disa "male" të Shqipërisë Veriore e qëndrore si "Hotina Gora (Mali i Hotit 1330)[6], Montagna di Benda[7](Mali i Bendës 1479). Organi më i lartë i "malit" ishte Kuvendi i cili zgjidhte organet drejtuese: parinë dhe pleqësinë. Paria përbëhej nga kefaliu (udhëheqësi ushtarak), i cili udhëhiqte malësorët e "malit" të tij në luftë dhe i përfaqësonte në marrëdhëniet me "malet" fqinjë. Pleqtë, mbikqyrnin zbatimin e së drejtës zakonore dhe ushtronin funksionin e gjyqtarit. Pleqësia përbëhej nga 2-3 pleq, të cilët kishin 3-5 çekiçë (ndihmës-gjyqtarë). Kreu i "malit" zgjidhej nga malësorët, ndaj duhej të respektonte vullnetin e tyre. Krerët e Nëntë Maleve formonin bashkërisht parinë e Dibrës, e cila vendoste kolegjialisht mbi çështjet e mbarë trevës (Lura dhe Golloborda kishin pari më vete). Paria nuk kishte mbi krye ndonjë udhëheqës të veçantë. Secili ishte i barabartë midis të barabartëve. Vendimet merreshin unanimisht. Nga çdo "mal", vetëm një plak merrte pjesë në pleqësinë e Dibrës, por "Mali i Çidhnës" si mali më i madh përfaqësohej nga 3 pleq. Pleqësia e Maleve ishte e trashëgueshme për fisin e tij. Pleqtë më të përmendur në Nantë Malet kanë qenë: Troci në Reç, Ndreu në Dardhë, Noka, Lusha e Kaloshi në Çidhën, Hoxha në Muhurr, Murrja në Luzni, Dema dhe Markja në Grykë të Vogël, Shehu në Grykë të Madhe, Kaziu në Selishtë e Karaj në Bulqizë. Në kohë të ndryshme kreu i parisë ka patur emërtime të ndryshme, si "kefali", "Sevast" "Zhupan", "bujar", "sanxhakbej", "pashë", "aga", "bajrakatar", etj. Mbledhja e përbashkët e parisë dhe pleqësisë formonte "Kuvendin e Maleve", si organi më i lartë i Malësisë që miratonte normat kanunore, formonte "besëlidhjen"(itifakun" politik e ushtarak), shpallte pushimin e përkohshëm të gjakmarrjeve, vendoste fillimin e fundin e luftës, etj. Vendimet e tij ishin detyrimisht të zbatueshme për mbarë viset malore të trevës që ndodheshin në krahun e majtë të Drinit të Zi[8]. Sipas situatave që krijoheshin përfaqësuesit e maleve mblidheshin tek Varret e Shupenzës, Gjurrë të Mazhicës, Ferrë të Pashës (Çidhën), Varret e Delihasanit, Pjepi i Egër etj. Karakteristikë e veçantë e Kuvendit të Maleve ka qenë, lënia e hasmërive, falja e xhaqeve dhe lidhja e besës. Kasta sunduesve feudalë (pashallarë, bejlerë, dhe agallarë), që u krijua gjatë sundimit osman, por dhe gjatë viteve 1912-1944, u kthyen në shtëpi bajraktarësh. Në fund të sundimit osman, krahas familjeve ekzistuese dolën disa familje të mëdha atdhetare, të formuar pa bajrak a pashallëk në sundim, me një flamur të vetëm, flamurin e shpëtimit të

Shqipërisë. Gjatë komunizmit me "pari" nënkuptoheshej klasa shtypëse e shfrytëzuese e popullit, jo udhëheqësit e qeveritarët e krahinës. Me këtë kuptim po përdoret sot edhe nga Prof. Shinasi Rama, në disa artikuj kur etiketon me termin "paria e Tiranës" klasën politike në fuqi. |"Nocionet "bej", "aga", "bajraktar", "borgjez", "aristokrat" në histori kanë mbetur të mallkuar, edhe pse në dokumentacionin e luftës për liri, duke përfshirë edhe Deklaratën e Pavarësisë Shqiptare, janë firmat e vulat e tyre. Si rezultat i trajtimit klasor të historiografisë shqiptare mjaft ngjarje, figura, analiza e deduksione janë interpretuar thjesht nën trysninë ideologjike të kohës.[9] Krahas maleve, Dibra është qeverisur edhe nga 4 familje të mëdha feudale (Oxhaqe); Hoxholli në Dibër të Madhe dhe Xhilaga, Hysenagolli, Karahasani në Dibër të Poshtme. Këto kanë nxjerrë disa pashallarë, bejlerë e agallarë, me poste drejtuese gjatë pushtimit osman, si qeveritarë të dy Dibrave. Dibra e Madhe është qeverisur nga Oxhaku i Hoxhollit, e Poshtmja nga Karahasani, Xhilaga, Hysenagolli dhe "Nëntë Malet". Oxhaqet u krijuan në gjysmën e dytë të shek. XVII., si rezultat i ç'thurjes së regjimit feudal ushtarak të timareve, ku shumë spahij e zaimë, përmes dhunës e arbitraritetit ndaj fshatarësisë krijuan zotërime e çifligje të mëdha në trevën dibrane: Shasharaku (Çidhën), Çipurri (Tomin), Xhilaga (Peshkopi), Rrahamani (Brezhdan), Turhanet e Dakuzet (Sohodoll), Zemzadja (Limjan). Disa pasardhës të Zemzades u bënë pashallarë. Familje të tilla tokësore me autoritet politik u krijuan dhe në Dibër të Madhe si Hoxholli, duke e ndarë Dibrën në semte të tyre. Lufta për pushtet ekonomik dhe politik midis tyre, në fund të shek. XVIII, i reduktoi në dy oxhaqe: Hoxholli në Dibër të Epërme, Xhilaga në Dibër të Poshtme

**NË NGJARJET MADHORE SHQIPTARE**

Paria e maleve dhe e oxhaqeve kanë organizuar disa kuvende ndërkrahinore ku janë marrë vendime të rëndësishme për kombin shqiptar: Kuvendi i Arbërit (2 mars 1444) në Lezhë, organizuar nga Skënderbeu. Morën pjesë gjithë princat shqiptarë dhe u formua Beslidhja Shqiptare me kryetar Skënderbeun. Besëlidhja realizoi bashkimin politik të shqiptarëve dhe ngriti shtetin e parë shqiptar. Kuvendi te "Gurra e Mazhicës (1844), Kuvendi i Prizrenit (10 qershor 1878) ku u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit me kryetar Iljaz Pashë Dibra (Qoku). Kuvendi në Fushë të Ornanicës (korrik 1878), Kuvendi i Dibrës (1 nëntor 1878), Kongresi i Dibrës (20 tetor 1880) Besëlidhja e Dibrës (27 shkurt 1899), Kongresi i Dibrës (1909), Kuvendi te Pjepri i Egër (1912), Kuvendi në Kodër Leshe (1913), Kuvendi i Arrasit (13 gusht 1920), Kuvendi i Lurës (1943), Kuvendi antikomunist (Ferra e Pashës, 1944) etj. Në kohën e Skënderbeut u bënë në Dibër 19 beteja. Pas vdekjes së tij, u bë kryengritja antosmane më 1559, 1833, dhe ndaj ekspeditave të mëdha ushtarake osmane kundër Rexhep Pashës (1840), Rushit Pashës (1844), Haredin Pashës (1844), Hysni Pashës (1855), Demir Pashës (1872), Dervish Pashës (1991), Turgut Pashës (1910) e Xhavit Pashës (1912), ku spikati Sheh Zerqani, Salë Markja e Cen Leka nga Gryka e Vogël, Salë Demiri, Ismail Kaloshi, Demir Lusha, Ali Lusha Tafë Kacani dhe Hasan Shini nga Çidhna, Nelë Hoxha e Abaz Pira nga Muhurri. Paria e Dibrës ka luftuar dhe në mbrojtje të tokave shqiptare në Nish (1878), Plavë, Guci, Shkodër (1878, 1912-1913), Follorinë (1912-1913), Manastir (1912-1913), Kolesian 1912), Vllanicë (1913), Prrenjas etj. Gjatë Lidhjes së Prizrenit figurat më të njohura të Dibrës ishin Iljaz Pashë Dibra, Ahmet Karahasani, Isuf Karahasani, Isuf Doda, Bajram Buzi, Llan Kaloshi, Hoxhë Muglica, Mustafa Lita, Harjedin Pitarka, Seit Daci, Halil Cami, Sheh Hyseni, Mersin Dema, Sheh Mustafa Zerqani, Xhemal Qoku etj. Pas 1899-ës spikati Vehbi Agoll, Selim Rusi, Hamdi Ohri, Shaqir Daci, Shyqyri Qoku, Sefedin Pustina, Shaqir Jegeni, Nurçe Pustina, Kadri Fishta nga Dibra e Madhe. Nga e Poshtmja Jusuf e Isuf Karahasani (Brezhdan), sheh Sulejmani (Zerqan), Tushe Lleshi (Zogje), Hasan Kaloshi (Çidhën), Dali Noka (Çidhën), Haziz Xheka (Gjoricë), Jashar Dema (Homesh), Vesel Lusha e Selim Alia (Çidhën), Bib Doçi (Lurë), Salih bej Dohoshishti (Dohoshisht), Safet Dema (Luzni), Sali Gaqini (Murrë), Bedri Xhaferri nga Gryka e Madhe, Bajram Marku (Gryka e Vogël), Abdullah Musaj e Nurçe Mira nga Luznia, Abaz e Sali Graqini nga Murra, Xhafer Noka (Grykë-Nokë), Selim Alija, Met Alija e Mehmet e Ali Kacani nga Fushë-Alie etj. Në ballë të kryengritjeve antiturke (1909-1912) u vu një plejadë e shkëlqyer krerësh atdhetarë si Jusuf Beg Karahasani (Brezhdan), Elez Isufi (Sllovë), Selman Alia e Halil Kaloshi (Çidhën), Shaban Lusha (Çidhën), Baftjar Doda (Reç), Mersim Dema, Sulë Daci, Liman Alliu, Destan Puca, Haxhi Karaj, Dan Cami, Hoxhë Moglica, Elez Koçi (në Gollobordë), Sadullah Strazimiri, Hafëz Sherif Langu, Eqrem Cami, Shuqyri bej Ohrit, Dine bej Maqellara, Izet bej Maqellara, Nazif Abdullah bej Allajbegia, Nazif bej Grazhdani, Mersim Dema, Rrahman Leka etj. Me largimin e ushtrive turke dhe pushtimin serb më 27 nëntor 1912, Dibra iu nënshtrua një terrrori të paparë. Atdhetarët Elez Isufi, Selman Alia, Vehbi Agolli, Sherif Langu, Dervish Hima, Sefedin Pustina, Shaqir Behxhet Agolli, Muharrem Rusi, Hamdi Ohri (Hamdi Qoku), organizuan më 20 shtator 1920 në Arras një kryengritje mbarë shqiptare e quajtur nga historianët "Lufta e Tretë ballkanike", sepse përshiu mbarë trojet shqiptare nën pushtimin serb. Kryengritësit të udhëhequr nga Elez Isufi, Selman Alia, Halil Kaloshi, Mersim Dema, Dan Cami, Bajram Buci, Hasan Koçi, Ramadan Kanxha, Sufë Xhelili, Qazim Lika, Cen Elezi, Fejz Alia, i dëbuan pushtuesit serbë nga kufiri i 1913-ës. Pas largimit të Princ Vidit më 3 shtator 1914, Shqipëria mbeti pa qeveri. Esat Pasha, u kthye nga jashtë dhe më 20 shtator 1914 hyri në Peshkopi ku kërkoi mbështetjen e dibranëve për tu ngjitur në krye të shtetit shqiptar. Më të u bashkuan Ali Bej Zajmi, Jusuf bej Hysen Agolli, Selim Noka, Selman Alia, Dervish Lusha, Selim Dema, Halil Kaloshi, Kurt Spata, Xhafer e Haxhi Noka, Fejzi Alia, Ali Tahiri, Destan Tafa, Oman Haraçiu, Shahin Deshati, Fetah Bajram Dohoshishti, Ymer Reçi, Sufë Xhelili, Ibrahim Tahiri, Halit Lleshi, Liman Lleshi, Islam feta, Ibrahim Tahiri, Shaqir Dema, Tafë Kaziu, Dine Hoxha, Xhelal Zogolli, Kurt agë Kadiu, Hysen Bej Golja, Maliq Bej Jegeni, Xhelal Zogu, Kurt Kadia, Kadri Maqellara, të cilët e përcollën deri në Durrës. Në krye të 5000 forcave dibrane Esati hyri në Durrës më 2 tetor 1914 dhe e shpalli veten kryetar i Qeverisë së Shqipërisë së Mesme e komandant i përgjithshëm i saj. Pashain e mbështeti edhe Myftiu i Përgjithshëm Vehbi Dibra (kryetar i Senatit

# etnokulturë




*Oxhaku i parë i Dibrës. Pikturë nga Sadik Bocku*

në Kuvendin e Vlorës), i cili u largua nga Vlora dhe erdhi në Tiranë, ku Esati kishte selinë e vet dhe u vu në shërbim të tij. Esati e bëri senator bashkë me Sejefedin Pustinën dhe Ali Bej Zajmin, kurse Faik Beun e bëri sekretar të Senatit (të tre dibranë.[10] Nuk iu përgjigj Elez Isufi, Izet Bej Maqellara, Riza Bej Jegeni, Dine Bej Maqellara, Sheh Sula i Zerqanit, Mersim Dema, Dine Bej Maqellara, Izet bej Maqellara, Riza bej Jegeni, etj, madje në Peshkopi menduan t'i ngrinin një pritë për ta vrarë. Lëvizja esatiste pushoi së ekzistuari kur kreu i tyre, Esat pashë Toptani u vra në Paris më 1920 nga Avni Rustemi. Lufta e Parë Botërore e ktheu truallin e Dibrës në një shesh betejë luftrash e pushtimesh. Nga viti 1912 deri më 10 dhjetor 1921, kur ushtritë serbe u larguan përfundimisht nga Dibra, treva dibrane u pushtua 4 herë nga serbët (1912), (1915), (1918), (1920), bullgarët (1917), austro-hungarezët (1917) e francezët (1918), të cilët vranë qindra dibranë, terrorizuan, dogjën e grabitën qindra shtëpi. Kundër këtij pushtimi atdhetarët dibranë Ramiz Bej, Dine bej Maqellara, Izet bej Maqellara, Ramiz Daci, Jashar Erebara, Ismail Strazimiri, Selë Bajraktari, Shaqir Dema, Dine Dema, Riza Lusha, Dervish Lusha, Dine Hoxha, Selim Noka, Haxhi Noka, Sali Noka, Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Selim Kaloshi, Dan Cami, Hakik Mena, Llan Destani (Ndregjoni), Kurt Spata, Dikë Spata, Met Skepi (Dedja), Abdurrahim Abdi Kuta (hoxhë Kuta), Ali Tahiri, Destan Puca, Osma Lita, Daci i Kalisit e Lita i Ploshtanit, Mehmet (Dedja) Skepi, Sheh Shazumani i Teqesë së Vleshës, Sheh Halimi u mblodhën një kuvend të madh më 13 gusht 1920 në Arras, ku zgjodhën një komitet lufte me kryekomandant Elez Isufin e Ramiz Dibrën. Ky komitet organizoi e drejtoi kryengritjen e 20 shtatorit 1920, e cila pëzuri forcat e serbe nga Dibra. Oficerët e Elez Isufit në këtë betejë dhe në betejën 3 mujore të Lanë-Lurës që përfundoi në dhjetor 1921 me fitoren e ushtrisë shqiptare e humbjen e forcave serbomercenare, ishin kapitenët: Ali Rizai, Suf Xhelili, Murat Kaloshi, Ibrahim Gjoçi, togerët Haziz Pilafi, Mehmet Skepi, Dervish Troci, Nisim Ahmeti, Qazim Aziz Ndreu, Dervish Lusha, Haxhi Noka, Xhezmi Frashëri, Xhevdet Strarova, nëntogerët Abdullah Tirana, Munir Tërshana, Rrok Qafa, Hakik Mena, Demir Curri, aspirantë Gani Dida, Sali Doda, Dali Lami, Selman Ahmeti, Hasan Faliu, Bajram Lusha, Hysni Kaca, Xhetan Gjoni, Sadik Kërçova, Sulë Cani, etj. Pas largimit përgjithmonë më 10 dhjetor 1921 të ushtrive pushtuese, Dibra e shkatërruar nga lufta 9 vjeçare me serbët dhe lëvizja esatiste, në vend që të qetësohej nga plagët e marra, filloi një luftë të re brenda saj, që u kurorëzua me vrasjen e disa krerëve që organizuan e drejtuan kryengritjet antiturke të 1912 dhe ato serbe të 1913-ës dhe 1920-ës. Heronjtë e këtyre luftrave; Ahmet Zogu dhe Elez Isufi nga shokë llogoreje u kthyen në armiq për jetë a vdekje, ku i pari u katapultua në krye shtetit, e më pas endacak nëpër botë, i dyti në parajsë. Lufta midis tyre u acarua kur Elez Isufi, Fan Noli, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Hoxhë Kadriu, Ramiz Daci, Jusuf Xhelili, Cen Elezi (djali Elezit), Halit Lleshi etj, vendosën të rrëzojnë me armë qeverinë e Xhafer Ypit, ku Zogu ishte ministër i Brendshëm. Elez Isufi më 22 mars 1922, sulmoi i vetëm Tiranën duke detyruar ministrat të largohen, por me ndërhyrjen e ambasadorit anglez Eires, Elezi e ndaloi luftën e u rikthye në Sllovë, ndërkohë ai, Cen Elezi, Isuf Xhelili, etj, u dënuan me vdekje në litar nga Gjykata.Në Mat iu organizua një pritë të cilën e nuhati, por nuk shpëtuan antizogistët Halit Lleshi e Ramiz Daci që u vranë nga xhandarët.

Vrasja e Avni Rustemit më 1924, shënoi fillimin e Revolucionit të Qershorit të drejtuar nga Fan Noli, që pati pasoja dhe në Dibrë. Më 11-12 qershor në Kala të Dodës u zhvillua për 5 orë një betejë e ashpër midis forcave kryengritëse të Bajram Currit dhe ato qeveritare të Muharrem Bajraktarit, Ceno Kryeziut (dhëndri i Zogut), kryetarit të Bashkisë së Peshkopisë Sulë Shehut dhe të Mustafa Bej Serdarit nga Deshati, Selim Nokës e Dervish Lushës nga Qidhna, sheh Hajrullahut nga Brezhdani, Sherif Tafës nga Sohodolli, Dine e Shaqir Demës nga Homeshi e Dine Beut nga Maqellara. Kundër Bajram Currit mori pjesë edhe Sufë Xhelili. Pas besës së dhënë Eires-it, Elezi qëndroi neutral, dy dhëndurët e tij Dine Hoxha e Murat Kaloshi me fuqitë e tyre shkuan pranë Zogut në Tiranë. Lufta mbaroi me humbjen e forcave qeveritare. Zogu erdhi në Homesh, qëndroi një javë nën mbrojtjen e parisë dibrane, më pas u fut në Serbi, me të dhe Shaqir e Sul Dema, Dine e Hysni Dema, Dine Maqellara, Fiqiri Dine, e Muharrem Bajraktari.

Rikthimi në dhjetor 1924-ës i Zogut nga Dibra e Madhe ishte një katastrofë për parinë dibrane dhe për disa krerë të spikatur të saj. Dibranët u ndanë në pro dhe kundër futjes së Ahmet Zogut nga Dibra. Përkrah Ahmet Zogut qëndronin Aqif Lleshi, Taf Kaziu, Pëllumb Lleshi, Dine Dema, Dine Maqellara, Fiqri Dineja, Major Gjilardi, Sulë Shehu, Mustafa bej Serdari, Sherif Tafa, Dine Hoxha, Murat Kaloshi, Selim Noka, Selim Nezha, Dikë Spata, Hysni Dema, Aqif Lleshi dhe oficerë rus të armatosur me topa, mitralozë, nga forcat pro qeveritare të udhëhequra nga Elez Isufi, Sufë Xhelili dhe Ali Rizai. Pasi vranë me pabesi Elez Isufin, Sufë Xhelilin dhe 5 të tjerë nga Sllova Zogu e fitoi luftën dhe i shoqëruar prej parisë dibrane hyri triumfalisht në Tiranë, ku mori frenat e qeverisjes në dorë. Vrasja e Elez Isufit e Sufë Xhelilit shënoi fundin e rezistencës antizogiste, ndërsa vrasësit e tyre morën poste, prona e grada dhe sunduan si sundimtarë absolut deri më 7 prill 1939, kur Italia fashiste pushtoi Shqipërinë. Pushtimi italian dhe arratia e Mbretit Zog prishi balancat politike në Shqipëri dhe në Dibër, kurse krijimi i Partisë Komuniste më 8 nëntor 1941 e ndau më dysh Dibrën: komunistë e nacionalistë. Figurat më të rëndësishme komuniste ishin Haxhi Lleshi, Dali Ndreu dhe Esat Ndreu. Në grupin nacionalist, krahas zogistëve Miftar e Murat Kaloshi, Cen Elezi, Dervish Lusha, Faik Shehu, Selim e Xhetan Kaloshi, Haziz Kaloshi, Shaqir Dema, Faik Shehu, Xhevdet Kumbarçe, Abdyl Konjolli, Dine Dema, Fiqiri Rusi, Irfan Ohri, Jashar Erebara, Ramadan Hoxha, Haxhi Noka, Met Skepi, Met Hoti, Fiqiri Dine, Aqif Lleshi, Ali Maliqi, Shemsi Hatibi, Hysni Dema, etj, u bashkua edhe Halil Alia, që u bë figura kryesore nacionaliste e antikomuniste në mbarë trevën dibrane. Më 1944 u vra edhe Halili nga forcat e Mbrojtjes Popullore komuniste. Vrasja e tij shënoi fundin e nacionalistëve dhe triumfin komunist, të cilët sunduan për 40 vite me radhë.

Siç shihet historia e Dibrës, është plot ngjarje, luftëra, vrasje, intriga, tradhëti, atentate, ndaj disa krerëve si ndaj Abdyl Frashërit në Dibër të Madhe më 1878, Murat Kaloshit, Dine Hoxhës, Halil Alisë, Esat pashë Toptanit, por dhe me vrasje të bujshme. Ndër ta vrasja në Tiranë e djalit të vetëm të Murat Kaloshit nga Halil Alia. Me gjithë drithijet roli e kontributi i parisë dibrane në historinë miliona vjeçare të Dibrës e të Shqipërisë padyshim është i madh. Pa të historia dibrane dhe ajo shqiptare nuk do të ishte kjo histori plot ngjarje të lavdishme për të cilat nderohemi, krenohemi, por dhe pendohemi për vrasjet e turpshme të bëra dhe për disa gjëra që duheshin bërë më mirë.

## RËNIA DHE DEMONIZIMI I PARISË DIBRANE

Historia e Dibrës është një ndër historitë më të lavdishme, por shumë nga heronjtë kryesorë të saj kanë patur një fund tragjik të pamerituar. Babait të Skënderbut, Gjon Kastriotit akoma nuk i dihet varri. Edhe varri dhe eshtrat e birit të tij dhe të Heroit tone Gjergj Kastrioti-Skënderbeu akoma nuk dihen ku janë. Barleti thotë që "Skënderbu u varros në qytetin e Lezhës në kishën më të madhe të Shën Kollit", ndërkohë Sami Frashëri, te "Fjalori i Përgjithshëm i Historisë dhe i Gjeografisë" (Stamboll 1899) shkruan se "Nga pesë kishat e mëdha të asaj kohe, njëra u shndërrua në xhami e pastaj u rrënua. Thuhet se në rrethet e kësaj është varrosur Skënderbu, megjithatë varri nuk gjendet kurrkund". Fjalori Enciklopedik Shqiptar (1985) pohon se "varri i Skënderbut u shkatërrua e u dhunua nga turqit. "Turqit e barbarët duke u bërë zotër të Lisos (Lezhës -M.H), gjetën e nxorën nga varrimi me dëshirë shumë të madhe trupin e Skënderbut. Te eshtrat dhe varri i tij u mblodhën që të gjithë, kush e kush më parë, sepse kujtonin se do të ishte fatbardhë, shumë i lumtur ai që do të siguronte për vete një copëz prej tyre, të cilën e qepnin dhe e zbukuronin një palë me argjend, një palë me ar dhe e varnin në qafë, si ndonjë gjë hyjnore, të shenjtë e vendimtare për fatin e tyre dhe e nderonin me respekt shumë të madh, duke kujtuar se të gjithë ata që do i mbanin me vete ato thërmija do kishin në jetë po atë fat e mbarësi që pat dhe gëzoi sa qe gjallë Skënderbeu"[11]. "545 vjet nga vdekja, ende i panjohur fati i eshtrave të "Heroit" tonë kombëtar?! ...Miti për dhunimin e varrit të tij mbeti fakt për kujtesën e Evropës: pse nuk pohohet nga botimet tona zyrtare se varri i Skënderbut është dhunuar nga turqit? A është Kisha e Shën Kollit vendbanimi i heroit, mbi të cilën më vonë u ndërtua një xhami?![12] Fati i keq, ra edhe për Donikën, bashkëshorten e Skënderbut dhe për Gjonin, djalin e tij të vetëm që pas pas vdekjes së tij emigruan në Itali ku vdiqën me brengën përvëluese për atdheun për të cilin luftuan e sakrifikuan kaq shumë. E kobshme ishte vdekja e Princit të Dibrës, gjeneralit të Skënderbeut, Mojsi Golemi dhe 4 gjeneralëvë dibranë: Moisiu i Dibrës (Dibër), Vladan Gjurica (Dibër), Muzhaqi i Angjelinës, Gjon Muzhaqi, Gjon Perlati, Nikollë Berisha (Dibër), Gjergj Kuka (Dibër) dhe Gjin Maneshi (Dibër), të cilët ranë në duar të ushtrisë turke të renegatit nga Mati Ballaban Pasha, në Betejën e Vaikalit në Bulqizë në prill 1465. Pasi u torturuan për 15 ditë në oborrin e Sulltanit në Stamboll dhe nuk pranuan të luftonin kundër Skënderbeut, u rropën të gjallë, u prenë copa-copa dhe i'u hodhën qenve".[13] Fund të hidhur patën edhe dy krerët më në zë të oxhakut të Hoxhollit në Dibër të Epërme, Aqif pasha dhe Dalip beu (vëllezër dhe krerë të parisë qeveritare). Pasi u arrestuan më 1844 nga Hajredin Pasha, të lidhur e të veshur me brekush e me një thes mbi kokë u dërguan në Selanik dhe më pas u burgosën në Azi të Vogël. Iljaz Pashë Dibra (Qoku), kryetari i Lidhjes së Prizrenit (Shteti i parë Shqiptar) nuk është vlerësuar aq sa duhet nga historiografia shqiptare. Madje, gjatë regjimit komunist, si kryetar i Lidhjes Shqiptare, nuk përmendej ai, por Abdyl Frashëri. Dom Nikoll Kaçorri, firmëtari i Pavarësisë dhe zëvendës kryeministri i Qeverisë së Parë shqiptare vdiq jashtë Shqipërisë dhe u varros në Vjenë, duke i munguar për 94 vjet me radhë shtetit të cilin e themeloi dhe luftoi aq shumë. Por, edhe riatdhesimi i eshtrave të tij më 9 shkurt 2001, ishte skandaloz."Për turpin e qeverisë, themeluesi i alfabetit shqip, firmëtari i Pavarësisë së Shqipërisë dhe nënkryetari i qeverisë së Vlorës, erdhi në Rinas si ndonjë njeri që mund të ishte vrarë duke transportuar drogë. Eshtrat e Nikoll Kaçorit janë transportuar me një karrocë mallrash. Ai nuk u prit nga asnjë qeveritar shqiptar, madje as nga ndonjë i rangut më të ulët. Në Rinas nuk kishte asnjë shenjë protokolli qeveritar për themeluesin e parë të kësaj qeverie, -shkruan Enver Sulaj. Shumë prej prijësave popullorë që organizuan e drejtuan kuvendet e betejat më të mëdha antiturke, antiserbe, antifashiste dhe antikomuniste vdiqën jo nga vdekja natyrale, por nga plumbat vrastarë të kundërshtarëve politikë. Disa u vranë në pabesi nga shokët e idealit, disa nga miqtë e njerëzit më të afërt. Elez Isufi, udhëheqësi legjendar i dibranëve


*(Vijon në faqen 16)*

Rruga e Arbërit nr. 82

Një botim në tre vëllime mbi historinë e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj

botime

# Dibra në hulli të historisë




Nga Prof. dr. **ADEM BUNGURI**

Që në epokën homerike kur lindi shkrimi (rreth vitit 750 para Kr.), botimi i një libri ka qenë gjithnjë një ngjarje e gëzueshme dhe njëherësh e rëndësishme. E gëzueshme për faktin se pas një pune të gjatë e sistematike, të mundimshme e shpesh herë rraskapitëse, autori ka arritur t'i paraqes lexuesit substratin e kërkimeve dhe përvojës së tij të gjatë në fushën përkatëse të studimit. E rëndësishme, pasi kjo eksperiencë e çmuar, që pak njerëz arrijnë ta fitojnë, memorizohet dhe u transmetohet brezave më të rinj në fushën përkatëse të dijes.

Në këtë kontekst, monografia e studiuesit të njohur Xhemal Domi ia ka arritur plotësisht qëllimit. Pas një pune të gjatë e sistematike, në arkiva dhe në kabinet, është përpunuar dhe klasifikuar një material i bollshëm arkivor dhe historik, i cili i serviret i gatshëm në tavolinë e të nxënit çdo studiuesi të historisë së Dibrës në përgjithësi dhe historisë së arsimit të saj në veçanti. Ky promovim vjen ne kudrin e 7 marsit, festes se mesuesit, 126 vjetorit te shkolles se pare shqipe te Korçes dhe 125 vjetorin e shkolles se pare shqipe ne Diber që u hap ne vitin 1888, vetëm një vit pas asaj të Korçës. Monografia me titull "Dibra në hulli të historisë" vjen para lexuesit në tre vëllime, një rast i rrallë ky që dëshmon për punën me pasion dhe përkushtim të autorit. Vëllimi i parë i kësaj monografie që po promovojmë sot, me 342 faqe, i kushtohet historikut të arsimit në rajonin e Dibrës, në periudhën më të hershme dhe më të gjatë historike, që përfshin periudhën e lashtësisë, atë të antikitetit, të mesjetës dhe të Rilindjes deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Pa dyshim që kjo është periudha më e vështirë për t'u trajtuar, më e varfër në dokumente dhe shumë me larg kujtesës së gjalle te njerëzve. Megjithatë, Xhemali ia ka dalë të na sjellë një libër të vlefshëm mbi problemin që trajton. Botimi i tij është rezultat i një pune sistematike dhe të përkushtuar të autorit. Për këtë atij i është dashur të lexojë shumë, të punojë shumë, të shfrytëzoj arkivat e Institutit të Historisë dhe të Arkivit Qëndror të Shtetit, arkivin e rrethit të Dibrës etj. I qetë dhe i heshtur, çdo ditë dhe sistematikisht, ai ka mbledhur e sistemuar materialin e nevojshem dhe e ka klasifikuar ate ne qindra skeda, në funksion të objektivit të tij të qartë, historikut të arsimit në Dibër.

Dibra ka vertete vlera te spikatura ne tradicionin etnologjik e kulturor, aq sa lirisht mund te krahasohet me nje thesar te pashtershem vlerash. Eshte fat i madh te jesh pjese e saj, por eshte shume fat dhe pergjegjesi te jesh studiues i ketyre vlerave. Ne se deri para disa vitesh, kudo ne ambiente dibranesh degjohej shprehja se "Dibra ka histori te shkëlqyer, por nuk ka historianë", tani kjo nuk mund te thuhet plotësisht. Duhet thënë se kjo pamje ka filluar të ndryshojë ne drejtimin e duhur. Jane disa studiuese dibrane qe po e thone fjalen e tyre ne fusha te ndryshme te dijes, si ne ate te arkeologjise, te historise, te etnokultures etj. Në listën e ketyre autoreve është përfshirë që prej 30 vitesh edhe studiuesi Xh. Domi, tashmë edhe me punen e tij te pasqyruar ne tre vëllime, kushtuar historikut te arsimit ne Diber.

Struktura e ketij përbëhet nga hyrja dhe 22 probleme kryesore tematike, qe mund te ishin përmbledhur ne 4-5 kapituj, çdonjeri prej të cilëve, i përbërë nga disa sytha të veçantë, të ndërtuar sipas kriterit kronologjik. Ajo mbyllet me CV e disa nga figurat më të shquara të arsimit në Dibër, që pasohen nga 4 shkollat më të rëndësishme në Dibër, dhe sythi përmbyllës, që ben fjale per shkollen normale shqipe te Bukureshtit. Monografia është pajisur me bibliografinë dhe aparatin e nevojshëm shkencor si dhe me 13 fotografi të figurave të arsimit në Dibër dhe Shqiperi në periudhën e Rilindjes etj.

Libri fillon me sythin "Në vend të hyrjes", duke shmangur vështërsinë e njohur të fjalisë së parë. Në këtë syth prej 11 faqesh (f.9-20), paraqiten dy hipotezat kryesore mbi etimiologjinë e emrit Dibër, dhe mbështetet karakteri autokton i formimit të këtij makrotoponimi, duke e veshur këtë edhe me argumentet e njohur arkeologjikë e gjuhesore. Pastaj vijon trajtimi i mjaft problemeve te historise se arsimit shqiptar ne pergjithesi dhe atij dibran ne veçanti. Per te gjykuar mbi vlerat e kësaj monografie, si dhe per te mos hyre ne hollesi te panevojshme, une do te përmend vetem titujt e problemeve kryesore qe autori ka marre ne shqyrtim, qe sipas kronologjise janë:

- "Arsimi dhe edukata popullore nga lashtësia deri në mesjetën e vonë"( f. 21-31).
- "Fillimet e arsimit, shek. X-XV" (f. 32-41)
- "Nga letërsia didaktike me alfabet të huaj në përhapjen e shkollave në trevat shqiptare" (f. 42-55).
- "Në kërkim të arsimit dhe të shkollave në gjuhë të huaj dhe përpjekjet për të futur mësimin e gjuhës shqipe në to" (f. 56-68)
- "Shkollat e huaja në viset shqiptare" (f. 69-107)
- Nje vështrim i shkurter nga Tanzimati ne Lidhjen e Prizrenit (f. 108-113)
- Arsimi e shkolla shqipe prej Tanzimatit deri ne Lidhjen e Prizrenit(f. 114-120)
- Naum Veqilharxhi-pionier i pare i Rilindjes sone kombëtare(f. 121-123)
- Ne kërkim te shkollave shqipe prej Tanzimatit deri ne Lidhjen e Prizrenit (1839-1878) (f. 124-134).
- Lidhja shqiptare e Prizrenit (1878-1881) (f. 135-139)
- Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe politika e saj arsimore( f.140-157)
- Nga "Shoqëria e te shtypurit shkronja shqip" e Stambollit(1879) tek kongresi i Manastirit(14-22 nentorn 1908) (f. 158-202)
- Me besa-bese, me pushke e pene, Dibra ne vitet 1899-1908 (f. 203-225)
- Kongresi i Dibres (f. 226-234)
- Kongresi i Elbasanit (2-8 .09. 1909) (f. 235-243)
- Kongresi i dytë i Manastirit(1-6 prill 1910) (f. 244-252)
- Kërkesat e kryengritësve shqiptare të viteve 1911-1912 për arsimin, shkollën shqipe dhe lufta kundër shkollave të huaja (f. 253-256)
- Me pushkë e penë drejt pavarësisë në vitet 1910-1912 (f. 257-262)
- Figura të shquara dibrane për arsimin shqip (Rilindja) (f. 263-318)
- Said Najdeni-Hoxhe Voka (1864-1903)
- Josif Bageri (1868-1914)
- Dervish Hima (1872-1928)
- Zyhdi Ohri (1870-1931)
- Ibrahim Temo (1865-1945)
- Hamdi Ohri (1872-1938)
- Haxhi Vehbi Dibra (1867-1937)
- Jashar Erebara (1873-1953)
- Haki Stermilli( 1895-19563)
- Disa shkolla qe kane lene gjurme ne historine e arsimit per Dibren (f. 319-331)
- Shkolla e Said Najdenit (Hoxhe Vokes)
- Shkolla shqipe e Josif Bagerit
- Shkolla kishtare shqipe e Dufit te Rekes se Dibres
- Shkolla normale e Dibres(1910-1912)
- Nga shkolla e parë shqipe tek shkolla e çupave në Korçë (f. 332-338)
- Shkolla normale shqipe e Bukureshtit (f. 339-342).

Autori ka sjelle nje informacion te vertete, te gjere e te plote lidhur me perpjekjet e popullit te Dibres per hapjen e shkolles shqipe, megjithe kushtet e veshtira social-politike te kohes. Ajo tregon qarte dashurine per dije e arsim te popullit te Dibres, per te cilat, ajo shquhet ne plan kombëtar. Shkolla e pare shqipe ne qytetin e Dibres u hap ne vitin 1888, vetem nje vit pas asaj te Korçes, u rihap ne vitin 1893 dhe u rihap perseri ne vitin 1900. Ai ka sjell një episod të rëndësishëm të historikut të arsimit në Dibër në nëntor 1899, pas mbylljes per here te dyte te shkolles shqipe ne Diber, kur Komisioni Arsimor i Dibrës me 30 anëtarë, i kryesuar nga Shyqyri Qoku, i dërgon një peticion Sulltanit, duke kërkuar nga Porta e Larte lejen per nje shkolle te tille. Per rendesine qe paraqet po e citojme peticionin :

"Meqenëse në qytetin tonë Dibër flitet vetëm gjuha shqipe dhe fëmijët e vendit nuk kanë pasur mundësi të arsimohen legalisht në gjuhën amtare, zemrat tona janë mbushur me hidhërim të thellë. Në qoftëse do të lejohet hapja e një shkolle me shqipen si gjuhë mësimi, domethënë me gjuhën tonë amtare, atëherë jo vetëm do të përgjithësohej arsimi në popull, por edhe njohja e gjuhës zyrtare do të bënte përparim. Shkolla do të jetë nën mbikqyrjen e Komisionit Arsimor të Dibrës dhe të gjitha shpenzimet për mbajtjen e saj do të përballohen nga qytetarët" (Xh. Domi, 2012, f. 215).

Ky Komision Arsimor i Dibrës i vitit 1899, është organizata e dytë kulturore patriotike që u formua pas Shoqërisë Kombëtare të Korçës të vitit 1887, ndersa shkolla e pare shqipe ne qytetin e Dibres e vitit 1888, sic u përmend me lart, e dyta ne Shqipëri pas asaj te Korçes.

Te gjithe e dime mire dashurine e dibraneve per arsim e dituri. Te gjithe e kujtojme me krenari faktin e njohur, qe nuk ka kaluar ne heshtje, qe studentet dibrane shkëlqenin ne cdo fakultet te Universiteteve te Shqiperise, dhe kjo eshte padyshim edhe merite e mesueseve dibrane. Te urte e te heshtur, ata ecnin me ore te tera ne kembe, per te përhapur driten e diturise jo vetem ne qytete, por ne cdo skaj te Dibres, ne Lure, Rec e Dardhe, ne Cidhen e ne Kastriot, ne Kala dhe ne Radomire, ne Trebisht, Klenje dhe ne Stebleve, ne Okshtun e ne Ostren, ne Zerqan dhe ne Ternove, ne Shupenze dhe ne Maqellare etj.

Duke e shfleuar këtë libër të Xh. Domit, bindesh se ai ka bërë një punë të madhe me pasion dhe përkushtim të veçantë. Duke e shfletuar atë më vjen në mendje një postulat mbi njerëzit e urtë dhe të heshtur, që i përshtatet autorit të këtij libri: "Njerëzit që rrinë në heshtje janë ata që kanë më shumë për të thënë...ata nuk rinë në heshtje nga frika e fjalës, por flasin vetëm me atë që është i zoti ta kuptojë". Dhe ky auditor i nderuar si dhe auditori i gjere dhe i vemendshem i lexueseve te shumte dibrane, eshte vlerësuesi i vertete dhe me i sakte i ketyre botimeve.

Kjo monografi e Xh. Domit perben pa dyshim kontribut të ri në pasurimin e tablos së zhvillimit te arsimit shqip të rajonit te Dibres në veçanti dhe të hapesires shqiptare në përgjithësi, kontribut për të cilin e urojmë përzemërsisht autorin.

cyan magenta yellow black

# Një botim shkencor për shkollën

Nga **ELMAZ LALA**

**Karakterin shkencor të përmbajtjes së librit autori e ka bazuar në shfrytëzimin e një materiali të gjerë arkivor, lokal e kombëtar, ka përdorur referenca shkencore të mjaftueshme dhe të besueshme. Ka shfletuar në mënyrë selektive shtypin e kohës, ka studjuar e analizuar një varg aktesh e dokumentesh zyrtare në të cilat përvijohej e përcaktohej rruga dhe prirjet e zhvillimit të shkollës, ka inkluduar pjesë te raporteve e relacioneve të zyrtarëve të kohës, natyralisht e me efikasitet ka përdorë kujtime të tijat dhe të kolegëve sa herë i është dashur të ndriçojë më mirë e t'i bëjë më interesante anë e dukuri të veçanta të saj.**

Promovimi i një libri gjithnjë përbën një eveniment, por ky i sotmi është mjaft i rëndësishëm pse ai është mirëfilli kulturor e arsimor, është një vlerësim e homazh për rrugën e gjatë dhe njëherazi të lavdishme të shkollës e arsimit shqiptar dhe të veçorive të zhvillimit të tyre në trevën e Dibrës e rreth saj. Duke u pajtuar plotësisht me vlerësimet që bënë më parë kolegët e nderuar, më lejoni të shpreh shkurt, edhe unë nja dy–tre konsiderata e të bëj ndonjë vlerësim.

Së pari, libri "Dibra në hulli të historisë" (Historia e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat e Dibrës dhe rreth saj), në tre pjesë, të autorit Xhemal Domi, përbën një punim serioz, mbështetur në kritere e parime shkencore, gjithpërfshirës e volominoz, që rrok një periudhë mjaft të gjerë historike dhe një përpjekje të sukseshme për një ndriçim shumëplanësh të zhvillimeve të shkollës dhe arsimit tonë.

Ndonëse autori ka grumbulluar një përvojë jo të vogël në këtë lëmë, pasi ka prezantuar edhe studime të tjera, unë dua ta përgëzoj atë për nismën kurajoze dhe realizimin e një studimi të përmasave të tilla. Autori ia ka dalë t'i dhurojë lexuesit të interesuar për historinë e Dibrës, sidomos atij më të kualifikuar, veçmas punjonjësve të arsimit, miqve e shokëve, njerëzve me të cilët e ka lidhur jeta, puna dhe një përvojë mbi 45 vjeçare në fushën e arsimit dhe shkollës, etj. një libër me rreth 1000 faqe me një përmbajtje të pasur, në të cilin.pasqyrohet historia dhe etapat më të rëndësishme të zhvillimit të shkollës në Dibër. Kësisoj, me punimin e mësipërm, z. Domi, jep një kontribut me vlerë, i cili jam i sigurtë se nga studjuesit e tjerë dhe më të rinjtë, në të ardhmen, do të shërbejë edhe si literatyrë reference, për ta ndriçuar e pasuruar edhe më tej atë.

Së dyti, në tërë përmbajtjen e volumit të tretë të librit që përfshin periudhën 1944–1990 ai argumenton qartë rrugën e vështirë të zhvillimit të shkollës sonë, vendosmërinë e popullit të Dibrës për të çrrënjosë padijen dhe injorancën, ritmet e shpejta të shtrirjes së institucioneve arsimore, reformat e thella që u realizuan në përmbajtjen e saj, forcimin e karakterit masiv e frymës kombëtare, platforma dhe përpjekjet sistematike të partisë në pushtet për ta vënë shkollën në shërbim të saj, ndryshimet e herëpashershme që u aplikuan në strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e shkollës, për t'iu përgjigjur dhe paraprirë stadit të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, etj. Në libër tërheq vëmendjen trajtimi linear i zhvillimit të arsimit në trevën e Dibrës, analiza dhe pasqyrimi i kontestit kombëtar në fushën e arsimit, përqasja dhe ballafaqimi me zhvillimet në shkallë vendi, madje në shumë raste edhe me vendet e rajonit.

Së treti, autori ia ka dalë që edhe në volumin e tretë të librit, që përbën edhe periudhën më delikate të zhvillimit të shkollës, të ruajë karakterin objektiv, realist e shkencor në trajtimin e tërë problematikës komplekse që shfaq kjo etapë e zhvillimit të shkollës. Kompetenca shkencore dhe pajisja e autorit me formimin dhe metodikën e një studjuesi të mirëfilltë profesionist, kurajua civile për të menduar, analizuar e konkluduar në liri të plotë e bëjnë atë të pohojë pa kurrëfarë ngurimi disa nga arritjet më të mëdha të shkollës sonë, si, lufta kundër anafabetizmit dhe triumfi mbi të, puna titanike e popullit dhe e punonjësve të arsimit për shtrirjen dhe masivizimin e arsimit në rreth, i të gjithë hallkave të tij, që nga ai parashkollor, 8-vjeçar dhe të mesëm, profilizimin e tij në përshtatje me veçoritë e zhvillimit ekonomik të Dibrës, përpjekjet e vazhdueshme dhe arritjet e shënuara në përgatitjen e kuadrove e specialistëve të fushave të ndryshme në përputhje me nevojat e rrethit tonë, angazhimi plot ambicie i trupës arsimore të rrethit tonë për cilësi më të lartë në përvetësimin e dijeve nga ana e nxënësve, rezultatet e admirueshme që arriti Dibra në shkallë vendi për sigurimin e detyrimit shkollor, shtrirjen e arsimit parashkollor, zgjerimin e arsimit të mesëm në të gjitha komunat (ish–Këshillat e Bashkuara), në të cilën tërhiqeshin mbi 75 % e nxënësve që mbaronin klasën e 8-të, shtrirjen e Gjuhës së Huaj në të gjitha shkollat e Mesme (28 të tilla) dhe në shumicën e shollave të mëdha 8-vjeçare, plotësimi i planit të pranimeve në arsimin e lartë dhe treguesit në rritje të kalueshmërisë së tij ( Dibra renditej e 5 ose 6–ta në shkallë vendi në vitet 1987-90), investimet e mëdha në tërë inrastrukturën e objekteve arsimore etj. Këto tregues sinjfikativë, sasiorë e cilësorë, pohojnë karakterin afirmativ të përmbajtjes së librit, që sipas mendimit tim, përbën një ndër veçoritë më karakterizuese të studjuesit Xhemal Domi. Karakterit objektiv, realist e të drejtpeshuar, që përshkon tërësisht librin, i ka dhënë shpirt e jetë dhe e bën edhe më të besueshëm për lexuesin faki që autori është jo vetëm bashkëudhëtar i rritjes e zhvillimit të shkollës në etapat më të rëndësishme të saj, por edhe një aktor i rëndësishëm dhe aktiv në këtë proces të gjatë e kompleks.

Së katërti, Duke e analizuar shkollën si produkt historik të rrethanave të kohës dhe një element e instrument i rëndësishëm i superstrukturës që ndikon në ritmet e zhvillimit të vendit, autori ka meritën e dukshme të kritikës së thellë, parimore e objektive të disa dukurive kancerogjene që gradualisht e atrofizonin atë. I qetë dhe i kthjelltë në analizën e përmbajtjes së shkollës deri në vitet 90-të, autori duke nënvizuar përpjekjet për forcimin e karakterit kombëtar dhe rolin e madh të saj në përgatitjen e intelegjencies kombëtare që përgatiti transformimin e madh dhe shembjen e regjimit të kaluar totalitar, ka shënjestruar politizimin e ideologjizimin ekstrem të përmbajtjes së teksteve, programeve dhe aktivitetit jashtëshkollor, mungesën e demokracisë së vërtetë në jetën e brendshme të saj, shtrirjen e luftës së klasave edhe në jetën shkollore, ndikimin e saj në ndrydhjen e personalitetit të nxënësve, izolimin e saj nga kultura perëndimore, madje edhe gjymtimi e censurimi i njohurive të nxënësve për historinë e trojeve shqiptare që padrejtësisht mbetën jashtë kufirit tonë shtetëror, centralizmin e tepruar, tutelën dhe shtrirjen e kontrollit punëtor e fshatar në punën e shkollës, shfaqjet e fiktivitetit në përvetësimin e dijeve, presionet për notë mesatare të lartë e të pameritуar për të shmangur barrierat e vazhdimit të shkollës së lartë, vendosja e trekëndëshit revolucionar mësim-punë–edukim ushtarak, ndikimet e pedagogjisë e shkollës ruse, etj.

Së pesti, karakterin shkencor të përmbajtjes së librit autori e ka bazuar në shfrytëzimin e një materiali të gjerë arkivor, lokal e kombëtar, ka përdorur referenca shkencore të mjaftueshme dhe të besueshme. Ka shfletuar në mënyrë selektive shtypin e kohës, ka studjuar e analizuar një varg aktesh e dokumentesh zyrtare në të cilat përvijohej e përcaktohej rruga dhe prirjet e zhvillimit të shkollës, ka inkluduar pjesë te raporteve e relacioneve të zyrtarëve të kohës, natyralisht e me efikasitet ka përdorë kujtime të tijat dhe të kolegëve sa herë i është dashur të ndriçojë më mirë e t'i bëjë më interesante anë e dukuri të veçanta të saj. Libri merr vlerë shkencore të shtuar dhe bëhet edhe më interesant me pasazhet e veçanta qe autori përmend kur autorit i duhet të evidentojë përvojat e përparuara të shkollave a mësuesve të veçantë. Janë të shumtë këto shembuj aq sa ndonjëherë na ngjallin edhe ndonjë nostalgji, por z. Domi ia ka dalë të jetë i vertetë, pa u bërë prehë e saj. Gjithkush që e lexon ketë libër do të tregojë simpati për mësuesit e artikuluar nominalisht me emer në të sepse ai pasqyron besnikërisht mendimin e opinionit pedagogjike të Dibrës për kohën në vlerësimin e punës së tyre. Në anën tjetër autori nuk ka "harruar" t'i japë vendin e meritуar historisë së arsimit të zonës së tij, Kalaja e Dodës, për të cilën nuk e fsheh krenarinë dhe respektin, ashtu siç kujton e vlerëson me mirënjohje kontributin e kolegëve të tij. Nuk mungojnë në libër narracione të qëlluara për kohë, personazhe e dukuri të ndryshme, me një fjalor të përzgjedhur me kujdes, që e bëjnë atë interesant e të këndshëm në të lexuar.

Në përfundim, duke shprehur konsideratën time të lartë për librin dhe autorin, duke e konsideruar si dhuratën më të çmuar të tij që na bën në 100-vjetorin e Pavarësisë që sapo kremtuam dhe në kuadër të 7 Marsit, duke e vlerësuar atë si punimin më të arrirë rreth historisë së arsimit dhe shkollës për trevën e Dibrës, pa pretenduar karakterin shterrues të tij, dëshiroj të theksoj se veprimtaria e sotme i shërben gjallërimit të jetës kulturore e shkencore të kryeqytetit dhe solidaritetit e konsistencës së komunitetit të punjonjësve dibranë të arsimit, edhe këtu në Tiranë. Njëherazi, më lejoni të pohoj, se si njeri prej ish-drejtuesve të arsimit të Dibrës, e këtu besoj shpreh edhe mendimin e homologëve të mi, ndjehemi krenarë për bashkëpunëtorët tanë, si z. Xhemal Domi, për tërë brezin e kolegëve tanë drejtues shkollash dhe gjithë trupën pedagogjike të rrethit që me seriozitet, pasion e përkushtim të spikatur krijoj atëherë një emër të nderuar në shkallë vendi dhe që edhe sot bëjnë diferencën këtu në Tiranë.

## XHEMAL DOMI



*Lindi në fshatin Ceren të Kalasë së Dodës më 1 maj 1937 në një familje intelektuale me tradita kulturore patriotike. Arsimin fillor dhe 7-vjeçar i mori në vendlindje, në Kala të Dodës. Arsimin e mesëm e kreu pjesërisht në Elbasan (vitin e parë e të dytë) dhe pjesërisht në shkollën pedagogjike në Peshkopi (vitin III-IV), ku dhe u diplomua shkëlqyeshëm. Arsimin e lartë e kreu në Tiranë në Fakultetin Histori - Filologji.*

*Që në moshën 15-vjeçare, pasi kaloi një kurs përgatitor tremujor në Shkodër, filloi punën me përkushtim si mësues fillimisht në Radomirë (1952), pastaj në Ceren (1953-1954), në Mustafaj (1954-1955). Pasi kreu shërbimin ushtarak (1956-1958), emërohet përsëri mësues ku shërben në Gjurrë-Reç (1959), në Ploshtan (1961-1965), në Radomirë (1965-1966) dhe me hapjen e shkollës 8-vjeçare në Radomirë ishte drejtori i parë i saj (1966-1968).*

*Më 1968 shkarkohet si drejtor shkolle dhe transferohet në Lashkizë të Zall-Dardhës ku hapet shkolla 8-vjeçare, nga ku pas një muaji transferohet në shkollën 8-vjeçare në Shumbat, ku shërbeu tri vjet rresht duke përballuar kushtet e vështira ekonomike dhe atmosferike.*

*Gjithkund që punoi, është dalluar për punë vetëmohuese dhe arritje të larta sasiore e cilësore në procesin mësimor-edukativ. Është nderuar me instiktivin "Mësues i dalluar" nga Ministria e Arsimit si dhe me medaljen dhe Urdhrin "Naim Frashëri" nga Presidiumi i Kuvendit popullor.*

*Nga viti 1973-1976 ishte zv.drejtor dhe pastaj drejtor i shkollës 8-vjeçare dhe të mesme (1976-1983), drejtor 8-vjeçarje (1983-1990) dhe mësues në shkollën e mesme Ceren deri sa doli në pension (1990-1993). Është autor i disa punimeve shkencore si:*

*- Historiku i shkurtër i Kalasë së Dodës (1981). Një vështrim i shkurtër mbi të vërtetën historike të Shqipërisë veri-lindore – 1918-1925, "Beteja e Kalasë së Dodës përmbysi planin e Zogut për t'u riorganizuar në Dibër" referuar në Peshkopi, - 1974 dhe në Bajram Curr 1975, "Mbi bajraktarizmin dhe shfaqjet e tij në kohën e sotme" (1980) etj. Në 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit referoi në Shkodër e Peshkopi temën "Malësitë e Veriut forcë goditëse dhe prapavijë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" (1978). Vepra e tij madhore është "Dibra në hulli të historisë - Historia e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj".*

Botime & Studio Grafike

KAPE KOHËN...

për çmime më të lira, shpejtësi dhe cilësi

BOTIME - LIBRA - REVISTA - GAZETA - FTESA -
- FLETËPALOSJE - POSTERA - BROSHURA
- KARTOLINA - KARTVIZITA - SHËRBIM FOTOGRAFIK

PRINTIME ME NGJYRA DHE BARDH E ZI

(04)22 33 283 / 069 20 68 603 / 067 30 73 265 / 068 65 08 441

mbbotime@gmail.com M&B - Botime dhe Studio Grafike

Rruga e Arbërit nr. 82

***- Pasthënie dhe persjatje e librit "Alegoria e Luznisë dhe "gjuha e zogjve"" e autorit Mevlud BUCI-***

alegoria

# Alegoria si kllapedanar i ligjërimit të zhdërvjellët parabolik dhe i transkriptimit logjik

**Nga: Msc. QERAM CIBAKU**

***I. ALEGORIA SI IDEOESTETIKË.***

Alegoria shënon një pamje figurative të përfaqësimit. Ajo buron nga latinishtja e mesjetës e nga greqishtja e shekullit të 14-të dhe ka në trung dy fjalëzat *"allos"* me drejtimin "tjetër apo ndryshe" dhe degëzimin *"agoreuein"* që ka kuptimin me folë. Pra, e folura me një kuptim tjetër është e folur me kuptim simbolik, të ndryshëm nga ajo që dëgjohet; përçues i kuptimeve të tjera larg atij literal e të fjalëpërfjalshëm. Ajo sillet sa tek grotesku (me një tërthore apo kllapë që shpie në kurth bashkëbiseduesin), e gjer tek peripatetikët e hollë të meseleve dhe gjuajtjeve me parabla 120-tshe mbas malit, që ua dëgjon rrapëllimën vetëm kur je lagë e të ka hy ujët ndër petka. Studiuesit e njohin alegorinë si formë e sofistikuar e ligjërimit sipër kokës.

E folmja me mesele ngjan si abstraksion haluçinant, ku biseda e vërtetë zhvillohet gjetkë, larg e shumë larg, në një eter a hemisferë tjetër trollsore, si në gjuhën e programimit Basic, si në matematikën e Bulit apo kodin e Hammurabit... Ajo personifikohet nga një gjuhë utilitare, e dëgjuar pothuajse nga të gjithë, por jo të përdorshme nga të gjithë, posaçërisht mjeshtri e fituar vetëm nga burrat e odave të kuvendimeve. Shpesh bisedat janë të shkurtra dhe ndiqen nga një vakum heshtje, si për ta grish sho-shoqin në këtë delikt; nganjëherë ato mbyllen me finesë, ku hedhësi i "zarit" duket se do të shtensionojë dhe zbusë ngarkesën e bisedës, lëshon zbaticën që ta shpengojë dhe ëmbëlsojë kuvendimin, të lëshojë pé...se "këto janë dokrra bre dokrra, or lum miku!".....

Në këtë interlokucion, gjerësia e këndit midis asaj që drejtpërdrejtë kumtohet dhe asaj që nënkuptohet shkon ngaherë si kithtësi, që kurrë s'takohen. Alegori nuk kultivon vetëm Dibra, por dhe Mallakastra e egër, Mirdita apo dhe zona të tjera të vendit, me shkallë të ndryshme të metamorfozës së saj (si gradacioni rakisë). Por atdheu i dytë i këtij kulmari të rrëfimit të urtisë popullore mbetet Luznia. Ajo është shpotitje e stërholluar e mendjehollësisë, saqë siç e ka shprehur shkrimtari i mirënjohur Xhafer Martini, alegoria "përpush mendjen njerëzore". Rrallëkush do ta besonte se trualli identikit i këtij zakoni është Luznia e Dibrës, vendthi ku njerëzia e tërhekin hollë pa e këputë muhabetin, aty ku burrat mplaken nga këmbët...

Për konsumatorin e rëndomtë e të kabahshëm, e folura konvencionale dhe ligjëruesi i alegorisë duket se "çan trupa pa pykë", "bluan jarëm si dokudo, sa prej këtu e gjer në Krasniqe"....Këto anekdota e rrëfime janë diamante e thesare të lara e të zbukuruara në kllapedanar, që dëgjohen e rrëfen "duke pasur kockë në fyt".

Tipare bazike të alegorisë mund të listohen: ndjeshmëria, mbingarkesa shprehëse (bindje, keqardhje, mendim, habi, zemërim, refuzim, qesëndi, nënqeshje, xhestikulacion, kontekst e kundërthënie), rrëshqitja, anashkalimi dhe kurdisja, shpotitje e shkundje e mexhlisit apo konakut, kthimi kohë pas kohe tek një temë e filluar dhe e lënë qëllimshëm për gjysmë duke u ndërfutur tema apo duke hapur një "rrugë tjetër këmbe" sa për të nxitë dhe një herë unët e zjarrit nga këto fjalëpunues

**Dibranët janë fjalëpunues. Ato ngecen me fjalë në oda, veç ama zbatojnë rreptësinë e porosisë pështjellake të Ciceronit: "Folësi duhet të ketë kujdes në tre gjëra: çka flet, ku flet dhe në ç' mënyrë flet!".**

dhe çekiçët e tyre...që zateten me fjalë dhe paguajnë qiranë e mendjes së vet...

Dibranët janë fjalëpunues. Ato ngecen me fjalë në oda, veç ama zbatojnë rreptësinë e porosisë pështjellake të Ciceronit (*asnjëherë e lexuar prej tyre*):

"Folësi duhet të ketë kujdes në tre gjëra: çka flet, ku flet dhe në ç' mënyrë flet!".

Alegoria është e dashur sa vera e vjetër, se biseda në odat e burrave gjuhet me spond, me konvencion nga një përdorim intuitiv i gjuhës së kursyer, por për ide të largëta; një udhëtim ku bashkëfolësi "ka ngarkuar në shpinë një lojtar rezervë dhe e merr gjithkund në kuvende me vete"... Deshifrimi i këtyre fjalëkalimeve herë-herë është më i vështirë se transkriptimi i serive kohore apo përkthimet nga osmanishtja e përvgjerrun, se ky marifet shumohet përditë, sipas parimit kuvendor "tu ndejtë e xhuxhrru, e tu shkulë urov...". Ai ndërthuret si ligjërim i mysët, bisedë "shtatzënë" e gati në të lindur...një përpajnë e stërholluar e folklorit, një ingredient i pjekur me filozofinë e kuvendimeve të rralla veçmas e maleve, që lum kush i dëgjon, lum kush i kupton, i dyston e ua qet krismën, por ma fort shend e lum kush i ndan si amanet me brezat.

Lexuesi i vlertë mund të shquajë detaje të kuvendimit në këtë almanak mendjehollësie të burrave, përpos këtyre copëzave rrëfmitare:

☞ Një herë në një krahinë të Dibrës, shkoi një i deleguar nga Tirana. Vetulltrashë, hijevrazhdë e gojëzeher, pasi dëgjoj për rezultatet e dobëta të asaj kooperative malore, ku hante pula gur... nuk kursej shtatëqind fjalë pa thënë për t'i sakatuar drejtuesit. Atëherë i gjegji një plak Dibre:

-A e di si asht puna or gjalë? Këtu ke na ashtë fut farë, qit farë, kashta qarë.....".

☞ Në kohën e ndërtimit të qendrave të fortifikimit, bunkerëve dhe pozicioneve e qendrave të zjarrit, një i deleguar i partisë së parë, zbriti nga Tirana e drejtë e në bjeshkët e Korabit, ku brigada me njerëz, në pik të zhegut, i sillnin kupaçes (kazmës) dhe mbartnin në kep të krahut elementet e qendrave të zjarrit.

-A u lodhe or shok?-i flet i deleguari nga maja e makinës një fshatari që kishte ngarkuar bandierat mbi shpinë. Fshatari pa folur bën një gjest duke vënë gishtin nën gushë si për t'i thënë se po na del shpirti, ndërsa djersët i piqeshin klladë ndër gushë.

Sakaq makina ecte nëpër ato malore, i deleguari kthen vështrimin hetues njërit prej banorëve të asaj zone, që e shoqëronte:

-Çfarë tha ai fshatari?!

-E, or shoku i deleguar. Thotë, me më dalë shpirti, nuk i lë pa çuar këta elementë atje ku ka urdhnue partia,- i futi stërkëmbshin bisedës dhe devijoi rrjedhën e fjalës vendasi.

***2. ALEGORIA SI STOLI GJUHËSORE, KONVENCION E DEFINICION.***

Studiues të ndryshëm i janë sjellë butësisht dhe kanë mundë me nxjerrë në dritë kuptimet personifikuese të dyfishta të kësaj forme të stërholluar interkomunikimi:

-kuptimin literal (shkronjor, tekstual e të drejtpërdrejtë) dhe

-kuptimin simbolik (figurativ, dytësor, indirekt, emblemor).

Pikërisht, ky ekspresion i përdorimit të kuptimit i figurave të trilluara simbolizuese, mundëson përcjelljen e kuptimeve të tjera përveç kuptimit sipërfaqësor e të ashtu dëgjuar. Alegoria komunikon mesazhin e saj nëpërmjet figurave, aksioneve, veprimeve dhe përfaqësimit simbolik. Ajo trajtohet nga literatura si figurë retorike. Si instruksion letrar alegoria në kuptimin e saj më të përgjithshëm është një çetë e zgjeruar e metaforave burimore, muhabete me të rrëshqitme, ku objektet, personat e veprimet në rrëfim, transferohen me kuptimet që shtrihen jashtë rrëfimit. Etimologjia e alegorisë supozohet se buron nga shekulli i 14-të. Stofra të saj janë anekdotat, ndërfutja e përdorimi në tregime i fjalëve të urta, bendet dhe replikat në distancë, rrotullat, nëmat e urimet, kunjat dhe shifrat, ritualet etj.

Burime të ndryshme i qasen zbërthimit të këtij nocioni gjuhësor nga kënde të ndryshme. *Kështu,*

**"English Thesaurus",** (botuar nga "Geddes & Grosset", Skoci, edicioni 10, faqe 15) i jep këtë veshje kontekstit të alegorisë dhe shprehjeve alegorike: apologji, fabul, mit, rrëfenjë, parabolë, legjendë transformim politik etj.

**1.** E pyetën një plak të sotshëm për trazirat e politikës pas zgjedhjeve të 28 qershorit, teksa rrufiste një filxhan kafe:

-E, si të duket koha sot, or mixhë?

Plaku heshti.

U nxiti prapë unëve të bisedës i riu:

-Hë pra or mixhë, a je tu ndijë?

Plaku s'foli.

-Gjegj këtu or djalë! Mëngjesi e ka lëkurën e hollë!

U nguc sërish djali:

-Koha, si të duket?

Atëherë u gjegj plaku:

-O rini, për të ndijë, jam tu ndie, por s'po di me ta kthye. Njëherë për njëherë ka ra lëmshi në shkozë, e o ngatërrua nëpër krande...

**2.** -Ene një kërkesë kam,- foli njëri nga pjesëmarrësit, në grumbull të njerëzve të mbledhur si miza në qyp të mjaltit.- I thoni doktorit të mos na bije më farë të huaj se dhe vjet s'u bë, veç brollet morëm. Nuk e bën toka.

-I ka dëmshpërblyer Qeveria lek më lek, -ia kthen frymë për frymë njëri nga oratorët.

Dikush tjetër, që nuhat muhebtin, teksa kruan kokën i pëshpërit shokut në vesh: nuk e ka për tokën e për farën ky jo, se s'ka punuar tokë ndonjëherë në jetë të vet, po e ka fjalën për kandidatët...

Teknikë a zhanër i përfaqësimit, simbolikë dhe instrument i të vërtetave dhe moralizimit, një stoli, poemë, lojë, emblemë a pikturë, ku dukja e karaktereve dhe ngjarjeve të përdorura simbolizon në fakt një moral ose një vënie në lojë, -nënvizon **"Collins English Dictionary"**, (shtypur në Britani të Madhe, botimi 6, faqe 42). Pra, alegoria është dhe moralizim logjik apo vënie në lojë e naivitetit....

**1.** Vdiq një plak në një katund të Dibrës dhe brofën mileti për kryet shëndoshë. Një jabanxhi që punonte në ato vise, i ardhur nga zonat e jugut si dublant e për shkëmbim përvoje, u bashkua me do burra që ishin nisë për qeksojë.

-Ka do adete e rregulla, këtej nga ne,- i tha njëri dublantit,- Ti duhet të prijsh përpara se je jabanxhi, duhet të ulesh në krye të vendit, t'i ngushëllosh njerëzit kujt t'i takoje dhe ta pish filxhanin e kafesë me fund.

Ashtu bëri dublanti: u ul në krye të vendit, ngushëlloi sipas formës së vet, mori filxhanin dhe e rrufiti kafen e nxehtë me fund. E dogji dhe e përvëloi e nxehta e ithët gjer në tepe të kresë... Burri që bënte hyzmet, përkuli me respekt trupin dhe sipas zakonuit ia afroi sërish ibrikun e kafesë, si për ta pyetur të huajin nëse donte kafe tjetër.

-Të vdesin të tërë, unë nuk pi më kafe me fund,- tha jabanxhiu që u çua nxitimthi përjashta pa e kuptuar lakun e mbështjellun.

**"Oxford Advanced Learner's Dictionary"** (viti 1995, faqe 30), e cilëson kategorinë teorike të alegorisë si histori, lojë, mishërim, ku karakteret dhe rastet jepen përmes simbolikave të përfaqësuara.

**1.** Kur Marka Brunga zgjidhi gjalmat dhe u rehatua në krah të oxhakut të odës së miqve në kullën e Murat Kaloshit, i zoti i shtëpisë urdhëroi me sy që ti bëhen gjithë nderet mikut prej Mirdite. "Të theret kau, por në sofër t'i vendoset një lugë e vogël për ngrënie"- porositi shërbëtorët.

I unët nga rruga e gjatë, mysafiri, si u shtrua në sofër, e shoqëronte kafshatën e bukës me dy-tre lugë gjellë, ngaqë i kishin vënë përpara lugë të vogël kafeje.

-Oj Merditë, kur vdes kush ka ju, ka sa veta futni me nji varr, ka dy a ka tre?

-E, or Murat Aga...simbas trupit. Me qenë të vegjël, ka dy e ka tre, me qenë trupmëdhenj, ka një.-ia ktheu qetësisht Marka Brunga.

Murat Kaloshi u bëni shenjë hyzmeqarëve të mbushnin sofrën e ti dërgonin lugë ngrënie Marka Brungës...

**2.** Jo e jo! - i pati thënë kërkesës së qeverisë, një njeri i mirë që e kishin projektuar si kandidat për kryetar komune në një fshat të largët me qytetin, në Dibër. Kur e pa se s'kishte derë tjetër, u detyrua të pranojë, por me do kushte:

-E para: të ma shtroni rrugën me asfalt nga dera e shtëpisë e deri tek zyrat e komunës... (që mos e vras mendjen me vjedhë)....

-E dyta: cuca ime të punësohet centralist e komunës (që të marr vesh se ç' thuhet për mu dhe ç' bëhet këndej përreth nga komuna deri në qytet).

-E treta: njërin djalë të ma punësoni në SHIK (që të di se ç' bëhet nga qyteti gjer në kryeqytet)....

Alegoria në **"Fjalorin e Shqipes së Sotme"** (botim i Akademisë së Shkencave, viti 1984, faqe 15), ilustrohet si shprehje e ideve tërthorazi; fjalë e shprehje prapa të cilave fshihet një domethënie tjetër.

Në vitin 1964, tre funksionarë të shtetit të asaj kohe,të tre nga Golloborda, shkojnë miq në një shtëpi Methasanësh në Sohodoll. Njëri prej tyre, Rifat Tola, atëkohë Kryetar i Gjykatës së Rrethit e pyeti Idriz Elmazin:

-"Or xha Idrizi,a na thua sa male ka

# kulturë

**Në fillim studiuesi Buci të krijon përshtypjen e një indiferenti rrëfimtar, por, vetëm sa lë pas pjesët e para të librit, befasohesh kur ai na kalon në revistë fise e lisa, valëzime grunjërash e grunesha, rrapëllime strugjesh e pellgje kërthizakë ujëdrinas, të cilët shkumbohen dhe shpërhapen si valë antenash e dëbohen kumbueshëm kushediseku...Lexuesi i vlertë a dibrani i mirë, pasi ta rilexojë librin, do t'i shtojë një kut egoizmit për fisnikërinë e kësaj nahije...**

**Në katrahurën e përpjekjen jetësore gjithë ngjitje e zbritje, batica e zbatica, gjithkush u vë mendjen punëve dhe halleve të veta në vrapin e itinerarit të jetës së ngarkuar me një pështjellak hallesh.**

Dibra,e për ma fort, kush është kryemal ndër ta?

Idrizi,si e dëgjoi, përgjigjet:

-Or shoku kryetar, ju ini me shkolla të nalta dhe e dini ma mirë se unë kush janë malet e ç'farë historie kanë!

-Jo, jo.Unë e kam qejf të ma thuash ti se je burrë i zgjuar,-insistoi Rifati.

- Male kanë qenë nëntë, por nuk janë ma nëntë. Tani janë ba dhjetë male!

Miqtë takuan vështrimet, pa kuptuar se ku do të dilte Idriz Elmazi.

-E kush është ky mal, or mixha Idriz?-pyetën mysafirët thuaj për një fryme.

-Mali i dhjetë e kryemali është Golloborda,se ju jini nga ajo zonë e drejtoni rrethin e Dibrës. Kur doni ju të tre i thirrni, i mblidhni e i shpërndani nëntë malet e tjera. Pra, a nuk jeni kryemal?!

-Na ngave,or mixha Idriz,-ia kthyen miqtë me të qeshur,

-Ju u ngatë vetë bre, se nantë malet e Dibrës i di ene Stambolli e jo mo Golloborda, or shoku kryetar,-hazër xhevap përgjigjet oxhaku i Methasanëve.

### *3. ALEGORIA DIBRANE DHE PRIJËSIT E GRIGJËS SË SAJ.*

Alegoria dibrane është filozofi popullore, ylber fjale e kumti, një margaritar inteligjence natyrore e hajmali në të folmen e menduar dibrane, po aq e vyer dhe e barasvlertë sa gravurat mesjetare dhe isopolifonia, ndaj dhe ky relikt origjinal i botës duhet konservuar e kuruar si margaritar e vlerë kombëtare. Në rrëfimet e këtij karakteri, fjala mund të mehledisë plagën si melhem, por mund të fshikullojë e djegë si hithra nëpër vegë. Kësi rastesh, qëllimi është që me fjalë "ta zhdeshësh tjetrin", ndaj kjo gjuhë e folur është një afresk e këmbanare mençurie.

Kontribute të vlerësueshme në mbledhjen e këtij poleni lëndor krejt të veçantë, eksplorimin e kaltrinave të këtij korpusi thellësish të mendimit, zbërthimin e fjalëkalimeve dhe ngarkesave emocionale në analiza paravajtëse soc-linguistike dhe psiko-estetike, (sidomos në inercinë e turravrapin e gjuhës së komunikimit në distancë dhe gjuhës së tregtisë), rikthimin në këtë doktrinë që meriton gjallnime, e kanë disa kalorës të letrave, të cilëve u falemi pakursimisht me përulje mirënjohëse.

- Kanë mbledhur bujarisht e rrëfyer me kontribute eksponenciale alegori e rrëfenja nga gurra e urtisë së trevave dibrane Haki Stërmilli, Hilmi Kolgjegja, Xhelal Ndreu, Dr.Laurant Bicaj, Naim Plaku, Sakip Cami, Prof. Arian Kadiu, Shaqir Skarra, Hasan Leka, Fatos Daci, Dukagjin Hata, Vesel Hoxha, Ramiz Gjini, Hasan Shahinaj, Bajram Hyseni, Ilmi Dervishi, Ymer Elezi, etj.
- Kontribute të përkora, rreth karakterit studimor, larmisë, shtjellimit gjuhësor e leksikor, diftongut e degustimit, zbërthimin lëndor të alegorisë dibrane, evokimit të "morfologjisë dhe sintaksës së saj", kanë veçanërisht ç'kodifikuesit dhe transkriptuesit e këtij ligjërimi sofist e të besueshëm, i cili shpaloset përmes një korpusi punimesh të këtyre studiuesit:

1. Hazis Ndreu, me veprën "Alegori dibrane", (Tiranë 1999, botuar nga Eurorilindja, faqe 174), botuar fillimisht në vitin 1983 me titullin "Tregime Alegorike Dibrane".
2. Xhafer Martini, me veprat studimore "Perlat e Dibrës" (Tiranë 2008, Kristalina KH), dhe "Kanuni i Dibrës".
3. Dr. Agron Tufa, me veprën "Dibra në optikën e të huajve", kapitulli "Paravolitë alegorike dibrane", (Tiranë, 2008, shtypur n "M&B", faqe 58-68).
4. Hajri Mandri me veprën "Shëmbëlltyra në folklor dhe letërsi: një vështrim i posaçëm i alegorisë dibrane".(Tiranë 2009, shtypur në "Naimi", faqe 264).
5. Mevlud Buci, me veprën "Alegoria e Luznisë dhe gjuha e zogjve", (Tiranë 2010).

### *4. PERSIATJE DHE SHKURTIMORE PASTHËNËSE.*


Rilexoj dorëshkrimin dhe nën zë vë buzagazin për mbishtesat e korrigjimet dhe fjalët keqeshkrojë, që me "qejfmbetje" autori u ka lëshuar një vizë përsipër për ti hequr, duke i redaktuar butësisht. Studiuesi Mevlud Buci s'ka rreshtur së renduri. Turravrap i tij përpiqet ti mbyllë të gjithë shtigjet e vathës dhe ti mbledhë për së pari herë të gjithë: të gjallët e të vdekurit bashkë në një kuvendim ndryshesoj.

I cek dhe i tungjat të gjithë: të gjallët e zotë dhe jo të gjallët edhe më të famshëm e kryenaltë... Na i shtrin si shirit: pemë gjenealogjike fisesh, epizëm me vargje kënge, anekdota që ënda ta ka ti pish ngadalë se mos sosen... kolosë dheu që kanë bërë historinë e vet e të kohës, personazhet e gjallë të "Njeriut me top", gurgullime gurrash e krojesh, frazeologji e anektoda që na e hollojnë inteligjencën tonë.

Në fillim studiuesi Buci të krijon përshtypjen e një indiferenti rrëfimtar, por, vetëm sa lë pas pjesët e para të librit, befasohesh kur ai na kalon në revistë fise e lisa, valëzime grunjërash e grunesha, rrapëllime strugjesh e pellgje kërthizakë ujëdrinas, të cilët shkumbohen dhe shpërhapen si valë antenash e dëbohen kumbueshëm kushediseku...Lexuesi i vlertë a dibrani i mirë, pasi ta rilexojë librin, do t'i shtojë një kut egoizmit për fisnikërinë e kësaj nahije...

Në katrahurën e përpjekjen jetësore gjithë ngjitje e zbritje, batica e zbatica, gjithkush u vë mendjen punëve dhe halleve të veta në vrapin e itinerarit të jetës së ngarkuar me një pështjellak hallesh.

Mu kujtua se në një rrugëtim, një grua e panjohur përmes një psherëtime, i tha dikujt:"I kam shtatëqind halle, e m'u ka shtu dhe një...". Por ngado të sillet bota me baulen,trastën e ngratë të halleve ngarkuar, prapëseprapë, do të avitet e do të mbërrijë ngadalë-ngadalë tek e para dhe e mbramja e botës: tek Fjala! E këtu alegoria Dibrane, edhe falë këtij kontributi të studiuesit frymëtar e fjalëpeshuar Mevlud Buci, bëhet bujtinare në shtëpinë e vet...




Arbër Sh. Cami. **Kalatë shqiptare**
Botimet "M&B". ISBN 978-99956-04-97-4
64 faqe. 500 lekë - Tiranë, 2013.

# Kalate shqiptare

## *Një album fotografik me ngjyra në gjuhën shqipe dhe angleze, i shoqëruar me shpjegime plotësuese nga Arbër Sh. Cami*

Puna plot pasion e autorit Arber Sh. Cami , student ne Universitetin e Mynihut , Gjermani kalon cdo kufi. Me aparat fotografik ne duar ai ka shkelur ne cdo skaj te viseve shqiptare dhe ka skalitur ne celluloid historine tone . Ky vellim eshte ne dy gjuhe, shqip dhe anglisht, ndersa vellimi i dyte dhe i trete do te jete ne tre gjuhe , edhe ne gjuhen gjermane.

Vellimi i pare i ketij albumi permban pamje nga Kalaja e Shkodres, Kalaja e Lezhes, Kalaja e Krujes, Kalaja e Prezes, Kalaja e Rodonit, Kalaja e Petreles, Kalaja e Boshtoves, Kalaja e Beratit dhe shpjegime plotesuese.

Sigurisht, lexuesit dhe shikuesit shqiptare e njohin historine dhe i kane vizituar kalate kryesore shqiptare, por autori i ketij albumi sjell pamje te panjohura te Kalase se Boshtoves dhe te Rodonit si dhe pamje te brendshme te kalave shqiptare.

Ne vellimet e dyta dhe te treta do te pasqyrohen te gjitha kalate shqiptare ne te gjitha trevat shqiptare.

Pak nga historia e kalave

Per çdo kala autori ka shkruar edhe historine e saj.

Kalaja e Shkodres , si qender e fortifikuar ilire permendet per here te pare ne kohen e sundimit te mbretit ilir Genti. Ajo del me emrin Rozafa ne periudhen e mesjetes. Ze nje siperfaqe prej 9 hektaresh.

Edhe Kalaje e Lezhes ka origjine ilire. Ne vitin 1440 ajo ju nenshtrua nje rindertimi nga venedikasit. Ketu mund te shikohen gjurme te arkitekturave ilire, romake, bizantine dhe osmane. Prej saj shihet nje pamje e bukur e Fushes se Lezhes dhe e Detit Adriatik.

Kalaja e Krujes ze nje siperfaqe prej 2.5 hektaresh dhe eshte ngritur ne nje koder shkembore. Kalaja eshte ngritur ne shek. V, VI. Ne shekujt XIII, XIV ishte qendra e shtetit te Arberit. Gjate periudhes se Gjergj Kastriotit, Skenderbeut, u be kryefortesa e qendreses se shqiptareve kunder pushtimit osman.

Kalaja e Prezes u ndertua nga Fisi i Parthinit (me vone pjese e Taulanteve) Kjo kala eshte ndertuar prane fshatit Preze te Tiranes ne shekujt XIV, XV. Kalaja u perkiste Topiajve. Ajo ka 4 kulla, nje ne cdo cep. Kulla e sahatit u ndertua me vone rreth viteve 1800, 1850.

Kalaja e Rodonit ndodhet ne Kepin e Rodonit. Kjo kala filloi te ngrihej pas rrethimit te pare te Krujes ne vitin 1450 dhe mendohet te kete perfunduar pas dy vjetesh. Muri i keshtjelles se Rodonit arrinte ne nje gjatesi prej 400 metrash dhe ne kulmet e saj kishte kulla te rrumbullakta. Ne vitin 1500 kalaja u pushtua nga Venediku. Nje pjese e mureve te kalase, sot eshte e zhytur ne Detin Adriatik.

Kalaja e Petreles. Sic del nga studimet e bera eshte ndertuar ne kohen e sundimit te perandorit bizantin Justinianit te Pare, ne shek VI pas Krishtit.Eshte ne forme trekendore , ndertuar ne maje te malit dhe ka dy kulla impresionuese. Eshte rindertuar ne shekujt XV, XVI dhe eshte mirembajtur deri ne ditet e sotme.

Kalaja e Bashtoves ngrihet prane fshatit te Bashtoves , ne nje distance prej 3, 4 km ne veri te grykederdhjes se Lumit te Shkumbinit. Kalaja eshte ndertuar ne shekullin XV dhe u ka sherbyer venecianeve. Kalaja ka trajte katerkendore me permasa 60 X 90 metra. Muret e saj kane nje lartesi prej 9 metrash. Ajo gjendet ne nje reliev fushor.

Kalaja e Beratit eshte e ngritur ne nje koder 187 metra te larte , ne te djathte te Lumit Osum, duke dominuar luginen e tij dhe zonen perreth.Fillimet e saj datojne ne shek V para eres sone. Shtrihet ne nje siperfaqe prej 10 hektaresh me mure rrethuese me nje gjatesi prej 1400 metra. Muret perforcohen nga 24 kulla. Ndertimi i saj karakterizohet nga periudha te ndryshme si ajo ilire, bizantine dhe shqiptare.

Ky liber ne formen e albumit eshte nje kontribut domethenes per shoqerine shqiptare dhe vecanerisht per brezin e ri, per njohjen e historise dhe te vlerave turistike te vendit tone.

***B. Karoshi***

Rruga e Arbërit nr. 82
studim

# Shkëlqimi, rënia dhe demonizimi i parisë

*(Vijon nga faqja 11)*

në kryengritjen e antiturke të 1912-ës dhe në periudhën e përgjakshme 9-vjeçare me serbet, u plagos për vdekje më 16 dhjetor 1924 në betejën e Peshkopisë, teksa mbronte Qeverinë e Fan Nolit. Vdiq në Sllovë nga plagët e marra më 29 dhjetor duke luftuar me nipin e tij Sufë Xhelili, përkrah forcave qeveritare për të mos lejuar futjen e Ahmet Zogut në Shqipëri nga ana e Dibrës. Pro Zogut luftuan edhe dy dhëndurët e Elezit; Dine Hoxha dhe Murat Kaloshi. Në prag të vdekjes ai tha "Punova për Komb e Atdhe. ….këta njerëz që unë u pata ba kaq nder më dhanë besën, por më tradhëtuen".[14] Gjenerali me shajak, Elez Isufi, që nuk u vra nga topat e ushtritë turke e serbe, njeriu që për "nandë vjet me radhë kishte luftuar me krajla", siç thotë kënga, u vra nga bashkëluftëtarët e tij më të ngushtë duke i vënë Dibrës njollën më të madhe të turpit e të tradhëtisë. "Serbët kanë gostitur këdo që kanë patur pranë, kur kanë marrë vesh vrasjen e Elezit",-kujton I. Strazimiri, ndaj ai mallkon: "Qofshun të mallkuar ata njerëz që të mundun nga mënia e lakmia mbollën farën e dasisë e t'urrejtjes në mes të personit të vleshëm t'Ahmet Zogut dhe të njeriut të plotfuqishëm e të ndërgjegjshëm të Elez Isufit"[15]. Bashkë me Elezin u vra dhe nipi i tij Sufë Xhelili, një hero dhe prijës i madh në luftrat antiturke e antiserbe, një "trim, i mençëm, i përvuajtun, gojëambël, zemër bardhë. Përmendësh për besën që kishte zakon me mbajt. Po të jetonte, ky mund të zinte vendin e Elezit".[16] Me vrasjen e Elez Isufit e të Sufë Xhelilit pushoi rezistenca antizogiste në Dibër, por jo vrasjet e kundërshtarëve antizogisët. U vranë Bajram Curri, Avni Rustemi, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Zija Dibra, Halit Lleshi dhe senatori antizogist Ramiz Daci (prefekti i prefekturës së Drinit ose ndryshe Qeveria e Arrasit) dhe kryekomandant i kryengritjes dibrane antiserbe të 1920-ës që nisi në Arras. Ramiz Daci u vra prej xhindarmërisë te Ura e Gjytetit, në kufi të Grykës së Madhe në Bulqizë. "Kufoma e Ramizit të pafajshëm, kundër zakonit shqiptar dhe kundër njerëzimit e qytetërimitt, u ç'vesh dhe ditë me radhë u la në rrugë të madhe."[17] Zija Dibra u arrestua nga xhandarët e Zogut dhe u vra në gjyq. Të njëjtin fat si kundërshtarët antizogistë pësuan dhe krerët prozogistë e nacionalistët të shpallur antikomunistë pas ikjes së Zogut dhe pushtimit Italian. Miftar Kaloshi u vra më 1943 në Peshkopi në përpjekje me forcat komuniste. Dine Hoxha, Shaqir Dema e Riza Lusha (shtëpia e të cilit u bë selia e Qeverisë së Arrasit, që organizoi kryengritjen antiserbe të 1920-ës) nuk u nderuan për veprën patriotike, ndërkohë trashëgimtarët e tyre provuan dhunë të pashembullt gjatë regjimit komunist. Halil Selim Alia, kryekomandant i forcave nacionaliste dibrane gjatë vitit 1939-1944 u vra nga komunistët në Kolesian të Kukësit pa mbushur akoma 36 vjeç. Trupi i tij u varros buzë Drinit, por nga frika e terrori askush nuk guxoi ta çvarroste njeri për ta rivarrosur me nderime në Fushë-Alie. Tani varri i tij është mbuluar nga liqeni i Fierzës. Ai la pas një djalë dhe dy motra (Halifen e Xhemilen), të cilët në vitet e para të regjimit komunist u arratisën në Australi për t'u rikthyer pas viteve 1992. Djali i vetëm i tij, Sala vdiq nga fruthi pa mbushur akoma 5 vjeç. Dali Ndreu (djali i Sufë Xhelilit), një ndër 4 gjeneralët e parë shqiptar të pasluftës u pushkatua pa gjyq nga regjimi komunist më 25 dhjetor 1956. Me të u pushkatua shtatzënë edhe bashkëshortja e tij Liri Gega (anëtare e Byrosë Politike). Dy herë u burgos komandanti i Forcave Vullnetare të Ujë e m'Ujës, Beshir Sufa. U internua në Ballsh, Esat Ndreu, komandanti i forcave vullnetare në Dibër. Ibrahim Doçit, prijësit të betejës së Lanë Lurës i burgosën djalin ku edhe vdiq. Gjatë regjimit komunist (1944-1991) u arrestuan, u burgosën e u vranë shumë pjesëtarë të parive dibrane. Terrori e persekutimi më i madh ra mbi Aliajt, Nokën, Lushën, Bitrin, Spatën, (Fushë-Alie), Kaloshët (Kandërr), Ndretë (Sllovë), (Homesh), Tafet (Sohodoll), Dinët (Maqellarë), Demet (Homesh), Sevdarët (Deshat), Kaziu (Selisht), Dine Hoxha (Muhurr), Camët (Viçisht), Lleshët (Zogaj), Menet (Lurë), Litet (Ploshtan) etj. Për t'i shpëtuar luftës politike, Murat Kaloshi u largua nga Shqipëria në prill 1939 dhe vdiq në mërgim. Uke Cami u rratis në në Dibër të Madhe, Cen Elezi (Ndreu), djali i Elez Isufit, u arratis në Shkup, por atje u burgos dhe vdiq më 9 maj 1949 pasi kishte shkruar në qeli fjalët lapidare "Tradhëtia ndaj atdheut nuk falet, sado të mira të bësh më pas". Dy muaj më parë në këtë burg kishte vdekur edhe Dan Kaloshi. Mbi prijësit e luftrave antiturke, antiserbe e antikomuniste, që nuk mundën të arratisen ra furtuna komuniste. Selim e Sulë Kaloshi u pushkatuan nga komunistët në Peshkopi. Haxhi Noka vdiq në burgun komunist të Tiranës. Shaqir Tahiri, ish zëvendës qark komandant i Dibrës kaloi shume vite në burgjet komuniste. Dervish Lusha, Isuf bajrakatari (nipi i Selës Bajraktarit) u kap nga forcat partizane dhe u pushkatuan. Lista e të pushkatuarve, të burgosurve e të internuarve është tepër e gjatë sa nuk e nxënë qindra faqe. "Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar "paria e Dibrës" u damkos e u demonizua, jo vetëm për aq sa i takonte pjesës së bashkëpunimit me pushtuesit, por edhe në mënyrë prapavajtëse, "brezi para brezit" (pa folur për "brez pas brezi").[18] Hakmarrja ndaj parisë dibrane vazhdoi edhe pas demokracisë. U dënuan me burg nga kundërshtarët politikë, Haxhi Lleshi, ish kryetar i Presidiumit Popullor (Kuvendit), një ndër komandantët më të njohur të ushtrisë çlirimtare të Dibrës. "Armiqësitë në Ballkan qenë aq të kahershme e të fuqishme saqë ata kishin zënë rrënjë në përbërjen gjenetike të banorëve të këtij rajoni…Popujt e Ballkanit kishin ndjekur një rrugë tjetër evolimi në të cilën gjaku dhe hakmarrja kishin qenë forma të parapëlqyera të dialogut politik.[19] Zogu ishte implikuar në plot 600 hasmëri gjaku, disa prej të cilëve me familje shumë të rëndësishme. Lista e gjatë e viktimave të tij përfshinte 6 krerë fisesh të Mirditës, një numër klerikësh dhe shumë politikanë të shquar[20]. Ai përdori vrasjet, torturat shantazhet dhe ryshfetet të paparë deri atëherë në historinë shqiptare.[21] "Zogu çau me forcë rrugën për tu kthyer në pushtet. Ai mobilizoi një forcë ushtarake heterogjene me njerëz të fisit të vet, matjanë, dhe me njerëz nga fise të tjera shqiptare të Veriut me ushtarë të komanduar prej gjeneralit Vrangle, udhëheqësi bjellogardist, që sapo ishte kthyer nga fushata në Bullgari. Megjithatë, gjatë afro 4 vjetëve pas kthimit në pushtet më 1924, Zogu luajti një rol të zgjuar e të lavdërueshme"[22], ndërsa "Hoxha e fuqizoi vizionin e tij të unitetit të shqiptarëve me anë të një ksenofobie të hatashme[23]. Gjatë 41 viteve të Hoxhës në pushtet, 7 ministra të Brendshëm, të ngarkuar drejtpërsëdrejt me vënien në jetë në spastrimeve janë spastruar vetë.[24] Frikësimi ndaj kulakëve i'a kaloi për egërsi edhe fushatës në Rumani.[25]

## POSTMORTIUM

Në periudhën 45-vjeçare komuniste, kundërshtarët u quajtën armiq dhe u dënuan barbarisht, ndërkohë pas 1991-ës, nacionalistët u quajtën heronjë dhe krerët e luftës komuniste tradhëtarë. Historia do t'i ndajë "tradhëtarët "dhe "heronjtë e vërtetë", por intrigat, tradhëtitë, vrasjet, midis parisë dibrane për pushtet janë më të mëdha se sa gjatë luftërave me turqit, serbët, bullgarët e nazifashistët. Në luftërat antiosmane (1421-1912), antiserbe 1912-1921 krerët e parisë dibrane ishin shumë të bashkuar duke arritur suksese të mëdha, por hyrja në lojë për pushtet e Esat pashës Toptanit, Ahmet Zogut dhe Bajram Currit, e ndanë më dysh parinë dibrane ku viktima të saj u bënë fshatarët e varfër, ndërkohë ofiqet, postet e dekoratat i morën bajraktarët e tyre. Shprehja që "dibranët e kanë pushkën përbrenda", tashmë është realitet. Ka ardhur koha që dibranët nuk duhen të mburren më me "Nantë malet". "Ne dibranët vetë, duke u mburrur me "nand malet", në fakt jemi mburrur me një gjendje fisnore, me gjendjen e rregullimit parashtetëror të jetesës në bashkësi. Unë vetë çuditem kur dibranët monumentalizojnë "nand malet". … Me formimin e shtetit kombëtar, fiset, semtet, bajraqet, kararet, malet, mbeten kujtime të së shkuarës, jo nyja të historisë së re. … Kësulat e bardha" të mençurisë dibrane duhet të na kujtojnë thënien e mirënjohur të filozofit danez Kierkegaard: ato mund të jenë një parashutë shpëtimtare, nëse në to është një mendje e hapur; por mund të jenë thjesht një bunker vetëvarrosës, nëse nën to është një mendje e mbyllur".[26] Në pasthënien mbi librin "Lufta kundër pamvarësimit të Shqipërisë", me kujtime të Ismail Strazimirit, botuar nga Sh. Botuese "Naimi", Prof. Dr. Shaban Sinani ndër të tjera shkruan:"Shqipëria e viteve 1912-1924, siç na e tregon në librin e tij Ismail Strazimiri, ishte një shtet etnografik-tribunal, ku ligjin e bënin krerët e fiseve, një shtet që nuk ishte as monarki as republikë, një shtet ku krahina shpallnin pavarësinë prej atdheut dhe ruanin me ushtarë vulletarë "kufijtë" e tyre, urat, shtigjet e kalimit. Nga Shpallja e Pavarësisë deri te Revolucioni i Qershorit ka mbrapshti sa për disa shekuj. Shqipëria u bë, por jo siç e deshën shqiptarët. U bë një Shqipëri që zyrtarisht thuhej se vërtitej në duart e Fuqive të Mëdha, por vërtetësisht rrotullohej sipas konkurrencës së parave të dhëna "krenëve" të saj nga Beogradi, Athina, Stambolli, Viena dhe kryeqendra rë tjera të politikës botërore. ….Shqipëria u ndorua prej "krenësh pa krye" që e shisnin jugun për dishir" të Veriut dhe anasjelltas; që i'a falnin dreqit të krishterët për një Shqipëri të bekueme muslimane. … Libri i Ismail Strazimirit është dëshmia se parësia shqiptare nëse mund të kuptojmë me këtë klasën qeverisëse me pushtet politik të mbështetur mbi tagrin etnozakonor, që për fat të keq vijon edhe sot, përgjatë kohëve nuk dëshmohet gjithnjë njëlloj. Ka anën e vet të errët e të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin E në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut",
-përfundon Prof.Sinani.

**M.HOXHA**


1. Kristo Frashëri, "Historia e Dibrës", Botimet M&B, 2012, f. 79
2. Gjon Muzaka, "Memoranda", Napoli, 1510
3. Raffael Volaterrani, "Komentarët"
4. Historia e Popullit Shqiptar, Tiranë, 2005
5. Shaban Sinani, pasthënie, "Lufta kundër Pvarësimit tw Shqipërisë, të I. Strazimirri nga "Naimi", f. 344
6. M. Sufflay: "Serbët dhe shqiptarët, Tiranë 1926, f. 88
7. S. Ljubic. Listine X, 1891, f. 444.
8. K. Frashëri, cituar, f. 171
9. Ali Këlcyra "Historia e beut që u zhgënjye nga bolshevizmi e propaganda ruse", Metropol, 18. 02, 2013, f, 18)
10. Bajram Xhafa, "Lufta e Dibrës e 192-ës, f.77.
11. Marin Barleti: "Historia e Skënderbeut"
12. Ilirian Gjika: "Enigma e vendvarrimit të Skënderbeut", "Metropol?, 17.01. 2013, f. 16.
13. Fan Noli, vepra 4, f. 183
14. I. Strazimiri, Lufta kundër pamvarësimit të Shqipërisë, botimet "Naimi", f. 163.
15. Po aty, 119
16. Po aty, 163
17. Po aty, 146.
18. Shaban Sinani, Dibra stacioni i punës sime krijuese, Rr. Arbërit, maj 2012, f. 5, intervistë dhënë Mentor Hoxhës
19. Misha Glenny: Historia e Ballkanit (1804-1999), botimet Toena.
20. Misha Glenny, po aty, f. 413.
21. Mishha Glenni, po aty 414
22. Misha Glenny, po aty, f. 414
23. Misha Glenny, po aty, f. 560
24. Misha Glenny, po aty, f. 561
25. Misha Glenny, po aty, f. 564,
26. Sh. Sinani, Dibra stacioni i punës sime krijuese, Rruga e Arbërit, Maj 2012, f. 5, intervistë dhënë Mentor Hoxhës




# Libri "Kur loton qielli..." nuk derdh lot

**ALI R. BERISHA**

Nuk janë raste të rralla në letërsi kur një poet i shpërfaqet opinionit lexues në moshën e dytë të tij. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në letërsinë tonë, si te rilindësit (Pashko Vasa, Filip Shiroka) ashtu edhe tek më të vonshmit. Në vitet e fundit kemi edhe një shembull të tillë; atë të Nexhi Baushit (poete nga Tirana), e cila në moshën e dytë të jetës depërtoi në fushën e poezisë me një përmbledhje vjershash që mban titullin Kur loton qielli..., të botuar në Tiranë muajt e fundit. Libri është përgatitur nën redaktimin e Kristaq Shabanit .

Të themi që në fillim se autorja është me profesion ekonomiste finance, prandaj çdo mirëpritje e librit të saj ka peshë të madhe, krijon befasi, dhe zgjon interesim në mesin e lexuesve dhe të miqve të saj. "Kur loton qielli..." veç faktit se është libri i parë, ai ka edhe anë të tjera që meritojne të sheshohen e të analizone letrarisht, që besojmë se do të janë të mirëpritura nga lexuesit. Nga titulli fitojmë përshtypjen se libri do të na sjell lëndë vlerash artistike me konotime klasiko-moderne dhe presim të lexojmë poezi shqetësimesh të thella poetike, por nuk del ashtu. Do të bindemi se ato janë poezi të kohës - interesimesh të shumta jo vetëm intime, por edhe mbarëkohore e shoqërore , morale, psikologjike, shpirtërore etj. kurse emërtimi i librit bashkëshoqëron përkushtimin domethënës me temat referenciale për të ndriçuar relatat e poetes me jeten, dhe e përballëvënë vendlindjes, qytetit ku ka arritur pjekurimin dhe botës intelektuale, kulturore e sidomos asaj letrare. Me sa duket ajo, që moti paska qenë e dhënë pas poezisë në radhë të parë si lexuese por edhe si krijuese e saj. E rritur dhe e shkolluar në një periudhë kur të marrurit me letërsi ka qenë dashte të behej me syçeltësi te madhe, prandaj, tash, vendosja për të shkruar e shfaqur lirshëm botën perceptore dhe ndjenjore ka bërë që poezitë e Nexhi Baushit të kenë seriozitet dhe begati krijuese dhe përmbajtësore. Entuziazmi i kësaj poeteje përcjellur hap pas hapi me përgjegjësi ndaj asaj që krijon është për t'u admiruar. Ajo fillon me një poezi 20 vargjshe kushtuar nënës dhe përfundon me një poemë që ka për subjekt, rrallëherë të shtjelluar në poezinë tonë – kushtuar pemës, dardhës shekullore të mbjellur nga katragjyshi dhe e cila në ditët e sotme ngërthen kujtime, nostalgji, mall për vendlindjen e te pareve. Poema kuptohet si një baladë me rrëfime për kohën e kaluar nga Dardha shekull. Me që dardha nuk ka gojë, rrëfimi i saj natyrizohet përmes gojës së stërmbesës . Kështu ndërmjet dy poezive me motive familjare stiset përmbledhja me 50 poezi me motive, tematika, forma e brendi të mbushulluara me mjaft frute të mirëpjekura që mund t'i japë një vepër poetike. Linja kryesore që i lidhëron poezitë është frymëzimi krijues dhe dëshira këmbëngulëse për të bërë jo vetëm një libër, por një vepër me sa më shumë vlera. Hetohet edhe frika e poetes se mos nuk ka për t'ia dalë me sukses, prandaj ka punuar e ripunuar ngadalë, kujdesshëm dhe këmbëngulshëm.

Pasi t'i ketë shkruar 8 poezi kushtuar prindërve dhe vendlindjes se te pareve – Steblevës pastaj edhe njpërkushtim të denjë, kushtuar Papës, radhiten poezite e tjera. S'ka politikë, s'ka luftë, s'ka dhunë, s'ka vuajtje, s'ka vdekje, ka atmosfere gjallërimi, natyrisht me gjithë telashet dhe problemet jetësore, por mbi të gjitha ka dashuri. Natyrisht, edhe kjo me telashet dhe peripetitë e saj, ndonëse edhe aty ka më shumë dëshpërime, se sa dashuri platonike. Poetja e ka të qartë se në




këtë botë, e cila siç thotë Kuteli "Është koprrace në mirësi." Këto janë shënjestrimet e lajtmotivit që e mban gjallë e gjethon dhe e degëzon vëllimin.

Me "Dashuria e parë" hapet sipari i motivit erotik. Aty ka shumë më pak klithma lirike sesa që bëjnë poetët e vlugeve dashurore, e shumë më tepër këndim erotik, filozofiko-natyror të ndjenjës më të fuqishme që paraqet kryefrymëzimin e jetës.

… zemra nga kraharori
kurrë s'më kishte dalë …
Kjo ishte, po e kuptoja,
dashuria e parë!... (fq. 25)

Zakonisht kur në veprat poetike theksohet zëshëm dashuria e parë, duhet pritur që ajo ka për t'u shuar, prandaj edhe te kjo poete

Harrova diçka diku
dhe pata mall.
Sërish të kthehesha,
a duhesh vallë? (fq.27)
dhe natyrisht duke pritur ditën që
Do të kthehem
ta rimarr përsëri. (fq. 27)

ikin "Stinët e jetës" dhe poetja e rezignuar mezi i gjen vargjet e pështatshme për këtë gjendje me poezinë Lermëni këtu!...

Lermëni, o njerëz,
Këtu vetëm …
Me gotën ndër duar, …
Për shpirtin e trazuar.
Ah! … Vitet e mia,
Të mirët e jetës sime, (fq. 29)

Kurse në poezinë në vijim "I pashpirt …" lexojmë dhembje-revoltën;

Mëkat!
A' do të arrij të të urrej, o i pashpirt!

Dhe në fund përmbyllja plot ekzalt, që lë pa frymë e pa shikim:

Mëkat!
S'arrij të të urrej, o i pashpirt!...

Pasi të kemi lexuar në vijim disa poezi, prapë për nënën dhe vendlindjen, poetja sërish i kthehet temës së dashurisë: "Dashuria ime u tret në harresë … fluturoi atje lart, në një botë pa ndjenja" (fq. 49). Dhe në vijim i lexojmë poezitë që pjekurisht vazhdojnë të përbëjnë pjesët e mira të vëllimit si: Në kërkim të së panjohurës, Trazim shpirti, Harmonia e ndjenjës, Oh, ka frikë…, Si pulëbardhë, Vajza dhe trëndafili, Sekretet e mia, Kostelacion i ri, Dialog i ndjenjës, Silueta, Vetmia e largimit, Pentagrami i ndjenjës, Jo si dikur…, Pirat i zemrave, E ndiej…, Vetëm imja …, në mesin e të cilave gjenden edhe dy poezitë më të fuqishme të kësaj vepre: "Sa pak kërkon një grua…" dhe "Në tavernën që dikur quhej "Vjosë".

"Sa pak kërkon një grua…" lë përshtypjen e një thurime poetike melodioze, psikologjike, pritësi gruaje me rrezatime të forta sentencioze. Thirrje gruaje drejtuar jetës dhe të dashuruarve:

Ti, mos u kur …se: …
Heret në pranverim tek ajo të shkosh,
Si gonxhe ta vjelësh … (fq.69)

Ndërsa poezia tjetër që e stigmatizuam, "Në tavernën që dikur quhej "Vjosë" na e shpërfaq një tabllo jete të poetës në dy periudha; të asaj rinore dhe të jetës së tanishme, me pikëzime tepër lirike. Në secilën strofë na faniten çaste e pamje me ngjyra të ndezura përshtypjelënëse. Poetja sikurse shokët e gjimnazit që dikur vizitonin "Vjosën" Përplaset nga dallgët. "Nocionin gjatë jetës e humbëm", dhe vazhdon:

Dëshiroj fati të më trokasë dhe një herë. – dhe i vë pikë, për të përfunduar tejet prekshëm në strofën në vijim:

Asgjë nuk dukej si më parë.
Atje në Tavernën që dikur quhej "Vjosë"
Në shisheen e verës shëmbëlltyrën pashë
Është ajo grua e vetme, vërtet unë? (fq. 81)

Do ndalemi edhe pak te kjo poezi, për të spikatur tri vargjet e strofës së dytë, të cilat duken si të pavend.

Secili nga ne jetoi jetën që na zgjodhën
Por luftuam e kurrë nuk u lodhëm
Dallgët e jetës kudo na përplasën…

E themi këtë, sepse ajo që del nga këto vargje nuk përputhen shumë me natyrën e poetës e as me porosinë e vëllimit. Andaj mund të jetë ky një lëshim apo humbje e hapit në të shprehur si tërësi për nga rrumbullakimi i mendimit, gjë që nuk haset gjetiu, madje është kundërthënës brenda strofës e më dukshëm kundërthënës me poezinë paraprake "Vetëm imja…", në të cilën poetja shprehet:

Do të jem vigjilente, do të gjej rrugëdalje …
Ndoshta vdekjen do ta mposht
Jeta ime, vetëm imja,
më shumë dritë do të ketë, e di, " (fq. 80)

Perceptim pamjesh e soditjesh, përfytyrimesh lexojmë edhe në poezitë e tjera që thurrin një imazh simpatik për librin në tërësi. Një realitet jetësor i poetizuar me shume kujdes e finesa me tone jo të tejzëshme që e rrumbullakojnë suksesshem mesazhin poetik se jeta duhet te duhet gjithsesi:

Jeta ime është vetëm imja,
Në qilarin e butësisë s'do të lejoj,
Goditjet të më përplasin… (Vetëm imja …, fq. 80)

Përveç poezisë kushtuar Papës personazhet e poezive si objekt këndimi i merr nga rrethi familjar dhe vendlindja e te pareve. Këtu e radhisim Dardhën shekullore si personifikim. Një poemë kjo rreth një subjekti mjaft interesant e thurur me kujdes. Përkundër dëshirës dhe mundit të bërë, poema ka mundur të dalë më e ndërtuar. Me sa duket, poetja ende s'e ka fituar guximin për t'u marrë me njeriun e përmasave të ndërlikuara jetësore. Është ky edhe një fakt se ajo ka një përgjegjësi të lartë për punën që bën dhe dronë nga shkarjet a lajthitjet e mundshme fillestare. Prandaj libri paraqet një sprovë letrare të një ndërtim të suksesshëm hapësinor e funksional me shtresime të shumta ideoemocionale të botës së brendshme dhe të asaj që e rrethon me ndërliqësitë e saja kohore. Këtu gjendet ama e nxehtësisë së ndjenjave buruese dhe e reflektimit të ngrohtësisë që pushton. Ajo mbi të gjitha e do jetën dhe dashurinë si metaforë të saj, ku ndarjet nuk duhet të kuptohen si "lamtumirë e fundit", ose në fund të fundit

"nëse këtu, nuk do të takohemi, /
Në një jetë tjetër do të të pres!" (fq. 78)

Duke lexuar poezi situatash e ndjenjash pushtuese me ngjyra e figura të forta shprehëse e vërejmë një jetë të veçantë brenda botës së madhe që qerthullon, nga e cila, poetja ka pritur më shumë se sa që ajo i ka dhënë. Atë, prandaj , më shumë e kuptojmë barabar si kundruese dhe si krijuese që është, vazhdimisht në kërkim të shkaktarit, me shumë shpresë, më shumë besim tek fati se sa stoicizëm (poezia Lermëni vetëm!...). Ajo ia del me sukses ta kundrojë gruan brenda botës, ku ajo e radhit edhe vetveten, si vetje që ka të pashterrshme botën e dashurisë, për njerëz, , për prindërit, , për fëmijët, madje madje edhe për mashkullin si burrë, si përballëvënës i vështirësive, si mik, si shok, si koleg.

Me të drejtë redaktori i librit shkruan: "Pa saforco dalin në pah të "dhëna", të cilat mund t'i zbulojë veç poezia".

Kurse Ilmi Dërvishi, në një vështrim të botuar në gazetën "Rruga e Arbërit" shkruan: "Poetja Nexhi Baushi vjen me një zë të saj në poezi, mjaft origjinale, me një krijimtari interesante e tematikë të gjerë… ka ditur që në unin e saj ta përgjithësojë në një un-poetik në një kohështrirje për shumë lexues të çdo moshe." Andaj nuk do të mund të quhej e tepërt nëse do ta nënvizonim mendimin se "kemi të bëjmë me një tufë poezish, autorja e të cilave ka filluar të shklasë sipas mënyrës vetanake të të shkruarit, pasi që posedon shkathtësi në përdorimin e sukseshëm të figurave stilistike, të struktures së vargut e sidomos të një gjuhe gjithanshmërisht të suksesshme.

**JEPET ME QIRA**
mjedis **300 m2,** pranë Kombinatit të Autotraktorëve.
E përshtatshme për çdo lloj aktiviteti.
Lartësia e katit 5 m. Mjedis edhe për zyra!
Linjë trefazore elektrike në dispozicion!
Rruga e shtruar me asfalt!
Të interesuarit të komunikojnë me tel:
**069 20 68 603**

Rruga e Arbërit nr. 82

# Një bajrak në Korab

**Nga: JAHE DELIA(SELMANI)**

**Poemë kushtuar Bajrakut të Radomirës e drejtuesit të saj Ibrahim Gjorgji)**

poemë

Sa ka shkrepë dielli n'Korab,
Frullizë bore zu të bjerë,
Tre kalorës vijnë me vrap,
Po na sjellin një haber.

Eh, ç'haber, haber i zi . . .
N'Radomirë mbrrini at'ditë,
Po vjen krali me ushtri,
Thrret Atdheu për shehitë.

Veç tri krisma ndihen n'qiell,
Lajm kanë çue në çdo anë,
-Sot më shpejt se asnjëherë,
Duhet t'shkojmë në Kolesjan!

Asht tubue Radomira,
Si e ka përherë zakon,
Sot vatani n'ditë t'vështira,
Me i dalë zot ne po na fton.

Në xhami ku falen burrat,
Një vendim ata kanë marrë,
-Sot me hasmin me i ndrrue ksulat,
Për vatan me faqe t'bardhë!

Me derhem peshohet fjala,
Sa fort peshë po ka n'kuvend,
Radomira me pesë mëhalla,
N'ballë ka sot një burrë me mend.

Flet Brahim Haxhi Zeqiri,
Po flet trimi Brahim Gjorgji,
Për vatan s'i tutet syri,
Radomira pas e ndoqi.

Kurrë s'gaboi kjo Radomira,
Përherë punët i shkuen mbarë,
Që t'i ndrisë zemra e ftyra
Zgjedh Brahimin Bajraktar.

I njeh trimat ky bajrak,
Përherë trimat pas i ndoqi,
Na ka ardhë sot hasmi n'prag,
- Na pri para brahim Gjorgji!

-Na pri para se, për besë,
Pa fitore nuk vijmë gjallë!
Sot vatani flakë asht ndezë,
Turrin hasmit me ia ndalë.

Një palë rroba bardhë si borë,
Ruejtë i kemi për ktë ditë,
Hije u ka martina n'dorë,
Qise e bardhë mbi krye u ndrit.

At' bajrak që valon era,
Në gjoks sot shtrëngon Brahimi,
Ia çon fisi,ia çon dera,
Radomirës në ballë i prini.

Nuk ka shenja, nuk ka grada,
Por ka zemrën si flamur,
Treqind pushkë i shkojnë prapa,
Me besë t'lidhur te ky burrë.

U tubuen trimat,
Atje te Meçaiti,
Mbushur plot Rudinat,
Mbushur plor dhe Kraiti.

Pleq,gra, fëmijë,
Dalin me i përcjellë,
At' çast nuk ra shi,
Zoti e bani diell.

I kalojnë Rudinat,
Me udhët tërthore,
Të gjithë urojnë trimat,
T'kthehen me fitore.

Të gjithë dorë për dore,
Me sytë në flamur,
-O vijmë me fitore,
O nuk kthehemi kurrë!

Për borxhin që i kemi,
Ne sot Atdheut,
Të bashkuar jemi
Si n'kohë t'Skënderbeut.

T'i bashkojmë krahët ,
Me vllaznit lumjanë,
Se atdheu s'ndahet,
Nji asht për të tanë.

T'veshur si dasmorë,
T'gjithë me kuaj të bardhë,
Korabi uron:
-U priftë fat i bardhë!

E kanë lidhur besën,
Sot për vatan,
-O fitojmë, o vdesim,
Sot në Kolesjan!

Kapëcejnë malet,
Kapëcejnë luginat,
Turri nuk u ndalet,
Me u bashkue me trimat.

Me trimat e mbledhur,
Atje n'Kolesjan,
T'gjithë një udhë kanë zgjedhur:
-T'vdesim për vatan!

Përmbi Kolesjan,
Po duket vargani,
Bukur veshur janë,
Si dasmorë nami.

Eh, sa shpejt kalojnë,
Lugje e rrëpira,
Nga larg i dallojnë:
-Po vjen Radomira!

Me atllarë të bardhë,
Shalat u bëjnë dritë,
Të gjithë me radhë,
Kalorësit kanë zbritë.

Kolesjani n'një shpat mali,
Sot gjithë Lumën e ka tubue,
Ushtri t'madhe ka nisë Krali,
Ktu fesatin me fillue.

Prapë janë mbledhë burrat e motit,
Marrin fjalën gjthë me rend,
Prapë me i dhanë sot zjarr barotit,
Si ato ditë në Prizren.

Ramadan Zaskoci flet,
Sa fort fjala po i ze vend,
Dhe pse n'moshë,ai prapë i ngjet,
Ramadanit në Priznen.

Në Prizren koburja e tij,
Nam të madh, besa, ka lanë,
Shkoi heberi në Turqi:
-Me Shqipni s'bahet pazar!

Burrë në moshë Islam Spahia,
Mend për vete e të tjerë,
Tha:"Ksaj here kjo Shqipnia ,
Ma n'rrezik asht se përherë!"

Ksaj herë hasmi me ushtri,
Ia ka msy mu në prag,
N'Kolesjan ku shpia e tij,
Qe konak e kryekonak.

Kullë e tij këtu n'malsi,
Ditë e natë trima ka pritë,
S'pyet për mall as për flori,
Emrin kurrë ai s'e ka shitë.

I jep za fushës e malit,
Gjithë Lumës e malsisë,
-Jo, për besë,ushtri e Kralit,
S'e tund kullën e Spahisë!

Ia ka ndie zanin malsia,
E alltinë e mban në dorë,
-Sot në provë asht Shqipnia,
Ndryshe, s' ka Flamur në Vlorë!

Në Lumë sot s'asht veç Nahia,
Flakë ta ndezim shkamb e gur,
Ktu sot shpresën ka Shqipnia,
Sot vendoset për Flamur.

Lumë e Dibër vllazën janë,
Përherë t'lidhur dorë për dore,
Kur asht puna për vatan,
I ke bashkë në një llogore.

Kemi ndie prej baballarëve,
Janë si rana me harasanin,
Po i thrret sot zani i t'parëve,
Me vdekë bashkë zunë Kolesjanin.

Ka me ndie shpejt Evropa,
Lumë e Dibër do t'lanë nam,
Elez Isufi vjen me topa,
Prej Mirdite n'Kolesjan.

Për ne Shkodër ai qe nisë,
Me luftue me Mal të Zi,
Asht kthye prapë për me bitisë,
Një ma t'madhe me Serbi.

-Më prit,vlla, se po vij,
Dhe me trima,dhe me topa,
Lumë e Dibër janë ba nji,
-Prit, se erdha, Baftjar Doda!

Sot po vij bashkë me Cenin
Me Mahmutin janë një gjak,
Mirë kuvendit ia di renin
Di me folë,di me marrë hak.

Ata topat e Cen Dacit,
Kanë me i ba malet të tunden.
Kanë me i shti dridhmën hasmit,
Nder për Dibrën e për Lumën.

Baftjar Doda me Reç e Dardhë,
Burrë me qibër e me mend,
Lshon mbi sy ksulën e bardhë,
Fort po i ngjit fjala n'kuvend.

I nderuem emri i ktij burri,
Elez Agës i çon t'fala:
T'pres në Lumë,Elez Isufi,
Prapë me nisë luftën me krala!

Plot po mbushet vendi,
S'po i nxe Kolesjani,
Burrat nga Cereni,
Burrat nga Ploshtani.

Sot me besa-besë,
Hasmin me e zhbi,
Zemrat na janë ndezë,
-Ta mbysim në Dri!

Vasie, Shullani,
Bashkë janë mbledhë,
I pret Kolesjani,
Hasmit me iu derdhë.

Plot u mbush Kalisi,
Në çdo kullë e prag,
Ia çon dera e fisi,
Luftën me nisë prapë.

Nga dy vorre doli,
Prapë zani i Mahmutit,
Bumllon Bumetrolli:
-Jepni zjarr barutit!

Bajraku i Bed Gjinit,
Si at'ditë në Nish,
Haber i çon trimit:
-Ia nisëm sërish!

Dy e tre për shpi,
Mblidhen në Bushtricë,
Zemra u vlon në gji,
Maten me Gjallicë.

-Sot asht ditë e madhe!
Ndihet nëpër maja,
Haber në Buzmadhe,
Haber merr dhe Çaja.

Si ortek dëbore,
Që merr vrull në shpat,
Nga udhët tërthore,
Bëhen njësh në Fshat.

Po vijnë turra-turra,
Nuk mbetet kush prapa,
-Jo, për besë,kaq burra,
Kurrë s'kaluan në Lapa!

Bashkohen në Lusën,
Si një trup u banë,
Malet plot u mbushën
-Na prit,Kolesjan!

Qiset bardhë si borë,
Lëshuar n'një anë,
T'gjithë n'një za thonë"
-T'vdesim për vatan!

Seç u mbush plot trima,
Sot çdo shkrep e hon,
Asht larg Radomira,
Prandaj vjen më vonë.

Në shtab Brahimi,
Ka shkue pak vonë,
Fjalët e ktij trimi,
Shtabi i dëgjon.

Debati u ndez,
Brahimit po i thonë:
-T'fillojmë në mëngjes,
Se sonte asht vonë.

-Nuk kam ardhë,-tha,
Me bujtë sonte n'Lumë,
Mendjen kemi nda,
Do ta filloj unë!

Brahimi nuk ulet,
Zani nalt dëgjohet:
-Hasmi mëson udhët,
E më shumë forcohet!

-Planin do ta ndërrojmë,
Sonte do t'i bihet,
S'ka gjë se asht vonë,
Se nesër. . . s'i dihet.

Tash më fort në shtab,
Debati u hyni,
Fjalët ngrihen nalt:
-Ka të drejtë Brahimi!

Ka dalë me martinë në dorë,
E bajrakun n'dorën tjetër,
-Burra, nesër do t'jetë vonë,
T'i biem sonte hasmit t'vjetër!

U rreshtuen treqind dasmorë,
Me kryet nalt e fort serbes,
-Para se me ra dëshmorë,
T'i shkojmë tokës me abdes.

Shpejt gatitet ky Bajrak,
Flet Brahimi dhe njëherë:
-Burra, janë dhe tre sahat,
T'i biem hasmit sa s'asht errë!

Një dekik mos me ia falë,
Se ai nesër merr fuqi,
Nuk do t'mundim me e ndalë,
Ka me e vu kufinin n'Dri.

T' mendojmë drejt e me mend,
Po s'i ramë ne hasmit sot,
Dhe shumë kohë do t'vuajë ky vend,
Dhe shumë gjak do t'derdhet kot.

Tre sahat pa u terrue,
Prapë n'kuvend burrat janë mbledhë,
-S'ka derman pa ia fillue,
Radomira e para asht hedhë.

Nuk ka pritë me u dhanë kushtrimi,
Veç tri krisma u ndien n'ajr,
-Të lumtë dora,Brahim trimi,
Dasma e madhe t'qoftë për hajr!

Kta dasmorë që sot kanë ardhë
Një fjalë bese e kanë dhanë:
Na bashkon sot faqja e bardhë,
-Mirë se t'gjejmë,o Kolesjan!

Kaq u desh e u ndezën malet,
Nga çdo gur del një petrit,
Jo, ky turr nuk mund të ndalet,
Faqja e Drinit me flakë u ndrit.

Po lë nam ushtri e popullit,
Asht hutue ushtri e Kralit,
Zemërshkamb burrat e motit,
Flakë i dhanë fushës e malit.

Po sjell Sheja sot shumë dallgë,
Mbushet Drini buzë për buzë,
Mend nuk mbahet si kjo natë,
Rrëbesh shiu si tërkuzë.

Veleshica atë punë ban,
Po i sjell Drinit dallgë e shkumë,
Haber bijve n'Kolesjan:
-Me ju sonte jam dhe unë!

Sot Korabi ai asnjëherë,
Po shkrin borën e ban shi,
Veleshicës ia përcjell,
Me i shtue dallgët Drinit t'Zi.

Ushtri e Kralit fort serbes,
Pat gatit stuhi e tmerr,
-Kam me zhbi Lumën n'mëngjes,
Ujin e kuq sipër t'ia nxjerr!

S'i ka ba hesapet mirë,
Luma mëngjesin s'e ka pritë,
-Faqebardhë,moj Radomirë,
E ke nisë luftën me dritë!

Kolesjani në një shpat,
Çdo shtëpi e ban llogore,
Me t'knue kangën e ke hak,
Emër t'mirë vedit i nxorre.

Kolesjani në një kodër,
Sot po bie erë baroti,
-Mirë se erdhe,Dibër-motër,
Me derdhë gjak bashkë si qëmoti!

Luftë më e madhe nuk ish pa,
Afsh po lshon dhe zemra e t'dheut,
Çdo kullë bahet sot kala,
U ngjall zulma e Skënderbeut.

Shiu plot i ka mbushë Drinat,
Me mnijë t'madhe janë mbushë zemrat,
Breshër plumbash nga martinat,
Fort po i shembën Kralit ëndrrat.

I ka mbledhë rrufetë Gjallica,
Retë e zeza lotojnë shi,
Po i thotë Kralit Kralica:
-Na la Luma pa ushtri!

Sa shumë Drini po ban vorre,
Sa fort pushka po derdh gjak,
Në mbarë Lumën deri n'Tërthore,
N'tym baroti u nxi çdo prag..

Te kjo Qafë e Kolesjanit,
Ku çdo gur asht lye me gjak,
-Besë, për hatër të vatanit!
Luma e Dibra merrin hak.

Rreptë luftojnë Luma me Dibër,
Me një besë të lidhur bashkë,
Sa e shenjtë kjo besë e lidhur,
Emër pat që n' kohë të lashtë.

T'ia ngremë lart vatanit nurin,
Me besë t'lidhur dorë për dorë,
Që Ismaili ta ngrejë Flamurin,
Pavarësinë ta shpallë në Vlorë.

-Qofsh bekue Ismail Qemali,
Që po i zbardh faqen Vatanit,
Roje ban sot fusha e mali,
Ktu te Qafa e Kolesjanit!

# kulturë

Ngrije flamurin,hej, t'lumtë dora!
Porsi trim e mos ki droje,
I ka hapë sot zemrat Vlora,
Ne n'llogore po bëjmë roje.

Valo i lirë, o Flamur,
Që po ngrihesh n'të bukurën Vlorë!
Se çdo fmijë e plak e burrë,
Po t'ruajnë me martinë në dorë.

Kuajt u bënë shkumë,
S'po ndihen rehat,
I ka lodhur shumë,
Kjo udha e gjatë.

Të merzitur rrinë,
Kryet lart e mbajnë,
Sot dhe tagjinë,
Nuk duan ta hanë.

Jelet i kanë ngritur,
Të gjithë përpjetë,
Qiellin duke pritur,
Të shkarkojë rrufetë.

Rrufetë e Korabit,
Rrufetë e Gjallicës,
Dridhet ftyrë e Kralit,
E zemra e Kralicës.

Deri sa t'u kthehen,
Kalorësit prapë,
Rehat s'do të ndiehen,
As ditë,as natë.

Do t'i marrin prapë,
Mbi shalat që ndrijnë,
Do t'i çojnë n'Korab,
S'bashku me lirinë.

Ati i Brahimit,
Tagjinë s'e ka ngrënë,
Po qan prej idhnimit,
Në natën me hënë.

Pret t'i vijë i zoti,
T'ia ledhatojë kryet,
Po rrjedh pika loti,
E po vështron yjet.. . . .

E sollën Brahimin,
E afrojnë te ati,
Duart që i dridhen,
Drejt shalës i zgjati. . . .

Me zor po i afrohet atit,
Ia lshon frenat nëpër kambë,
-Fluturo,at, në Grykë t'Korabit,
Thuaji dy fjalë të zezës nanë!

I thuaj nanës, n'Kolesjan.
Paska thanë zoti me vdekë,
Për vatan kisha me i dhanë,
Dhe t'i kisha njëqind jetë.

Sa fort vrahet sot Korabi,
Sjell haber në Radomirë,
N'Kolesjan ku asht fesati,
Ta ka zbardhë faqen ai bir.

Veleshica po shkul gurë,
Prej Korabi i çon në Dri
Bashkon gjamën për atë burrë,
Që çuditi një nahi.

Veleshica fort tërbohet,
Po sjell shi e po sjell lot,
Drinit t'Zi po i bashkohet,
Gjamë me i ba ktij trimi sot.

I thuaj nanës t'mos qajë për mue,
Se s'qe thanë me u kthye prapë,
Me gjak emrin e kam shkrue,
I kam gjurmët në Bajrak.

Atë Bajrak të papërlyem,
Që bën valë e s'tundet kurrë,
Sot me jetë e ka shpërblyer,
E ka gdhendur emrin n' gur.

Vrapo, at, e mos u ndal,
Jo me hap, por me trok,
Kalo fushë e kalo mal,
Ndale vrapin n'atë Stërdok.

Kur të shohë ty nana vetëm,
Ka me i derdhë dy pika lot,
Për Vatan sot e dhashë jetën,
Radomira prapë asht plot.

Përshko, at,gjithë Radomirën,
Kalo malet veç me vrap,
Prapë ia kemi ndritë fytyrën,
Siç e ka Vatani hak.

Pusho pak, ti, te xhamia,
Në Meçait, aty në Tejs,
Thuaju"Nuk m'u dhims rinia,
Se Vatanit i dhashë besë".

Pastaj në Derbaç pusho,
Ndalu te çdo gur e prag,
Më vonë vrapin e drejto,
Për Çernjevë e pusho pak.

Një ujë t'ftohtë pi te Kroj Tej,
Dhe merr udhën për në Rade,
Thuaj:"Brahimi s'e kursei,
Jetën për Dasmën e Madhe".

Mbaje jelen veç përpjetë,
Turfullo për t'fundit herë,
Si Korabi kur mbledh retë,
Veleshica në pranverë.

Ka dalë dielli n'Radomirë,
Rrezja e parë ndrit në Korab,
Sot mungon atje një bir,
Ai që prini një bajrak.

Prapë në ballë po prin Bajraku,
Me varrë plumbi e nxi prej tymi,
Për mort sot u hap konaku,
-Hallal gjini,Brahim trimi!

Asht Bajrak me vrima plumbi,
Bojatisë me tym baroti,
Zani e nderi kurrë s'i humbi,
Si tani e si qëmoti.

Po vijnë shokët nji nga nji,
Gajret japin për Brahimin,
Radomira sot ka zi,
N'Kolesjan e ka lanë trimin.

Te ai vorr ku je palue,
Po vjen nana me të pa,
Lotë për faqesh i shkojnë krue,
Erë e Drinit don me i tha.

-Kto murana që shoh sot,
Për një ditë në dhe kanë ra,
Prandaj nana s'po derdh lot,
Zemrën, nana, ktu po e la.

-Ju djem nanash që po flini,
Te ky djep me dhe e gurë,
Hallall mundi, hallall gjini,
Kurorë thurët në flamur.

Ky Bajrak në Korab,
Kurrnjëherë besën s'e theu,
Jetën s'e ka vu n'hesap
Kur thrret nderi e Atdheu.

Ka pasë emër, ka pasë za,
Dhe n'Stamboll ku ish Sulltani,
Por asht djegë me mall e gja,
Sa herë e ka thirrë Vatani.

Kta bij nanash kurrë s'janë tutë,
Përherë pushkë kanë ba me vend,
N'ballë kanë pasë burra të urtë,
N'ballë kanë pasë burra me mend.

Ia kanë ditë burrnisë rendin
Hije pushka, hije fjala,
S'e ke prishur kurrë kuvendin,
Radomirë me pesë mëhalla.

*Maj-qershor 2012*



# Elsa Martini sjell dy seri pikturash nga rezidenca e artit në Haiti

Vajza me fustanin me pika lejla pak sipër gjurit, me shapkat me lule lejla e me sytë që shprehin aq shumë nuk i ka mbushur 15 vjeç. Barku i saj i rrumbullakosur tregon qartë se ajo është shtatzëne. Historia e saj është një histori e zakonshme në Haiti, ku vajza që ende nuk kanë kaluar adoleshencën bëhen nëna. Kur Elsa Martini, artiste nga Shqipëria që prej pesë vitesh jeton në Austri, mori ftesën për të qenë pjesë e një rezidence arti në Haiti, gjëja e parë që i shkoi në mendje, ishte ajo se çfarë do të ndjente. "Nga ajo çfarë kisha lexuar apo parë për Haitin, e dija që situata atje do më bënte të prekesha", thotë ajo. Por udhëtimet fshehin gjithnjë diçka tjetër nga ajo që mund të kemi menduar dhe Haiti shpaloste para një artisti, pamje të rralla të natyrës. Deti i Karaibeve... teksa dielli shkëlqente në lëkurën e zezë të haitianeve që zhyteshin në të dhe shtëpitë koloniale që të kujtonin librat e Markezit. "Natyra e Haitit ishte e mrekullueshme, një vend i bukur me gjelbërim të përhershëm... lulet dhe bimët dekorative që ne i blejmë i kishe në peizazh, thotë ajo. Por kjo gjendje e natyrës ishte në kundërshti me atë çfarë ndodhte realisht në jetën haitiane. "Varfëria e madhe ndihej kudo dhe një përqindje e popullatës jetonte në rrugë. Nuk e gjeja dot përgjigjen e kësaj gjendjeje kur shihja atë bukuri dhe varfëri bashkë...".

Martini u bë pjesë e një rezidence arti mes artistëve nga e gjithë bota, të cilët për tri javë do t'i kushtonin punët e tyre këtij vendi. Por, në vend të pamjeve aq të bukura të natyrës në telajo, ajo hodhi një tjetër subjekt. "Para udhëtimit tim në Haiti, gjatë kërkimeve që kisha bërë për këtë vend, u ndesha me fenomenin e abuzimit dhe skllavërisë së fëmijëve", thotë Elsa. Nëse skllevërit mendojmë se kanë ngelur në librat e historisë me skllavopronarë, në Haiti ky ishte një fenomen që ende nuk ka përfunduar. "Gjatë punës sime u ndesha me një fakt shumë të trishtë, fenomenin e skllavërisë së fëmijëve. Është fjala për fëmijët e quajtur 'Resteavec', që vjen nga frëngjishtja, "Reste avec moi" (rri me mua). Për fëmijët që kanë ngelur pa prindër ose që vijnë nga familje shumë të varfra që prindërit i lënë tek familje të tjera për të shërbyer për të siguruar strehë, ushqim, apo një të ardhme më të mirë, megjithëse në pjesën më të madhe të rasteve ata trajtohen si skllevër", tregon Martini.

Takimet me këta fëmijë, orët e gjata me biseda rreth jetës dhe dëshirave të tyre do ta frymëzonin Elsën të krijonte dy seri me piktura mbi këtë temë. Seria e parë u krijua nga subjekte direkt nga jeta e përditshme e këtyre fëmijëve në Haiti, serinë tjetër e krijoi në Vjenë, për t'u prezantuar sërish në Haiti gjatë rezidencës. Në serinë e dytë, figura e fëmijëve haitianë vendosen në peizazhet idilike të Austrisë, për të krijuar situata mospërputhjeje, sigurie që të jep peizazhi dhe pasigurie që të japin figurat e fëmijëve.

Punët e realizuara nga artistja u prezantuan në Institutin Brazilian në Petion Ville, Haiti. Udhëtimin në Haiti, Elsa e quan një përvojë të rrallë për një artist që vjen nga Ballkani, Shqipëria, pasi përballesh me një realitet krejt të panjohur.

Përveç pikturave, ajo ka realizuar dhe disa seri fotografish nga udhëtimet në zona të ndryshme.

Sipas Elsës, edhe arti që bëhet në Haiti është krejt ndryshe. "Arti haitian ka një traditë komplekse, pasi reflekton influenca të artit afrikan, katolicizëm frëng dhe traditën Vodou", thotë ajo. Për Elsën udhëtimi vijon të mbetet i rëndësishëm, pasi përmes tij mund të njohë kultura të reja, siç ishte dhe kultura haitiane. Ndër rezidencat artistike ku ajo ka marrë pjesë dhe që i veçon për të papriturat me të cilat është përballur, janë Kapadokia në vitin 2011, Rumania në 2006-n dhe Maroku në 2007-n.

Elsa Martini e la Shqipërinë pesë vjet më parë dhe zgjodhi që artin ta zhvillonte në një hapësirë tjetër larg vendit të lindjes. Ajo është vendosur për të jetuar në Vjenë dhe jeton aty bashkë me bashkëshortin artist, Erwin Maria Hafner dhe dy fëmijët. Por arti është hapësira ku Martini orvatet gjatë ditës së saj. Bashkë me të shoqin, drejtojnë atelienë e artit "Ruhdorf", ku bëjnë projekte mbi rezidenca arti në Austri. Kjo atelie është menaxhuar nga Hafner që prej vitit 2003.

Ashtu si piktura që ka sot një kthim në abstraksion, edhe punët e saj e reflektojnë këtë kthim. Nëse për shumë artistë rezidencat janë forma ku është e vështirë të shprehesh, për Martinin ato janë frytdhënëse. Asaj i pëlqejnë udhëtimet dhe njohja me kultura të reja që të ofrojnë këto rezidenca.

Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Arteve më 1996, ajo ka përfunduar dhe një master në menaxhim arti në Vjenë në vitin 2012. Martini është pjesëmarrëse në aktivitete kombëtare si "Onufri", "Ardhje", apo në ekspozita të ndryshme. Është fituese në disa rezidenca arti, në 2005 fitoi çmimin special në ekspozitën "Onufri". Para se të udhëtonte drejt Vjenës, ajo ka punuar si studiuese dhe kuratore në Galerinë Kombëtare të Arteve. Në vitin 2009, ajo ideoi "Art-ist", me rezidencë në Vjenë dhe ka organizuar e kuruar disa projekte ndërkombëtare si: "Soft identities 2011", "ERROR in Garden" 2010, "Autonomous stream 2009". Vjet ajo prezantoi për herë të parë një rezidencë artistike në Shqipëri të quajtur "Terrain Insecure", që u zhvillua në qytetin e Përmetit. Në rezidencën e zhvilluar prej saj në Vjenë "Art-ist" kanë marrë pjesë dhe artistët shqiptarë si Suela Qoshja, Matlinda Mehmetaj, Heldi Pema, Lumturi Blloshmi, Albana Kozeli.

***Marrë nga gazeta "Shqip",***
***5 Shkurt 2013***

# Një pushkë ka lindur në Doçaj

*Nga* **RESUL BENDO**

Eprita me dëshirë kërkesën që të flisja në këtë tubim, në promovimin e librit "Gjokë Doçi", "Kaçaku" e shkrimtarit Lutfi Hanku.

Ju kërkoj ndjesë, nëse nuk do mundem të them të gjitha ato që duhen të thuhen për librin "Gjokë Doçi".

Monografia e Heroit të Popullit Gjok Doçi "Kaçaku" e shkrimtarit Lutfi Hanku është një dhuratë që prozatori Lutfi Hanku është një dhuratë që prozatori Lutfi Hanku I dha lexuesit.

Lutfi Hanku është lëvrues I hershëm I monografive. Ai, me një punë të gjatë hulumtuese, ndriçon gjurmët e heroit.

Librin e lexova me kenaqësi të veçantë dhe shepsh u shpreha: "Bukur! Sa bukur! Të lumtë Lutfi Hanku! Mirënjohje nga lexuesi, mirënjohje nga lurasit, mirënjohje për punën që ke bërë!"

Në emër të shoqatës për të rënët e kombit përshëndes autorin e librit, ju përshëndes juve, lurasve, që jeni mbledhur sot këtu për t'i bërë nder birit e heroit tuaj Gjokë Doçit të pavdekshëm, në veçanti të përgëzoj edhe mikun tim, sponsorizuesin Mustafa Doçi, vëllain e heroit që sponsorizoi librin.

Më është dukur se kam ditur gjithçka për lurasin heroi. Paskësha qenë i gabuar. Nuk kisha mundur ta shihja atë të plotë, me bukurinë e shtatin azgan të lurasit, me dëlirësinë e shpirtit dhe krenarinë e lurasit. Këtë ma mundësoi ky libër. Këtë besoj se do ta shprehë lexuesi marrë në dorë librin.

Libra si ky sot i nevojiten popullit tonë, kombit tonë, në veçanti, në ditët që përjetojmë.

Autori e jep Gjokën në rrjedhën e jetës, pa zbukurime, kur krismat njoftojnë se "Një pushkë ka lindur në Doçajt" dhe ecën në gjurmët e tij gjithë jetën, deri komandant Gjokë Doçi bie në ballë të luftës, në Mallakastër.

Libri është shkruar me një stil të rrjedhshëm, me gjuhë të pasur dhe i mbushur me ngjarje, i plotësuar me fotografi, këngë et.

Nga shtatë pjesët e librit po ndalem në pjesën e parë, në vendlindjen e heroit, në Lurë.

Në këtë libër ndriçohen gjurmë nga historia e Lurës gjer në thellësitë më të hershme të kohës, kur "Lura ishte mbret". Sa gjetje e bukur! Lura mbret! Jepet informacion për 35 fiset e mëdhenj e të vegjël të lurës, për 12 fiset e Doçajve, për Lurën që digjet e zhuritet, por nuk jepet. Nuk nënshtrohet. Me një prozë poetike shkrimtari përshkon shpirtin e lurasit të nujuar në këto male të larta e të bukura.

Lura ka shumë male, por malet më të larta të Lurës janë njerëzit e saj, që janë aty në shekuj, me rrënjë të lëshuara thellë, në palcë të tokës, dhe u kanë qëndruar furtunave të kohës duke u përcjellë pushtuesve lajme: "N'ato bjeshkë trimat lurjanë/ Lindin fëmijët e bëjnë armë".

Kur lexojmë e mësojmë historinë e Lurës, themi se pa lindur djem e pa bërë armë, s'do të kishte Lurë!

Në libër natyra e Lurës jepet bukur, me krahasime të goditura: "Shtatë liqejtë me qerpikë të gjelbër", kurora e Lurës krahasohet me një nuse, me një nuse me shtatë filxhanë, që i jep zotit çdo mëngjes kafe", e plot krahasime të tjera të gjetura e të përdorura bukur nga autori.

Por më bukur autori përshkruan historinë e njerëzve të Lurës. Kjo e dhënë përmes ngarjeve dhe personave konkretë.

Me jnë bukuri e vlerë të veçantë jepet Duvaku i nuseve me mustaqe. Ardhja e Selim Pashës s'e ndal turrin e luftës. Ai kërkon 300 cuca t'ia përcjellë sulltanit. Lurasit bien ngushtë.

Këtë telash e zgjidh bukur mençuria e Gjegjas, bariut të Lurës, kur thotë t'i japim pashës "nuse me mustaqe". Dhe bëhen 300 duvakë. Nën duvakë nuse me mustaqe me kama e pisqolla e jataganë për mezi. Dhe bukur zgjidhet ky konflikt. Përmes këngëve:

*Pritna mirë, mor Selim Pasha,*
*M'i do nuse, a m'i do vasha,*
*Me të holla, a me të trasha?*

Kur "nuset" zbulojnë duvakun, nis përleshja e madhe. Pashës "i mbetet ushtria në zabele / si me rënë ujku në dele".

Dhe konflikti zgjidhet. E ngjarja mbetet me vargun e këngës:

*I desh cuca lule bjeshke,*
*I dhamë nuse me mustaqe.*

Xhemilja, nuse panënshtruar, që pranon të vdesë, por jo të tradhtojë kaçakët.

Dila, nëna e Gjokës, e bukur e shpirtmirë. Bariu i Lurës Gjegja. Dhe një varg të tjerë trima e trimëresha, autori zbulon vlerat morale të malësisë dibrane.

Gjoka i vogël në vitet e foshnjërisë kur endet lëndinave të Lurës. Gjoka në kishë e në strehën vorfënore, kur lurasi i vogël, Gjokë Doçi, që zbret nga malet e lira në një botë me rregulla strikte, botë të ngushtë, të murrme, pa gjallëri. Njerëzit më të dashur të Gjokës janë librat. Të afërmit e nxisin të mësojë që të bëhet si Bibë Doçi e Kaçorri i mençëm i Lurës e gjithë Shqipërisë.

Më 1936 Gjoka e mbaron shkollën dhe del nga porta si një zog që del nga kuvlia dhe shpirti i qesh e merr frymë ilirë.

Në pjesën e tretë flitet për Gjokën nxënës në shkollën industriale "teknike", shkollë që do të shërbente shumë në përballimin e jetës dhe në veprimet ilegale të njësiteve guerile.

Në këtë kohë në Shkodër frynte era e mendimeve të lira. Gjokën student e rrëmben epika heroike. Zhytet në mendimet përparimtare të Migjenit, lexon me zell Fishtën. Ndjehet i kënaqur mes shokësh, rritet i gjallë e muskulor. Merret me sport. E rrëmben jeta, por u thotë shokëve: "A e dini kush më kënaq mua? Aroma e Lurës në mëngjes është mrekullia e zotit. A, sa larg e kam Lurën e sa afër më rri ajo, veçse nuk e prek me dorë".

Në vitin 1940, i detyruar nga ndjekjet e pushtuesve, Gjoka shkon në Elbasan. Punon në kushte të vështira pune. Merr pjesë në veprimtarinë ilegale.

Lutfi Hanku ka meritën që i ka hulumtuar një nga një këto veprimtari të heroit dhe ka mundur t'i pasqyrojë bukur në faqet e librit.

Edhe pse i rreshtuar ushtar i lirisë, Gjoka do të gjendet në Lurë. Ishte korrik i vitit 1942.

E kishte marrë malli për Lurën dhe erdhi. Shprehet autori: "Kur duart e Lurës e kapnin, Kaçaku bëhej erë mali, por kësaj here ndjen dhimbje se nënë Dila nuk doli t'i apë derën. Ajo kishte tre muaj që kishte vdekur. Derën ia hapi me të qara vëllai i vogël, Mustafai.

Në fund të vitit 1942 Gjoka del partizan në çetën e Dumresë.

Në çetë Gjoka gjen shokë e luftëtarë, veçohet për trimëri, shquhet në veprimet luftarake.

Në fillim të gushtit 1943, në krye të 70 partizanëve shkojnë në Vithkuq të Korçës, ku formojnë brigadën I "Sulmuese".

Në Brigadë Gjokë Doçi bëhet me fletë. Në fillim emërohet nënkomandant e pastaj komandant batalioni.

21 vjeçari Gjokë Doçi udhëheq batalionin me sukses nëpër llogore lufte.

Në luftimin e fundit Gjoka thërret: "I gjithë batalioni i katërt vullnetar në sulm!" Do të zgjidhen 80 vetë. Gjithë Brigada çohet në kambë / Kë me zgjedhë e kë me lanë?

Dhe:

*Tetëdhjetë drera, 80 trima*
*Shkrepin si vetëtima*

**Gjokë Doçi i librit të Lutfi Hankut nuk është ballëshuar, po ballëndritur.**
**Atij i pati lezet arma në duar, dhe vargjet e këngës:**
**M'i thuaj Lurës asaj ane:**
**Qaj mashinkën italiane!**
**Si m'u prish në dorë e ngrata?**
**Qaj që s'pata dy granata...**

*I thonë armikut pritna!*

Në këtë luftë ra heroi dhe derdhi lot për të Lura e Mallakastra trime që u thërret me këngë nuseve e vajzave të saj:

*Të marrin ujë nga gurra,*
*Të pijë djali nga Lura!*

Në kapitullin e shtatë dhe të fundit shkrimtari Lutfi Hanku me një prozë poetike plot emocione për të afërmit me një prozë poetike plot emocione për të afërmit e Gjokës, vëllain Mustafa dhe gjithë lurasit, përshkruan ardhjen e Gjokë Doçit në Lurë i derdhur në bronz. Duket sikur Gjoka i derdhur në bronz buzëqesh mes diellit të ngrohtë, erës së sertë e borës së ngrirë.

Flladi i maleve përkëdhel ballin e heroit dhe lurasit thonë: "Jetofsh në fëmijët tanë!"

Urim më i bukur se ky s'mund të bëhet për një hero.

E përgëzojmë autorin që ndriçoi gjurmë të Gjokë Doçit, që gjithë jetën, kudo që eci e jetoi, mbeti me kokën prapa, te Lura e bukur, te njerëzit e saj të mrekullueshëm.

Gjokë Doçi i librit të Lutfi Hankut nuk është ballëshuar, po ballëndritur.

Atij i pati lezet arma në duar, dhe vargjet e këngës:


*M'i thuaj Lurës asaj ane:*
*Qaj mashinkën italiane!*
*Si m'u prish në dorë e ngrata?*
*Qaj që s'pata dy granata... 1). (Gazeta "Për Mëmëdhenë")*

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!

rrugaearberit@gmail.com

**Botim i ri**




**Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.**

portret

# Beshir Sufa, figurë e shquar në historinë dibrane

*Nga* **NAIM PLAKU**

**Mbrëmjeve dhe në kohë pushimi Beshiri ishte gjithmonë i rrethuar nga miqtë e shokët e shumtë që kishte. Ëndërronte që të kthehej një ditë në Sllovë, aty, tek shtëpia dhe pronat e tij, aty ku kishte lënë rininë e tij dhe një pjesë të madhe të zemrës së plagosur, të shikonte për të fundit herë vendet nga kishte shëtitur e kishte luftuar, të dëgjonte këngën e fundit të atij bilbilit të dikurshëm që vinte nën pullazin e shtëpisë së tij, dhe, mes luleve të qershisë, sa zbardhte agimi, ia niste asaj melodie që vetëm ai di të këndojë. Mjerisht, ëndrra e tij u pre një ditë vere pa perenduar ylli i komunizmit dhe pa lindur akoma drita e demokracisë dhe ndrroj jetë i përvëluar e i djegur nga malli për vendlindjen e tij.**



*Beshir Sufa*

Beshir Sufa (Ndreu) ishte djali i madh i patriotit të shquar, trimit legjendar të Dibrës, Sufë Xhelilit, heroit të luftërave të popullit tonë për liri e pavarësi. I përkiste fisit të Ndreve, njërës prej familjeve më të mëdha e më të nderuara të vendit , por, njëkohësisht, nga më të nëpërkëmburat, më të përgjakurat e më të përsekutuarat nga regjimi komunist. Ishte një degë e atij trugu të lisit vigan që buloj e u rrit krenar e madhështor, aty, anës së djathtë të luginës së Drinit të Zi, në lëndinat e gjelbëruara të Lisivalles, aty ku lumi merr vrapin për të hyrë në Lumë. Ishte një degë e shëndetshme e atij lisi shpatullgjërë nën hijen e të cilit nënat malësore mëkuan e përkundën djepet e trimave Xhelil e Elez Isufi, Isuf e Dik Xhelili, Beshir e Dali Sufa, Cen, Mersim e Medi Elezin, Xhetan e Esat Elezin (Ndreun), 16 djemtë e Cen Elezit, shqiponjat e maleve tona që u përvëluan nën kthetrat e komunizmit, të gjithë luftëtarë të nderuar, shkrimtarë e artistë të talentuar, pinjollë të shquar të kësaj dere të madhe e të ndritur që historia i mban në gjirin e saj duke e bërë të pavdekshëme.

Kur vdes ndonjë burrë me emër në Dibër e shkojnë për ngushëllim, ata që nuk e njohin mirë familjen, pyesin:

-More, a ka lënë konak e derë? A ka lënë ndonjë djalë?

Kjo është një pyetje që kërkon një përgjigje të mençur e të vlerësuar drejt.

Kështu pyetnin larg e larg atë ditë dhjetori ku mbeti i vrarë Sufë Xhelili dhe u plagos për vdekje tradhtisht Elez Isufi nga forcat e reaksionit. Dhe dashamirët gëzoheshin e u vinte mirë, kur i jepnin dorën e përshëndosheshin në derën e kullës me një djalë të bëshëm e fisnik, qimekuq, me ata sy të kaltër që depërtonin deri në thellësitë e shpirtit njerëzor, tamam si i ati, që sapo ishte mbuluar me dheun e tokës-nënë, pranë atij burri të cilit kishte qëndruar qysh 15 vjeç kur u bë djal për pushkë, kishte marrë pjesë në dhjetëra beteja, kishte vrarë me dorën e tij sërbët pushtues të vatanit, kishte lëshuar, si i ati, atë piskamën tronditëse e fryzmëzuese "a besë-a besë", që ngrinte në këmbë malet dhe mbushte burimet me gjakujn e pastër të lirisë. Në betejën vendimtare të Lanë-Lurës në tetor të vitit 1921, në rrethana tepër të vështira e delikate për kombin, Beshiri qëndroi natë e ditë në krahë të babait të tij të nderuar duke luftuar me guxim të pashoq dhe në kushte tepër të vështira e duke u rënë kryq e tërthor maleve të Runjës për t'u siguruar nga ndonjë ndërhyrje e mundshme e forcave tradhtare.

Dhe djali i ri krenohej e madhohej kur burrnia më e zgjedhur dibrane e ngushëllonte:

-Mos u mërzit, o Beshir Sufa! Të na rrojsh me gjithë vllazni! Të pastë Dibra!

Beshir Sufa nuk i la gjë mangut të atit për nga karakteri, trimëria e bujaria. Figura e tij po vinte gjithmonë duke u rritur në situata të tjera e kohë të reja. Qysh në vitet '30, kur vëllai i tij më i vogël, Dali Ndreu, u përfshi në qëndresën antizogiste dhe më vonë në lëvizjen Çlirimtare pas pushtimit fashist të vendit, ai u bë një ndër veprimtarët më të shquar të kësaj lëvizjeje mbarëpopullore. Shtëpia e tij në Sllovë u bë qendra e mobilizimit të forcave ngadhnjimtare kundër fashizmit italian dhe, më vonë, atij të pushtimit nazist gjerman, djepi i lëvizjes Çlirimtare për tërë krahinën. Me autoritetin dhe vlerat njerëzore që trashëgonte, me besimin që kishin dibranët te fjala e tij e, sidomos, për besën shqiptare që nuk e tradhtoi kurrë, ai gëzonte një respekt dhe përkrahje të gjithanshme duke grumbulluar rreth kësaj lëvizjeje djemtë më të mirë e më të vendosur. Beshiri që në fillim të Lëvizjes vihet në krye të forcave vullnetare çlirimtare për tërë krahinën. Aq trim sa ishte, po aq i dashur dhe i dhimbshëm ishte për tërë banorët cep më cep Dibrës. Janë të panumërt ata që sot e asaj dite i mbajnë mend shumë mirë bamirësitë e tij për t'i shpëtuar nga vala e egër e komunizmit, që shpesh herë shpërthente duke rrëmbyer në vorbullat e saj djem të pafajshëm, vetëm për të ngopur ujqërit e kuq me gjak të kulluar shqiptari. Sa e sa shtëpi nuk i dogji kjo flakë përvëluese, vetëm sepse kishte hyrë në mes Beshir Sufa, që i thoshin ndryshe dhe "besa e dibranit musteqekuq". Forcat vullnetare të komanduara prej tij me një disiplinë e ndërgjegje të lartë ndihmuan në zgjidhjen e shumë problemeve që kishte populli në ata vite të sapodala nga lufta, sidomos në shpërndarjen e furnizimeve që vinin nga Front i Lindjes, në emërgjencat civile dhe në ndihmat që u shpërndaheshin familjeve në nevojë. Beshiri ishte njeri i veprimit. Fjalët e tij ishin të pakta, por zinin vend si guri i rëndë në themelet e kullave. Ishte njeri i punës, sepse veten e tij s'e quajti kurrë komandant, por një shërbyes për ta ndihmuar këdo e kurdo. Kështu e ka njohur Dibra Beshir Sufën dhe i tillë mbeti tërë jetën.

Ashtu si shumë shërbime të tjera, ashtu si shumë patriotë të nderuar dhe me vlera të mëdha njerëzore u harruan shpejt, u mohuan dhe u përbuzën nga një hakmarrje çmendurie për të joshur tekat e elitës që po vinte në pushtet pas gjithë atij gjaku të derdhur. Ndoshta, familja Ndreu është ndër më të goditurat e më të përgjakurat nga diktatura komuniste në tërë Shqipërinë, për të cilën mendoj që është me vlerë për kohën që ajo të njihet më gjërë dhe për atë të shkruhet më gjatë. Kështu e pësoi dhe trungu i familjes së Sufë Xhelilit. Në vitin 1947, fill pas mbarimit të Luftës, për të kënaqur oreksin e Beogradit burgoset Beshir Sufa, ish-komandant i forcave vullnetare në Dibër, djali i trimit Sufë Xhelili, që kishte luftuar një dekadë të tërë me shovinistët sërb së bashku me djemtë e tij. Lirohet për pak kohë dhe në vitin 1956 ndodh gjëma e madhe për tërë familjen e tij dhe për tërë familjen e madhe të Ndreut në përgjithësi. Vëllai i tij Dali Ndreu, një ndër gjeneralët e parë shqiptarë dhe udhëheqësi kryesor i LuftësÇlirimtare, arrestohet me të shoqen e tij një ditë vere tek po pushonin të shkujdesur në baçet e Beshirit në Sllovë i rrethuar nga disa vizitorë të farefisit të tij. Arrestimi i tij u bë me bujë të madhe dhe nuk kaluan veç pak ditë dhe vala e dëbim-internimit mori me vete familje të tëra nga fisi Ndreu. Familja e Beshirit dhe e vëllezërve të tij, si edhe ajo e Xhetan Ndreut e të tjera u internuan në Shtyllas të Fierit ku do të qëndronin deri në vitin '90 duke punuar si argatë në arat e krypura e moçalishtet plot mushkonja të kënetave të Myzeqesë. Këtu e kaloi gjysmën e jetës së tij edhe Beshir Sufa deri sa vdiq larg vatrës së tij të dashur e të nderuar në vitin 1989, në moshën 94-vjeçare ky burrë trim dhe i mençur, luftëtar i provuar në zjarret e luftrave për liri, një plak i hijshëm e fisnik, me një çehre që të impononte përherë respekt e dashuri, shtatdrejtë si lisi i kreshtës, me një humor të këndshëm.

Ai që e kishte kaluar jetën në luftë, me pushkë krahut e kollanin e fishekëve brezit, aty, në lëmishtet e Shtyllasit e shihje çdo ditë në mëngjes me shatë e drapër në dorë, në mes të arave duke derdhur djersën e ballit, pa iu ankuar askujt, gjithmonë i freskët dhe tërë shpresë e optimizëm për jetën, gjithmonë i qeshur dhe i dashur me këdo.

Mbrëmjeve dhe në kohë pushimi Beshiri ishte gjithmonë i rrethuar nga miqtë e shokët e shumtë që kishte. Qazim Bllaca, Astrit Delvina, Osman Kazazi, Drita Kosturi, Xhafer Vokshi, Sami Hysi, Faik Selenica e plot të tjerë ishin miqtë e tij të shumtë që e rrethonin përherë me dashuri e përkujdesje dhe e çmonin për vlerat që kishte. Ëndërronte që të kthehej një ditë në Sllovë, aty, tek shtëpia dhe pronat e tij, aty ku kishte lënë rininë e tij dhe një pjesë të madhe të zemrës së plagosur, të shikonte për të fundit herë vendet nga kishte shëtitur e kishte luftuar, të dëgjonte këngën e fundit të atij bilbilit të dikurshëm që vinte nën pullazin e shtëpisë së tij, dhe, mes luleve të qershisë, sa zbardhte agimi, ia niste asaj melodie që vetëm ai di të këndojë. Mjerisht, ëndrra e tij u pre një ditë vere pa perenduar ylli i komunizmit dhe pa lindur akoma drita e demokracisë dhe ndrroj jetë i përvëluar e i djegur nga malli për vendlindjen e tij. Qëndrimi i tij në internim është një kapitull tjetër interesant i jetës së këtij burri, që flet e na mëson për qëndresën madhore të njeriut përballë vështirësive njerëzore, është një faqe e ndritur e jetës së tij që e lartëson Beshir Sufë Xhelilin, po aq sa rinia e tij përkrah një babai me emër e zë, e ngre në pjedestalin e trimave që edhe dinë të luftojnë, edhe dinë të qëndrojnë me nder në rrethana të jashtëzakonshme, edhe dinë të vdesin me qerpik të papërlotur kurrë.

Rruga e Arbërit nr. 82
kujtesë



*Në foto:* (Lart) **Maliq Kacani mes nxënësve të tij**. *Foto poshtë:* **Mes kolegëve** *(Marrë nga arkivi familjes)*

# Memorial për Maliq Kacanin

*Nga* **XHAFER MARTINI**

**Maliqi ishte në moshën e pjekurisë së plotë, kishte shumë plane dhe projekte, por që mbetën pa u zbatuar. Një prej këtyre projekteve, ishte historikut i fshatit dhe i zonës së Çidhnës, bashkë me mbledhjen e kulturës shpirtërore të kësaj treve, që Maliqi, me siguri, do të kryente shumë mirë, mbasi i plotësonte të gjitha kushtet për t'u marrë me një punë të tillë.**

Dalëngadalë po bëhen dy dekada që kur Maliq Kacani u nda nga jeta në një ditë marsi, nga një vdekje e papritur dhe e parakohshme. Maliqi ishte në moshën e pjekurisë së plotë, kishte shumë plane dhe projekte, por që mbetën pa u zbatuar. Një prej këtyre projekteve, siç më ka thënë, ishte historikut i fshatit dhe i zonës së Çidhnës, bashkë me mbledhjen e kulturës shpirtërore të kësaj treve, që Maliqi, me siguri, do të kryente shumë mirë, mbasi i plotësonte të gjitha kushtet për t'u marrë me një punë të tillë. Ky ishte aspekti shoqëror i vdekjes së Maliq Kacanit: humbëm një njeri që mund të jepte mjaft rezultate në fushën e etnokulturës dhe të historisë. Në aspektin familjar ai la në pikëllim nënën e tij, Xhiben, motrat Fatimen, Lirien dhe Elhamen, vëllezërit Shefqetin dhe Hajredinin dhe, mbi të gjitha, të shoqen dhe dy fëmijët që ende kishin shumë nevojë për të. Vdekja e tij pikëlloi edhe shokët dhe të gjithë ata që kanë punuar me të ose e kanë njohur. Atë ditë që u varros Maliq Kacani, megjithëse qe mot i ftohtë, erdhën për t\i dhënë lamtumirën shumë shokë e miq jo vetëm nga Fushë Alia dhe fshatrat përreth, por edhe nga Peshkopia dhe qytete të tjera. Nuk thonë kot se dita e vdekjes tregon ç\njeri ke qenë.

Me Maliq Kacanin ishim moshatarë. E kam njohur në shkollën fillore në Fushë Alie, ku mësonim në një klasë. Maliqi ishte nga nxënësit më të mirë të klasës. Në shkollën pedagogjike të Peshkopisë, që e mbaroi në vitin 1958, dallohej për një të mësuar logjik dhe për rezultate të larta në të gjitha lëndët, veçanërisht shquhej në letërsi, ku, siç thuhej atëherë, "nuk kishte lënë libër pa lexuar", edhe nga e ashtuquajtura "letërsi e verdhë", që qarkullonte në mënyrë klandestine. Me këtë letërsi në atë kohë kuptoheshin vepra të tilla si "Bija e mallkueme", "Engjëj në errësirë", "Ura e psherëtimave" etj., që ishin ndryshe nga ato që botoheshin në vendin tonë sipas metodës së realizmit socialist. Letërsia e huaj, siç emërtohej atëherë letërsia botërore, zinte një vend të konsiderueshëm në program të shkollës së mesme, por zhvillohej në mënyrë skematike dhe të sipërfaqshme, duke qëmtuar të ashtuquajtura kufizime ideore, siç quhej çdo gjë që nuk i shkonte për shtat shtetit totalitar. Në fakt kufizimet ideore shpesh shërbenin për shtrembërimin e ideve e veprave të autorëve të mëdhenj. Doktrina e Tolstoit: moskundërshtimi i të keqes me forcë, interpretohej thjesht si moskundërshtimi i së keqes, duke e zhveshur nga thelbi i vërtetë. Shembuj dhe qëndrime të tilla kishte shumë si për librat e autorët që ishin në program, ashtu edhe për ato për lexim të lirë. Këto të fundit shoqëroheshin me parathënie të gjata dhe të mërzitshme, me analiza klasore dhe ideologjike. Me fjalë të tjera, edhe letërsia botërore nuk i kënaqte plotësisht kërkesat shpirtërore të elementëve më të përparuar, ku hynte Maliq Kacani. Ai kishte krijuar bindjen për thatësirën e ideologjisë sunduese dhe kërkonte burime të tjera për t\u ushqyer shpirtërisht. I pëlqente shumë letërsia, por jo metoda simbas të cilës duhej shkruar. Prandaj ai nuk shkroi kurrë diçka letrare. Maliqi pati një formim pak të ndryshëm krahasuar me bashkëmoshatarët e tij: ishte më i avancuar dhe i pajisur me një shpirt kërkimi, i pakënaqur me realitetin, gjë që e vuri qysh herët në opozitë me sistemin. Për këtë arsye ai përfundoi në burg që kur ishte nxënës në pedagogjike bashkë me shokun e tij të ngushtë Halit Bushi. Por diktatura, për arsye që i dinte vetëm ajo, nuk i mbajti gjatë në burg "terroristët", duke bërë me këtë rast, amplifikimet e nevojshme, që të përputheshin me sloganin: "partia ua dha edhe një herë dorën".

Kur unë mbarova shkollën pedagogjike të Peshkopisë më 1960, më emëruan mësues në shkollën shtatëvjeçare të Fushë Alies ku Maliqi, mbas dy vjetësh punë si mësues, vitin e tretë ishte drejtor. Këtu u njohëm më mirë dhe pikërisht nga ajo kohë kam shumë mbresa dhe kujtime të paharruara edhe në lidhje me Maliqin. Atë vit bashkë me mua u emëruan mësues në këtë shkollë edhe Sinan Bitri e Skënder Kuta. Gjetëm aty mësues edhe Aqif Kaloshin, njeri i ndershëm dhe i urtë, pak më i moshuar se ne të tre, që ishim gjithë vrull dhe energji, por pa përvojë. Maliqi, pa asnjë ekzagjerim, u bë mësuesi ynë për shkak të pjekurisë së parakohshme. Mënyra si drejtonte, ishte vërtet origjinale: pa peshë autoriteti, pa distancë ndërnjerëzore, pa mendjemadhësi e arrogancë. Na ndihmoi të njihnim programet, të bënim planet mësimore dhe edukative, të bënim përgatitjen ditore etj. Në ndarjen e lëndëve dhe të orëve ishte i drejtë dhe i ndershëm. Mbante parasysh prirjet dhe dëshirat tona. Duke u nisur nga notat e shkollës së mesme, më kishin emëruar mësues matematike, kurse Skënder Kutën mësues gjuhe. Prirjet i kishim të kundërta dhe, me ndërhyrjen e Maliqit, seksioni i arsimit na i ndërroi lëndët. Maliqi orët e kontrollit i zhvillonte pa bujë e mendjemadhësi, nuk nisej kurrë nga dëshirë për të të kapur, por për të të ndihmuar. Ai dinte të ndërtonte marrëdhëniet me njerëzit, sidomos me ata me të cilët punonte. Ai të bënte ta ndjeje veten mirë.

Vitet e para të arsimit në Fushë Alie, megjithëse në kushte të vështira, pa ngrohje të përhershme, pa ujë, pa asnjë kusht për jetë normale, pa bazë të mjaftueshme mësimore, me nxënës të zhveshur dhe të kequshqyer, që vinin edhe nga zona shumë të largëta, kanë qenë vitet e mia më të bukura. Maliqi na krijoi një klimë të ngrohtë miqësie dhe shoqërie të sinqertë, që pastaj nuk e kam gjetur tek asnjë drejtues tjetër në vitet që do të vinin, me përjashtim të z. Munir Sina në gjimnazin e Peshkopisë, me fillimin e proceseve demokratike.

Po le të shkojmë tek ajo kohë e largët. Maliqi na udhëzonte si të punonim dhe na linte të punonim, pa vogëlsira dhe dredhira të ulëta. Punonim me ndërgjegje të lartë dhe jashtë orarit. Pothuaj gjithë ditën ishim në shkollë dhe merrnim rrugën e shtëpisë vetëm kur binte mbrëmja. Ne ndërtuam lulishte, terrene sportive, kabinete, pasuruam bazën materiale dhe e bëmë të mësuarit sa më konkret. Ne vetë lyenim klasat dhe shkollën, vetë kryenim të gjitha meremetimet e vogla, dhe nuk prisnim nga fushata arsimore që bëhej një herë në vit dhe me mungesa të mëdha. Çdo mësues i blinte tekstet dhe mjetet mësimore për klasën në kujdestari me rrogën e vet dhe nxënësve ua jepte pa lekë në dorë. Kishte mjaft nxënës të varfër që nuk ishin në gjendje t\ia kthenin lekët mësuesit, por askush nuk e bënte problem një gjë të tillë. Puna jonë plot përkushtim dhe dashuri dha rezultatet e veta. Ne kishim nxënës shumë të mirë. Shumica dërrmuese e nxënësve që mbaronin shkollën tonë, ndoqën shkollat më të larta. Shkolla jonë në atë kohë vlonte nga veprimtaritë kulturore dhe sportive. Kishim rrethin e recituesve, të valltarëve, të teatrit, të letrarëve, të biologëve, që nuk mbeteshin thjesht në letër, por funksiononin më së miri. Kishim një bibliotekë të mirë, që e pasuronim vazhdimisht. Për herë të parë në një shkollë fshati, siç ishte shkolla jonë, u botua një faqe letrare në gazetën "Pioneri"me krijime të nxënësve, në një kohë kur kjo gjë në shkollat e qytetit as që mund të mendohej. Nuk ishte rastësi që nga shkolla jonë, dolën elementë të talentuar në letërsi që bënë emër në shkallë kombëtare, si: Garip Troci, Maliq Bitri, Ilir Spata, Miftar Mena e të tjerë. Po kështu shkolla jonë kishte skuadrën më të mirë në volejboll që krahasohej vetëm me atë të Peshkopisë, kishim një ekip të mirë futbolli, pingpongu, shahu etj. Të gjitha këto nuk mund të bëheshin pa dashamirësinë, ndihmën dhe përkrahjen e drejtorit, Maliq Kacani. Vetë ai jepte matematikë dhe nuk kishte asnjë dyshim që ishte një mësues shumë i aftë dhe me rezultate, por detyra e tij ishte që të na bënte edhe ne mësues të mirë dhe me rezultate.



Maliqin e kishim jo vetëm drejtor, por edhe shok. Ai ishte një bashkëbisedues i këndshëm, plot kulturë dhe modesti. Kishe qejf ta dëgjoje për mënyrën se si hynte në bisedë, për shtjellimin e saj, për argumentet që sillte, për fjalën e rrallë dhe shprehjen koncize të mendimeve. Ishte njeri i përgjigjeve të shpejta dhe të sakta, plot humor, por edhe plot ironi e sarkazëm kur këto ishin të nevojshme. Mua Maliqi më kujtonte babanë e tij, Metën, që shquhej për muhabet të ëmbël, për ato bisedat filozofike, plot mençuri dhe përvojë jete. Por Maliqi, duke qenë i pajisur edhe me arsim, ishte përherë një burim përfitimi intelektual. Ne ishim një ekip i ri, me mendësi të reja, me kuptim të ri për jetën dhe për progresin, që, jo rrallë, binte në kundërshtim me prapambetjen e zonës dhe të drejtuesve të saj. Ende nuk na kishte thyer dhe mposhtur jeta, ende nuk ishin kalcifikuar në ndjenja dhe mendime, prandaj shikoheshim si opozitarë me atë që quhej gjoja tradicionale, por që në fakt ishte e prapambetur dhe anakronike. Maliqi na mbante larg konflikteve, merrte vetë përsipër dhe zgjidhte çdo problem që mund të na fuste në kontradikta me pushtetarët lokalë dhe me ata qendrorë. Lexuesi i sotëm duhet ta dijë se në atë kohë arsimtari kishte shumë varësi. Për të shfaqnin mendimin sekretarët e instruktorët e Komitetit të Rinisë të Rrethit, organizata e Gruas, Bashkimet Profesionale, instruktorët e Partisë, kuadrot drejtuese të zonës, madje edhe brigadieri i brigadës ku arsimtari ishte atashuar sipas praktikave të atëhershme. Kështu, si shembull, njëri prej tyre të fliste keq për një mësues, se gjoja nuk ndihmonte në filan sektor të jetës, mësuesi transferohej. Kjo varësi e shumfëfishtë e bënte arsimtarin krejt të pambrojtur, secili mund ta merrte nëpër këmbë. Dinjiteti i tij ishte i papërfillshëm dhe shumë herë cënohej rëndë. Kur ndonjë kuadër partie ose pushteti në rreth gabonte dhe duhej dënuar, ai dërgohej arsimtar. Kjo ishte një punë për të kryer dënimin. Nderimi dhe vlerësimi për arsimtarin ishin shprehje e retorikës dhe e demagogjisë. Prandaj merrte rëndësi të veçantë që të kishte një drejtor që nuk i linte arsimtarët nën mëshirën e goditjeve të të tjerëve, që i mbronte dhe i respektonte ata, që merrte përgjegjësi për punën dhe veprimtarinë e tyre. Maliqi e bënte këtë.

Por, me gjithë kujdesin e tij për të na ruajtur nga abskuarantizmi, ai na hëngri në mënyrë tinzare dhe bizantine, siç ndodhte shpesh. Mbas dy vitesh punë të palodhur, pa asnjë arsye, na transferuan të gjithëve, bashkë me drejtorin që e dërguan mësues në Shumbat, Sinan Bitrin e Skënder Kutën i degdisën larg, andej nga Zogajt, kurse mua akoma më larg, në Kala të Dodës (Ceren). U shkatërrua shkolla e Fushë Alies. Muret jo, ato ishin në këmbë, por u shkatërrua puna që kishim bërë, modeli i mësuesit që ishte krijuar, u nëpërkëmb drejtësia dhe besimi

homazh

ynë tek ata që na emëronin.

Mbas një viti unë personalisht u ktheva prapë në atë shkollë, por tani nuk ishte as Maliqi dhe asnjë nga shokët me të cilët e kisha nisur punën. Për më tepër nuk ishte më ajo klimë, nuk ishte më ai përkushtim, nuk ishte më ajo cilësi njerëzore, nuk ishte më ajo mënyrë drejtimi që e zotëronte dhe e kultivoi Maliq Kacani. Transferimi i mësuesve për t\i degdisur e jo për t\u krijuar kushte më të mira pune, ishte strategji e pushtetit të asaj kohe, për t\ua theksuar varësinë, për t\i mbajtur gjithnjë në lëvizje e në pasiguri. Për këtë arsye arsimtari nuk krijonte vlera të qëndrueshme, se sapo niste një punë afatgjatë, e ndërpriste atë për ta nisur gjithnjë nga e para, si muhaxhir në vendin e tij.

Maliq Kacani ndërkohë ndoqi studimet e larta me korrespondencë për gjuhë e letërsi. Vite më vonë ne kemi punuar prapë bashkë në shkollën e Fushë Alies. Tani unë kisha mbaruar shkollën e lartë dhe formimi im ishte shumë më i mirë, por nga ana shpirtërore nuk ishim më ata që kishim qenë. Sidoqoftë, me Maliqin koordinonim punën dhe ndihmonim njeri-tjetrin. Kam punuar me shumë kolegë, por Maliqi është nga të rrallët që dinte saktësisht gjuhën, hynte edhe në hollësira në mënyrë shumë profesionale. Me të ishte kënaqësi të diskutoje për çdo problem. Ai ka derdhur shumë djersë për arsimin në rrethin e Dibrës, ka drejtuar dhe punuar me ndërgjegje dhe profesionalizëm të lartë për rreth pesëdhjetë vjet me radhë. Nuk di të jetë vlerësuar dhe nderuar me ndonjë dekoratë, kur këto jepeshin për më mediokrit. Edhe ky qëndrim ishte shprehje e një diferencimi ofendues.

Me fillimin e proceseve demokratike, Maliqi qe ndër të parët që u përfshi në ndyshimin që pritej të ndodhte. Në komunën e Fushë Alies, për shkak të së kaluarës shumë të hidhur(Fushë aliasit ishin vrarë me partizanët dhe ata si hakmarrje e dogjën këtë fshat nga shtëpia e parë dhe e fundit, bashkë me shumë shtëpi në fshatrat përreth) lufta e klasave kishte qenë shumë e ashpër. Me ndërrimin e sistemit kishte rrezik që të ngjallej një urrejtje e pakufishme, që do të bëhej burim i hakmarrjes dhe një persekutimi të ri nga krahu tjetër. Por nuk ndodhi kështu. Burrat e mençur të Çidhnës e mbajtën veten, nuk i frynë urrejtjes, por dëgjuan fjalën e Zotit që ka thënë:"Hakmarrjen ma lini mua!" Në pushtetin e ri pluralist që u krijua në komunën e Fushë Alies, u zgjodhën burra të urtë dhe të mençur. Njeri prej tyre, me rol drejtues, ishte edhe Maliq Kacani, i cili, me urtësinë që e karakterizonte, me mençurinë dhe largpamjen, me fjalën e qetë dhe të argumentuar, ndikoi shumë që pluralizmi politik në këtë zonë dalëngadalë të futej në shinat e veta dhe të funksiononte mirë.

Ai ishte edhe një prind shumë i kujdesshëm. Pati një martesë të lumtur, se mori për grua, Melqe Kukelin nga Mustafejt, vajzë e lindur në një familje me tradita të lavdërueshme, me baba dhe vëllezër model të burrërisë dhe të karakterit të malësorit të hershëm. Vajza dhe djali u lindën pas shumë vjetësh martese, falë edhe punës prej shkencëtari të Prof. dr. Rrahim Gjikës, aso kohe drejtor i maternitetit të Peshkopisë. Dhe si çdo prind që gëzohet me fëmijë në një moshë relativisht të madhe, Maliqi i donte fort dhe kujdesej që të arsimoheshin në mënyrën sa më të mirë. E shikoje gjithnjë të preokupuar dhe të shqetësuar për to. Madje edhe vdekja i ka ardhur në një rrugë kthimi nga Tirana, kur ai kishte shkuar për të parë fëmijët që ishin në shkollë: Irena, në të lartën për juriste, Valteri në shkollë të mesme. Vdekja e Maliqit e shkatërroi familjen e tij, të paktën përkohësisht, sa Valteri u detyrua të lërë edhe shkollën. Sot plagët janë mbyllur, vdekja e Maliqit është kompensuar në mënyrën e kompensimeve që bën jeta. Kujtimi i tij njerëzor mbetet i paharruar.



*Hamdi Kacani para spitalit*

**Tek shpirti human, tek përkushtimi e urtësia, tek provat pajtimtare, tek respekti për familjen, fisin, vëllazërinë, miqësinë e shoqërinë, tek gjurmët prej çidhnaku të mençur e bujar, fjalëpashuar e me karar qëndron thjeshtësia e madhështia, qëndrojnë gjurmët e Hamdi Tahir Kacanit.**

# Çidhnaku humanist

*Nga* **MEVLUD BUCI**

Sinqerisht ndodh që çdonjëri prej nesh zihet shumë ngushtë, ndjen peshë të rëndë në mendje e në zemër, kur mëson për dikë që nuk jeton më. Përse? Jeta është e shkurtër, e bukur, e vështirë, e dhimbshme, por edhe gjurmëlënëse. Këto gjurmë i japin kuptimin e vërtetë e përjetësinë e jetës. Tek shpirti human, tek përkushtimi e urtësia, tek provat pajtimtare, tek respekti për familjen, fisin, vëllazërinë, miqësinë e shoqërinë, tek gjurmët prej çidhnaku të mençur e bujar, fjalëpashuar e me karar qëndron thjeshtësia e madhështia, qëndrojnë gjurmët e Hamdi Tahir Kacanit.

***

Hamdiu u lind më 14 mars 1934 në Fushë-Alie të Dibrës. U rrit dhe u edukua në kullat e mençurisë, të urtësisë së Kacanëve, të fisit e të mbarë trevës. Mësimet e para i mori në Fushë-Alie, kurse 8-vjeçaren (dy klasë për një vit) e përfundoi në qytetin e Peshkopisë. Mësimet e "gradat, e tjera të diturisë i mori në udhët e jetës, në udhët e humanizmit e të përkushtimit, në udhët e pajtimit e të vëllazërimit. Qysh në moshë të re Hamdiu e njohu dhe mësoi shumë nga "Universiteti i Çidhnakëve", "Universiteti i odave". Dihet nga të gjithë nëse edhe sot e kësaj dite në vallet e odave në Çidhën apo në mbarë Dibrën thonë: "E kishte pas thënë Mane Kacani... kishte pas thënë Taf Kola, kishte thënë Shaban Lusha, Sulë Kacani, Rushit Kacani (i pari) e plot të tjerë.


***

Qysh në vitin 1958 Hamdi Kacani filloi punë me ambulancën e spitalit të qytetit të Peshkopisë. Pranë punës, pranë shpëtimit të jetëve, natën e ditën, orar e pa orar në çdo cep të Dibrës e shpeshherë përmes netëve me acar apo stuhi edhe rrugëve drejt Tiranës a gjetkë. Përkrah mjekëve e në ballë të tyre brofte i pari në Qafëmurrë, Lurë, Reç, Kala të Dodës, Radomirë, Klenjë e cep më cep të Dibrës për të marrë të sëmurët për t'i çuar sa më parë në spital të Dibrës, pranë mjekut të rojes, pranë ndihmës mjekësore. S'është aspak hiperbolë, por një realitet që ta themi me plot bindje e vërtetësi se Hamdi Kacani është dhe mbeti njeriu i përkushtimit, fisniku i palodhur në roje të jetës. Kushedi sa e sa raste mbeti në dëborë, çau përmes dallgëve rrëzë Korabit e në grykat e Runjës, Pratit, brigjeve të Drinit, Setës, Murrës e Veleshicës, në Lanë-Lurë a Fushë-Studen, në Ostren, Zerqan, Bulqizë, Qafë-Buall, Qafë-Draj e plot të tjera. I përmendëm këto toponime sepse këtu e në plot vende të tjera, kaloi si zgalem përmes furtunave çidhnaku i punës e i urtësisë Hamdi Kacani, gjithnjë me sedër, guxim e shpirt human në shpëtim të jetëve në përballimin e urgjencave. Në Lukan të Dibrës rreth viteve '70 një grua në lindje më pas një burrë i moshuar po jepnin shpirt: Lajmëroni spitalin, lajmëroni urgjencën, lajmëroni Hamdi Kacanin – kjo ishte sentenca e parë që dilte nga goja e njerëzve të thjeshtë, e njerëzve në nevojë, të cilët prisnin të vinte shpëtimtari, i kudondodhuri, i palodhuri e zemërbardhi në ballë të ambulancës së mjekësisë Hamdi Kacani. E Hamdiu qëllonte që brenda një nate të përballonte 2, 3 apo më shumë urgjenca në raste kur jeta e njerëzve ishte në rrezik. Puna gjurmëlënëse, shpirti human e i përkushtuar, mençuria dhe maturia prej pajtimtari të gjaqeve, puna për vëllazërimin e nderimi për shokët për miqtë për demokracinë e këtij çidhnaku të thjeshtë, por të rrallë e fisnik nuk përshkruhen në caqet e një shkrimi të thjeshtë e të shkurtër, si ky që po bëjmë ne. Hami Kacani është në kujtesën e brezave, familjari i nderuar, me fëmijë të edukuar e të përkushtuar në udhët e të atit, prindit shembullor, burrë i fjalës, i maturi, të mençur me marrëdhënie të shkëlqyer në fis e krahinë, në punë e në shoqëri me miqësi e kudo. Së bashku me bashkëshorten e nderuar Fatime Kacani (Puci) bija e Fali Pucit, mbesa e martirit të demokracisë Cen Selmani (Puci) të Venishtit, lindën, rritën dhe edukuan 4 fëmijë, secili më i mirë se tjetri: Nahilen, Ilmiun, Hasien e Musain. Hamdiu edukonte me shembull e me fjalë me mimikë e me urtësinë prej çidhnaku të shquar, me korrektësinë burrërore, me pritjen bujare sipas karareve të Çidhnës, të cilat i dinte e diskutonte dhe i demonstronte e zbatonte në dobi të edukimit e të pajtimit.

Sentenca filozofike dhe mjaft e çmuar që na ka lënë Hamdi Kacani ishte "Me e dashtë njeriun, jo vetëm me e respektue". Vërtet dashuria njerëzore është themeli, kalaja e pamposhtur, ajo që çelikos nderimin midis njëri-tjetrit, është prova më e ndritur që flet me shumicë se mijëra fjalë të bukura. Babai i Hamdiut Tahir Kacani, bashkëshortja e tij Hike Kacani (bija e Loshës në Bulaç) rritën dhe edukuan gjashtë djemtë dhe një vajzë: Sulën, Manen, Iljazin, Ganiun, Slaiun, Hamdiun dhe Dudën (martuar ke Sula në Zall-Dardhë). Hamdiu i respektonte e mbi të gjithë i donte me prova të përditshme sinqeriteti e mikpritje, miqtë vëllazërinë, shoqërinë, të njohur e të panjohur si i thonë. Dashuria burrërore e pati deri në fund të jetës për miqtë e kullës së Kacanëve: Lushën e Reçit, Kurtin e Zerqanit, Dervishin e Lugjejt, Kotaren e Kalisit, për të gjithë nipat e mbesat e tij, për farefisin e shoqërinë e punës.

Në vitin 1995 erdhi në Tiranë me banim në rrugën "Budi". Pranë shtëpisë së re si relike e çmuar rrëzë ullinjve ishte edhe ambulanca, makina me të cilën për plot 40 vite uturi përmes maleve e honeve të Dibrës e gjetkë në roje të jetës. Në vitin 1990 doli në pension. Në vitet e demokracisë iu dha mundësia të shijojë te nipi Behar Leka i Çidhnës me banim në Amerikë. Ku ka si Amerika, por edhe ku ka si Çidhna, si Dibra, si Shqipëria. Kisha leje 6 muaj, por qëndrova 3. Isha rehat që zoti, por s'ka si dheu i nënës, si odat tona, si kultura jonë... Në dhjetor të vitit 2002 u paralizua. Njeri i mençurisë dhe i forcës njerëzore, i mikpritjes dhe i durimit, i respektit të thellë për demokracinë e të vërtetat demokratike, i nderimit të sinqertë për Dr. Berishën me të cilin kishte patur fatin e rastin të rrugëtojë me ambulancën e tij në Dibër dhe pati fatin ta takojë në baçen e shtëpisë së re në rrugën "Budi" në Tiranë. Pasi përfalën i thotë Dr. Berishës: "Kemi ndëgju se duan me të vu një ortak që s'e ke ortak. Edhe me ua pre mishin ju të dyve copa-copa e me ua lënë 24 orë në një kazan edhe lëngu nuk u përzihet..." Pritje shokësh, besë, përzemërsi. Berisha e viziton Hamdiun në shtëpi, Hamdiu ishte i paralizuar: Të kaluara Hamdi i thotë dr. Berisha. Hamdiu: I nderuar doktor, i falem Zotit që më ka marrë anën e majtë dhe jo të djathtën. Një radhë e pyet djali, Ilmiu, babanë e tij Hamdiun: Or babë a ke mbajt ndonjë fjalë nga Katër Grykët e Dibrës? Po, o bir. Kur takova Ramë Laskun, një plak të shenjtërisë fetare më tha: "Or Hamdi, m'u futën ujqërit në tufë e më hëngrën dhentë. Unë u thashë: aman merrni tuajat e leni të miat" (merrni haramin e lini hallallin). Nazif Bodini, një intelektual veteran i arsimit, nipi i akademik Lik Dërvishit, vëllai i të cilit Ibrahimi ishte byrazer me Hamdi Kacanin na thotë: Hamdi Kacani ishte simbol i çidhnakut të mençurisë, të traditës, të respektit njerëzor, i pajtimit dhe humanizmit.

Në shtator 2011 i thotë djalit Ilmiut: "Dua të shkoj në Dibër... Dhe djali e çoi. Ishte hera e fundit, hera kur biri i çidhnakëve përfalej me vendlindjen. Në bisedë e sipër me të birin, pas një humori të hollë çidhnak kthehet e i thotë djalit: "Bir shkohet me la mendjen, jo me la fytin..., në Koben e poshtë...". Vërtet lëngoi nga sëmundja e rëndë paraliza por nuk u përkul. Qëndroi mendjekthjellët, burrë i bujarisë burrë i plot provave të pajtimit e të urtësisë. Më 12 janar 2013 ndërroi jetë. U përcoll me nderime siç e meritonte. Koha shoqëria, miqtë, farefisi e secili prej nesh e gdhend si Çidhnaku i mençurisë dhe i punës në roje të jetës.





Xhafer Martini
**"GJENERALI ME SHAJAK"**
Monografi
Botimet "Dita 2000"
ISBN: 978-99956-92-78-0
Çmimi: 1000 lekë




Naim Berisha
**PENGU I NËNDHESHËM**
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-84-4
Çmimi: 400 lekë





Nazmi Hoxha
**ALBANIA E AMERIKËS**
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-87-5
Çmimi: 500 lekë




Kristo Frashëri
**"HISTORIA E DIBRËS"**
Histori
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-82-0
Çmimi: 1500 lekë




Agron Tufa
**FRAGMENTET E GJESE**
Poezi
Shtëpia Botuese OM - Prishtinë
ISBN: 978-9951-632-02-7
Çmimi: 5.5 Euro




Shaban Sinani
**NDAJFOLJET PËREMRORE NË GJUHËN SHQIPE**
Punim historik krahasues
Botimet Naimi
ISBN: 978-9928-109-44-6
Çmimi: 800 lekë





Elliot Moglica
**BURRI I MADH HASAN MOGLICA**
Biografi

ISBN: 978-0-9868069-2-6
Çmimi: 12 E, 18 CAD, 20 USD




Naim Berisha
**E DREJTA, E PADREJTA DHE KADIU**
Fabula
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-85-1
Çmimi: 300 lekë




Arbër Sh.Cami
**KALATË SHQIPTARE**
Album me foto
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-97-4
Çmimi: 500 lekë




Faik Xhani - Hatixhe Erebara
**I PERKUSHTUARI**
Monografi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-89-9
Çmimi: 500 lekë

**Këto libra mund t'i gjeni pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.**

Librin HISTORIA E DIBRËs të Kristo Frashërit mund ta gjeni:

Në PESHKOPI: **Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.** Në DIBËR TË MADHE: **Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>**

Në DURRËS: **Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353**

**Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 / 068 65 08 441 / 067 30 73 265 *E-mail*: <mbbotime@gmail.com>**

cyan magenta yellow black